



RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT
NË
FONDIN SHQIPTAR TË ZHVILLIMIT
PROJEKTI
“FURNIZIMI ME UJË I ZONAVE RURALE III”

SHTATOR 2021

Nr.	Përmbajtja	Faqe
I.	PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	3-7
1.	Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit	3
2.	Përshkrimi i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve	3-6
3.	Konkluzioni i përgjithshëm dhe Opinioni i auditimit	6-7
II.	HYRJA	8-11
1.	Objekti i auditimit	8
2.	Qëllimi i auditimit	8
3.	Identifikimi i çështjes	8
4.	Përgjegjësitë e strukturave drejtuese	8
5.	Përgjegjësitë e audituesve	8-9
6.	Kriteret e vlerësimit	9
7.	Standardet e auditimit	10
8.	Metodat e auditimit	10-11
9.	Dokumentimi i auditimit	11-12
III.	PËRSHKRIMI I AUDITIMIT	12-55
1.	Informacion i përgjithshëm mbi subjektin	12
2.	Përshkrimi i auditimit, sipas drejtimeve të auditimit	12-55
	Pika 1. Marrëveshjet e financimit të projektit me huadhënësit, ndryshimet, shkaqet dhe argumentimi i ndryshimeve.	12-15
	Pika 2. Mbi shkallën e realizimit të objektivave dhe të komponentëve të projektit në krahasim me ato të përcaktuara në marrëveshjet me huadhënësit. 2.1. Mbi ndjekjen e procedurave ligjore në hartimin e objektivave dhe komponentëve të marrëveshjes së financimit. 2.2. Mbi zbatimin e rregullave për përzgjedhjen e skemave. 2.3. Mbi shkallën e realizimit të objektivave dhe komponentëve të projektit në krahasim me ato të përcaktuara në marrëveshjet e me huadhënësit. 2.4. Mbi respektimin e afateve të përcaktuara në marrëveshjet e financimit, për realizimin e objektivave të projektit.	16-18
	Pika 3. Mbi menaxhimin financiar të projektit, shkallën e realizimit të disbursimeve financiare të fondeve kundrejt nivelit të programuar. Raportimi i tyre në Ministrinë e Financave. 3.1. Mbi ndjekjen e procedurave ligjore në menaxhimin financiar të projektit. 3.2. Mbi realizimin e disbursimeve të projektit, në krahasim me disbursimet e planifikuara. 3.3. Mbi ndjekjen e procedurave ligjore për raportimet financiare dhe jo financiare).	19-34
	Pika 4. Mbi realizimin e procedurave të prokurimit për shërbime, mallra dhe punime civile, përputhshmëria me udhëzuesit të Bankës, apo ligjit shqiptar, kur është i aplikueshëm. 4.1. Mbi përlllogaritjen e fondit limit. 4.2. Mbi hartimin e dokumenteve të tenderit. 4.3. Mbi vlerësimin e ofertave dhe nënshkrimin e kontratës.	35-43
	Pika 5. Mbi zbatimin e kontratave të punimeve civile, mallra e shërbime. 5.1. Auditimin me zgjedhje për ndjekjen e procedurave ligjore në shtesat e kontratave dhe urdhër ndryshimet, arsyet, shkaqet dhe miratimi i tyre. 5.2. Realizimi i shërbimeve, mallrave, punimeve sipas përcaktimeve kontraktore, specifikimeve teknike dhe standardeve.	44-48
	Pika 6. Mbi administrimin e veprave të dorëzuara.	49-55
IV.	GJETJET DHE REKOMANDIMET	56-61
V.	ANEKSE	62-77

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

1. Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit

Është audituar aktiviteti i Projektit të Furnizimit me ujë i zonave rurale IIIö, për periudhën e audituar referuar fillimit deri më datë 31.05.2021. Auditimi është fokusuar në marrëveshjet e financimit, realizimin e komponentëve dhe objektivave, menaxhimin financiar të projektit, realizimin e procedurave të prokurimit dhe shërbimeve dhe punimeve civile, zbatimin e kontratave të shërbimeve konsulentë dhe atyre të punimeve civile dhe administrimit të veprave të dorëzuara.

2. Përshkrimi i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve

Gjetja Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Referenca me Raportin Përfundimtar	Rëndësia	Rekomandimi
1.	Nga verifikimi në terren konstatohet se objektivi i përcaktuar në marrëveshjet midis KFW dhe Qeverisë Shqiptare i cili është furnizimi me ujë të pijshëm 24 orë nuk është arritur në të gjitha zonat. Më konkretisht në qytetin e Peshkopisë, fshati Çetush, u konstatua se ky fshat nuk ka furnizim me ujë të pijshëm 24 orë, konstatim i cili u konfirmua edhe nga banorët e fshatit gjatë verifikimit në terren. Gjithashtu gjatë auditimit të investimit në Depon e ujit të pijshëm në këtë fshat u konstatua se depo ishte e boshatisur dhe furnizimi me ujë të pijshëm për këtë fshat bëhej me orare të kufizuara. Nga verifikimi në terren në datën 18.06.2021, për investimin e kryer në zonën e qytetit Durrës, më konkretisht në fshatin Katundi i Ri ku ndodhen 2 depo uji të pijshëm të cilat furnizojnë me ujë të pijshëm disa fshatra siç janë Katundi i ri, Jubë, Qerret, Katund Sukth dhe Lagje e Mirditorëve, u konstatua se të 2 depot e ujit ishin të boshatisura dhe furnizimi me ujë të pijshëm në fshatrat e lartpërmendura kryhet me orare të kufizuara dhe jo 24 orë në ditë siç është e përcaktuar në Marrëveshjen e Huas ratifikuar me Ligjin nr. 97/2015, datë 17.05.2015, për projektin të Furnizimit me ujë i zonave rurale IIIö, si dhe Manuali Operacional i Projektit, Seksioni 2, pika 2.1.	16-18	E lartë	- Fondi Shqiptar i Zhvillimit në bashkëpunim me Institucionet Vendore të evidentojnë mangësitë në sistemet dhe impiantet hidraulike të furnizimit me ujë për zonat përkatëse me qëllim realizimin e furnizimit me ujë pa ndërprerje për këto zona. - Fondi Shqiptar i Zhvillimit të marri masat që në të ardhmen të angazhohet maksimalisht në rankimin e zonave ku do të investohet për projektet e ngjashme të furnizimit me ujë 24 orë, me qëllim që në ato zona burimet natyrore të ujit në sasi dhe cilësi furnizim të ujit duke pasur parasysh furnizimin me vetërrjedhje, për pasojë uljen e kostos së furnizimit me ujë për banorët.
2.	Bazuar, në angazhimet e përcaktuara në Marrëveshjet e Financimit të donatorëve përkatës, në Manualin Operacional të Projektit dhe në Marrëveshjet Përfundimtare të Investimit, NJVV të cilat përfitojnë nga ky Projekt, kanë detyrimin të financojnë në formë kontributi një pjesë të fondeve të projektit. Kështu gjatë implementimit të projektit për periudhën nga data 01.01.2016, deri më 30.06.2021, disa nga këto NJVV kanë derdhur kontributet e tyre në arkën e FZSHSH shumën totale 308,963,708 lekë. Ndërsa nëntë NJVV nuk kanë shlyer ende detyrimin në shumën 89,425,931 lekë për Kontributin Lokal në llogari të FSHZH-së (shiko listën në tabelën nr. 9, pikën nr. 3, të Raportit të Auditimit). Kjo situatë ka ndodhur si pasojë e mos respektimit të afatit për derdhjen e detyrimeve referuar Marrëveshjes Përfundimtare të Investimit të lidhur me NJVV respektive neni 3, pikat 3.1, 3.2, dhe 3.3, ku përcaktohet se: - Të plotësojë kontributin total financiar në vlerën 10% të çmimit të Kontratës të Punimeve. - Të rrisë pjesëmarrjen e Përfituesve të drejtpërdrejtë duke i nxitur ata të paguajnë të paktën 2% të Kontributit të Përfituesit.	19-34	E lartë	Fondi Shqiptar i Zhvillimit/Njësia e Menaxhimit të Projektit të marrin të gjitha masat e nevojshme duke ndjekur të gjitha rrugët procedurale dhe administrative për mbledhjen e detyrimeve/Kontributin Lokal në shumën 89,425,931 lekë nga NJVV përfituese të projektit të cilat janë debitorë ndaj FSHZH-së, në zbatim të përcaktimeve të Marrëveshjes Përfundimtare të Investimit.

	- Të paguajnë pjesën e mbetur të Kontributit të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore, para nënshkrimit të Kontratës të Punimeve, kjo e llogaritur mbi çmimin e Kontratës së Punimeve dhe të pagesave të kryera në numrin e llogarisë bankare të FSHZH.			
3.	<p>Gjatë periudhës së zbatimit të Projektit, Marrëveshjet e Financimit me dakortësinë e palëve janë ndryshuar (amenduar) në lidhje me afatet e disbursimeve të fondeve konkretisht:</p> <p>-Më datë 28.02.2019, midis KfW-së Gjermane dhe MFE-së është kryer amendimi i Marrëveshjes së Huas me nr. 201166370, të ratifikuar me Ligjin nr. 97/2015, datë 17.09.2015, me objekt shtyrjen e afatit të disbursimeve nga data 30.06.2019, deri më 30.06.2021.</p> <p>- Më datë 27.01.2020, midis KfW-së Gjermane dhe MFE-së është kryer amendimi i Marrëveshjes së Financimit me nr. 202061133, të ratifikuar me Ligjin nr. 35/2015, datë 09.04.2015, me objekt shtyrjen e afatit të disbursimeve nga data 30.06.2019, deri më datë 19.02.2022.</p> <p>- Më datë 29.01.2021, midis KfW-së Gjermane dhe MFE-së është kryer amendimi i Marrëveshjes së Financimit me nr. 201470137, të ratifikuar me Ligjin nr. 36/2015, datë 09.04.2015, me objekt shtyrjen e afatit të disbursimeve nga data 30.06.2019, deri më datë 30.12.2022.</p> <p>Në zbatim të nenit 3, pika 3.2, të marrëveshjeve të financimit respektivisht me nr. 202061133, dhe nr. 201470137, afati përfundimtar për kryerjen e disbursimeve është data 30.06.2019. Amendimet për ndryshimin/shtyrjen e afateve të disbursimeve janë bërë me shkresat e datës 27.01.2020, dhe datës 29.01.2021. Nga auditimi konstatohet se, disbursimet kanë vazhduar edhe pas datës 30.06.2019, në kushtet kur midis palëve nuk është dakordësuar amendim për ndryshimin e afateve për disbursimin e fondeve. Referuar shkresave të sipërpërmendura amendimet janë kryer pas 7 muajve për Marrëveshjen e Financimit me nr. 202061133, dhe pas 19 muajve për Marrëveshjen e Financimit me nr. 201470137, veprime këto jo sipas përcaktimeve të Marrëveshjes së Financimit dhe Projektit të ratifikuar me Ligjin nr. 35/2015, datë 09.04.2015, dhe Ligjin nr. 36/2015, datë 09.04.2015, për Projektin ÷Furnizimi me ujë i zonave rurale III÷, pikat 8.5, të secilës marrëveshjeje.</p>	19-34	E mesme	Fondi Shqiptar i Zhvillimit/Njësia e Menaxhimit të Projektit, në vijim të zbatimit të projektit ÷Furnizimi me ujë i zonave rurale III÷ si dhe për të gjitha projektet të cilat do të menaxhohen në të ardhmen nga FSHZH, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat administrative për informimin e MFE në cilësinë e përfaqësuesit të Qeverisë Shqiptare për përfundimin e afateve të disbursimeve financiare referuar marrëveshjeve të financimit në kushtet që nga MFE dhe donatorët të kryen amendimet në kohë reale.
4.	<p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion në lidhje me likuidimin e TVSH-së nga Qeveria Shqiptare, referuar kontratës të datës 26.02.2019, nëndërmjet FSHZH-së dhe OE J. ÷T. E.÷ & ÷S.÷ me objekt ÷Ndërtimi i sistemit të ri të ujësjellësit dhe furnizimin me ujë 24 orë për 15,883 banorë, Lot 1÷ në vlerën 8,601,883 euro pa TVSH konstatohet se:</p> <p>Për situacionin e punimeve nr. 6, të kontratës të sipërpërmendur OE ka lëshuar faturën tatimore seria 77032493, nr. 42, datë 29.06.2020, në shumën 795,398 euro me TVSH. Për këtë faturë, TVSH-ja është në shumën 132,566.48 euro konvertuar sipas kursit të Bankës së Shqipërisë (1 euro këmbëhet me 124.77 lekë) ose në shumën 16,474,036.47 lekë. Likuidimi i TVSH për këtë faturë është kryer me Urdhër Shpenzimit nr. 108/1, datë 07.07.2020, në shumën 16,747,036 lekë me një diferencë më tepër në shumën 273,000 lekë në favor të OE J. ÷T. E.÷ & ÷S.÷. Kjo problematikë është bërë me dije përfaqësuesve të FSHZH-së më datë 28.06.2021, ku më datë 29.06.2021, janë kryer veprimet rregulluese në R. Bankë sipas transaksionit me referencë nr. P210629EUPOP08, datë 29.06.2021, ku OE ka arkëtuar në llogari të FSHZH-së shumën 273,000 lekë.</p>	19-34	E lartë	Fondi Shqiptar i Zhvillimit/Departamenti i Financës në pasqyrat financiare të vitit 2021 të kryejë sistemin e vlerës 273,000 lekë, vlerë e cila ka të bëjë me regjistrimin e gabuar të likuidimit të TVSH-së për situacionin e punimeve nr. 6, për kontratën e zbatimit të punimeve Lot 1 të lidhur midis OE J. ÷T. E.÷ & ÷S.÷ dhe FSHZH, për Projektin ÷Furnizimi me ujë i zonave rurale III÷ duke u bazuar në Urdhër Shpenzimit nr. 108/1, datë 07.07.2020, referuar sistemit të trajtimit kontabël dhe funksionimit të llogarive të grupit 23 ÷Investime në proces÷, si dhe të bëhen rakordimet me Degën e Thesarit Tiranë.

	Pavarësisht kthimit të shumës nga OE, në pasqyrat financiare të vitit 2020, regjistrimi i kësaj pagese nuk është kryer në përputhje me vlerën e saktë të përcaktuar në faturën tatimore, veprime këto jo sipas përcaktimeve të Ligji nr. 9228, datë 29.04.2004, òPër kontabilitetin dhe pasqyrat financiareò i ndryshuar, dhe Ligjit nr. 92/2014, datë 24.07.2014, òPër tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisëò i ndryshuar, neni 48.			
5.	Nga auditimi i procedurave të prokurimit të projektit òFurnizimi me ujë i zonave rurale IIIò u konstatua se, dosjet e prokurimit nuk ishin të inventarizuara dhe arkivuara, gjithashtu shumë prej shkresave, kontratave amendamenteve rezultuan të pa protokolluara, veprime këto në kundërshtim me nenin 3 dhe 29 të òNorma Teknike Profesionale dhe Metodologjisë të Shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisëò, miratuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave, në zbatim të Ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003, òPër Arkivatò.	35-43	E mesme	Fondi Shqiptar i Zhvillimit/Njësia e Menaxhimit të Projektit, të marrë masa për protokollimin dhe arkivimin e të gjitha dosjeve të procedurave të prokurimit të zhvilluara për këtë Projekt në zbatim të Normave Teknike Profesionale dhe Metodologjisë të Shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisë.
6.	Për projektin òFurnizimi me ujë i zonave rurale IIIò konstatohet se nuk është hartuar një Plan Prokurimi, veprime këto në kundërshtim me kapitullin 9, nënpika 9.1, òFazat e procesit të prokurimitò të Manualit të Procedurave të FSHZH miratuar me Vendimin nr. 167, datë 06.12.2018, i ndryshuar.	35-43	E mesme	Fondi Shqiptar i Zhvillimit, strukturat përkatëse të prokurimit sipas rastit, të marrin masa që në të ardhmen përpara kryerjes së procedurave të prokurimit për realizimin e projekteve të miratuara më parë, të planifikojnë dhe dokumentojnë prokurimet që do të kryhen në fazën e parashikimit në konformitet me ligjet, rregullat dhe manualet në fuqi.
7.	Nga auditimi i dokumentacionitmbi procedurat e realizimit të projekteve që në fazën e studimit të fizibilitetit, referuar edhe skeduleve apo manualeve për zbatim të projekteve të miratuara nga donatori, ka rezultuar se angazhimi i strukturave përkatëse të FSHZH në projektin òFurnizimi me ujë i zonave rurale IIIò ka qenë i pjesshëm, shoqëruar në disa raste edhe nga mungesa e gjurmës së auditimit, veprime këto jo sipas parashikimeve të Appendix 2, RWSP IMPLEMENTATION FRAMEWORK.	35-43	E Lartë	Fondi Shqiptar i Zhvillimit, Drejtoria Juridike dhe Drejtoria Teknike, të marrin masa që në të ardhmen të angazhohen në çdo projekt në konformitet me manualet dhe rregulloret në fuqi me qëllim përmirësimin e cilësisë së ekzekutimit të projekteve, si nga ana ligjore ashtu dhe teknike duke pasur parasysh lënien e gjurmës së auditimit.
8.	Nga auditimi u konstatua se, shumë prej zërave të listuara në listën e punimeve të vogla të pakryera (Snagging List) që shoqëron certifikatën e marrjes në dorëzim, nga krahasimi i bërë me verifikimin në terren të grupit të auditimit rezultuan ende të pakryera dhe nga ana e FSHZH nuk është marrë asnjë masë për të nisur një rinspektim për të verifikuar gjendjen sipas afatit të përcaktuar në të më datë 10.06.2021, veprime këto në kundërshtim me Kontratën No. RWSP-WC-ICB-2018-4 lidhur midis Fondit Shqiptar të Zhvillimit dhe BOE òA.ò SHPK & òA. G.ò O. më datë 18.04.2019, me objekt òNdërtim/Rikonstrukcion i Ujësellsave në zonat rurale LOT 4ò.	44-48	E mesme	Fondi Shqiptar i Zhvillimit/Njësia e Menaxhimit të Projektit të marrë masat për të kryer inspektimin për verifikimin e gjendjes dhe të adresohen shkaqet e përgjegjësitë e punimeve të mbetura ende pa kryer si dhe të adresohen mënyrat e përfundimit të tyre referuar kontratës.
9.	Nga auditimi i zbatimit të kontratave për projektin òFurnizimi me ujë i zonave rurale IIIò u konstatua se, rrethimet e depove të ujit nuk ishin të sigurta nga ndërhyrjet e kafshëve (zvarranikëve) duke rritur riskun për ndotje të depove të ujit. Gjithashtu nuk kishte asnjë pajisje monitorimi të ambienteve të ujit të pijshëm, veprim ky në kundërshtim me kushtet e marrëveshjes dhe VKM nr. 379, datë 25.05.2016, òPër miratimin e rregullores, Cilësia e ujit të pijshëmò, neni 11.	44-48	E lartë	Fondi Shqiptar i Zhvillimit/Njësia e Menaxhimit të Projekteve në të ardhmen, të marrin masa që të angazhohen seriozisht që në fazën e hartimit të projektit me qëllim propozimet përkatëse për përfshirjen në projekte specifike që kanë ndikim në jetën apo sigurinë e jetës së njeriut, të elementeve të sigurisë për sigurimin e garancisë së shëndetit publik në radhë të parë në konformitet me ligjet, rregullat apo marrëveshjet e miratuara nga palët.
10.	Për realizimin e skemave të furnizimit me ujë, ndërmjet FSHZH-së dhe operatorëve ekonomikë janë nënshkruar katër kontrata punimesh për secilin Lot. Deri në momentin e auditimit kanë përfunduar Lotet 1,			Fondi Shqiptar i Zhvillimit/Njësia e Menaxhimit të Projekteve, të marrë të gjitha masat administrative të nevojshme për Projektin òFurnizimi

<p>2 dhe 4, ku aktualisht janë në periudhë garancie, përsa i përket Lotit 3 është në proces punimesh. Në zbatim të angazhimeve të kontratave të punimeve, për lotet që kanë përfunduar punimet nga supervizori janë lëshuar certifikatat e marrjes së përkohshme në dorëzim të punimeve, marrë këto në dorëzim nga NJVV sipas rastit dhe skemave përkatëse. Për kalimin veprave të marra në dorëzim si aset në pronësi të NJVV, ndërmjet palëve janë nënshkruar marrëveshjet përfundimtare të investimit me çdo njësi. Nga auditimi konstatohet se, pas përfundimit të punimeve dhe marrjes në veprave në dorëzim bazuar në certifikatat përkatëse nga NJVV përfituese ende nuk ka nisur procesi i regjistrimit si aset në pronësi të tyre, siç parashikohet në marrëveshjet përfundimtare të investimit të datës 17.09.2018, datë 11.10.2018, dhe datës 23.01.2019, nënshkruar ndërmjet FSHZH-së dhe NJVV respektive, neni 2, pika 2.12, neni 3, pika 3.4, dhe pika 3.5.</p>	<p>49-55</p>	<p>E lartë</p>	<p>me ujë i zonave rurale IIIö dhe për Projektet në vazhdim që gjatë procesit të transferimit kapital të investimeve, të kërkohet nisja e menjëhershme e regjistrimit të aseteve në llogari të përfituesve të këtyre investimeve konform akteve ligjore dhe rregullave në fuqi.</p>
---	--------------	----------------	---

3. Konkluzioni i përgjithshëm dhe Opinioni i Auditimit

Opinion mbi përputhshmërinë (I pamodifikuar me theksim çështje)

Ne kemi audituar përputhshmërinë e aktivitetit për Projektin òFurnizimi me ujë i zonave rurale IIIö, financuar me fondet e Bankës Gjermane për Zhvillim, Bashkimit European përmes programit IPA dhe Republikës së Shqipërisë në formën e Kontributit Lokal nëpërmjet Njësive të Vetëqeverisjes Vendore përfituese të Projektit, bazuar në Marrëveshjet e Financimit të ratifikuara respektivisht me Ligjin nr. 35/2015, datë 09.04.2015, Ligjin nr. 36/2015, datë 09.04.2015, dhe Marrëveshjen e Huas të ratifikuar me Ligjin nr. 97/2015, datë 17.09.2015. Auditimi është bazuar në ligjin e Kontrollit të Lartë të Shtetit, Rregulloren e Procedurave të Auditimit, Manualin e Përputhshmërisë, si dhe Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Sektorit Publik ISSAI 4000 dhe 4100.

Në opinionin tonë, bazuar në evidencat e auditimit, mbi të cilat janë formuluar gjetjet dhe rekomandimet përkatëse, përmbledhur në bazën për opinion, si rrjedhojë e ekzekutimit të procedurave audituese, rezulton se Projekti (faza e tretë) për shkak të rëndësisë të anomalive të trajtuara në këtë Raport Auditimi, ka devijime materiale por jo të përhapura. Megjithatë grupi i auditimit tërheq vëmendjen për disa çështje të rezultuara gjatë auditimit dhe për këtë arsye gjykojmë dhënien e **Opinionit të pamodifikuar me theksim çështje**.

Baza për Opinion e pamodifikuar me theksim çështje:

Gjatë auditimit u konstatuan disa çështje të cilat ndikojnë në cilësinë e informacionit financiar të paraqitur për menaxhimin financiar të projektit, duke përfshirë dobësitë në sistemin e kontrollit të brendshëm dhe anomalitë e identifikuara.

Konkretisht:

- Për detyrimet në formën e Kontributit Lokal nga Njësiti e Vetëqeverisjes Vendore përfituese të Projektit në vlerën **89,425,931 lekë**.
- Për mos furnizimin me ujë të pijshëm 24 orë të zonave të evidentuara në këtë Raport, duke mos arritur objektivin e marrëveshjes/kontratës atë të furnizimit pa ndërprerje me ujë të zonave të përzgjedhura si zona që nuk kanë pasur ujë të pijshëm 24 orë.
- Në përgjithësi strukturat e FSHZH-së, janë angazhuar në etapat e projektit por jo në të gjitha rastet ky angazhim është i verifikueshëm. Strukturat e Menaxhimit të Projektit pranë FSHZH, duhet të angazhohen me qëllim lënien e gjurmës së auditimit në konformitet të plotë me kapitullin nr. 9, nën kapitullin nr. 9.1, Fazat e Procesit të Prokurimit, nënkaptullin nr. 9.1.6, pika

593 dhe 594 të Manualit të Procedurave të FSHZH miratuar me Vendimin nr. 167, datë 06.12.2018, i ndryshuar, për sa i përket hartimit të DST-ve, dhënien e mendimeve ligjore përpara nënshkrimit të kontratave apo amendimeve të tyre por dhe për dhënien e mendimeve teknike lidhur me hartimin e projektit teknik.

Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të Projektit:

Drejtimi i projektit është përgjegjës për marrjen e masave të nevojshme në drejtim të garantimit të përputhshmërisë së aktivitetit me kushtet referuar Marrëveshjeve të Financimit të ratifikuara respektivisht me Ligjin nr. 35/2015, datë 09.04.2015, Ligjin nr. 36/2015, datë 09.04.2015, dhe Marrëveshjes së Huas të ratifikuar me Ligjin nr. 97/2015, datë 17.09.2015. Gjithashtu drejtimi i projektit është përgjegjës kryesor për ngritjen e sistemeve të kontrollit dhe marrjes së masave të sinjalizimit për veprime korruptive në realizimin e objektivave të këtij projekti, duke nisur nga hartimi i rregullave të brendshme, strukturës në dispozicion, duke përcaktuar përgjegjësitë dhe detyrimet e çdo punonjësi në zbatim të kushteve të marrëveshjeve të financimit të projektit, mbi të gjitha duke shmangur dhe mbikëqyrur konfliktin e interesit.

Përgjegjësitë e Audituesve të KLSH mbi Auditimin e Përputhshmërisë:

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të institucioneve supreme të auditimit (ISSAI 4100 dhe ISSAI 4200). Ne jemi të pavarur nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit theksuar kjo në ISSAI-n 10-Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t, si dhe ISSAI 30- Kodi Etik, në përputhje me kërkesat etike që janë të rëndësishme në auditimin e përputhshmërisë në Republikën e Shqipërisë, duke përfshirë Kodin e Etikës të KLSH dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi marrë është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të siguruar bazën për opinionin tonë. Objektivat e punës sonë lidhen me garantimin e sigurisë së arsyeshme nëse realizimi i projektit nuk paraqet anomali materiale, si dhe për të konkluduar me një raport auditimi që përfshin një opinion mbi përputhshmërinë e aktivitetit me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi (marrëveshjet e financimit). Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Anomalitë mund të lindin nga gabimet apo mashtrimet dhe konsiderohen si materiale, nëse individualisht ose në tërësi ato influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve të raportit të treguesve fiskalë të konsoliduar. Përveç standardeve të ISSAI, ne gjithashtu aplikojmë edhe gjykimin dhe skepticizmin tonë profesional në punën audituese. Konkluzionet tona janë të bazuara në punën audituese, deri në përgatitjen e raportit të auditimit. Megjithatë, ngjarje apo kushte specifike në të ardhmen mund të ndryshojnë situatën aktuale të projektit. Gjithashtu, ne u mundësojmë drejtuesve një deklaratë në lidhje me kërkesat etike të pavarësisë sipas të cilave ne kemi kryer punën tonë audituese, dhe komunikojmë me ta në rastet kur ekziston konflikt interesi apo çështje të tjera lidhur me etikën.

II. HYRJA

Mbështetur në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014, për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit, në zbatim të Projektit dhe Programit të Auditimit nr. 581/1 prot., datë 04.06.2021, miratuar nga Kryetari i KLSH-së, nga data 01.06.2021, deri më 30.07.2021, në subjektin Fondi Shqiptar i Zhvillimito Tiranë, Projekti Furnizimi me ujë i zonave rurale IIIo për periudhën nga fillimi i projektit deri më datë 30.05.2021, u krye auditimi mbi zbatimin e përputhshmërisë nga Grupi i Auditimit me përbërje:

1. A. T., Përgjegjës Grupi
2. M. R., anëtare
3. A. R., anëtarë
4. M. H., anëtarë

OBJEKTIVAT, FUSHËVEPRIMI DHE METODOLOGJIA

1. Objekti i auditimit: Objektivi kryesor i grupit të auditimit të KLSH është dhënia e opinionit për përdorimin ligjor të fondeve dhe rregullshmëria financiare e paraqitjes së dokumentacionit, që Fondi Shqiptar i Zhvillimit u ka bërë fondeve në dispozicion për Projektin Furnizimi me ujë i zonave rurale IIIo në bazë të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi, marrëveshjeve, udhëzuesve, duke audituar rregullaritetin, ligjshmërinë e transaksioneve si dhe argumentimin e shpenzimeve të kryera në funksion të zbatimit të projektit.

2. Qëllimi i auditimit: Auditimi ka për qëllim *promovimin e transparencës* duke ofruar raporte të besueshme për fondet nëse janë raportuar siç kërkohet si dhe nëse janë arritur apo jo objektivat e Projektit. Gjithashtu, projekti i auditimit ka për qëllim *promovimin e përgjegjshmërisë* ndaj devijimeve të raportimit dhe ndaj shkeljeve të kuadrit ligjor, në mënyrë që të mund të merren veprime korigjuese dhe personat përgjegjës të përgjigjen për veprimet e tyre. Auditimi i përputhshmërisë i ndërmarrë nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, ka për qëllim promovimin e qeverisjes së mirë në sektorin publik duke marrë parasysh rrezikun e mashtrimit në lidhje me përputhshmërinë (sipas ISSAI 400, p 18).

3. Identifikimi i çështjes: Fondi Shqiptar i Zhvillimit në cilësinë e Agjencisë Zbatuese të Projektit, Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore dhe Ujësjellës Kanalizime Sh.a të cilat janë pjesë e skemës të financimit (përfituesit e projektit), duhet të kenë organizimin e duhur, duhet të funksionojë duke respektuar aktet ligjore e nënligjore në fuqi për arritjen në cilësi të punimeve/shërbimeve të ofruara nga Projekti.

4. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjektit të audituar lidhur me çështjen nën auditim: Fondi Shqiptar i Zhvillimit ka si qëllim arritjen e objektivave, duke respektuar përcaktimet në marrëveshjet, udhëzuesit, manualin përkatës, në mënyrë që të përzgjidhen për investim objektet me impakt sa më të lartë dhe me numër sa më të madh përfituesish.

5. Përgjegjësitë e audituesve: Audituesit janë përgjegjës për shprehjen e konkluzioneve dhe dhënien e opinionit mbi çështjet nën auditimin. Auditimi është kryer në përputhje me Standardet

Ndërkombëtare të Auditimit INTOSAI. Janë respektuar kërkesat etike si dhe është planifikuar dhe kryer auditimi sipas të cilit është arritur niveli i sigurisë së kërkuar.

6. Kriteret e vlerësimit:

- Kushtetuta dhe Ligji nr. 154/2014, datë 27.11.2014, òPër organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetitò.
- Manualet e auditimit, rregullat, udhëzimet e KLSH-së.
- Ligji nr. 97/2015, òPër ratifikimin e marrëveshjes së Huas dhe Projekti ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë òHuamarrësiò, të përfaqësuar nga Ministria e Financave, e Fondit Shqiptar për Zhvillim òAgjencia e Zbatimit të Projektitò, dhe KfW Frankfurt AM Main òKfWò, lidhur me furnizimin me ujë të zonave rurale IIIò.
- Ligji nr. 35/2015, òPër ratifikimin e marrëveshjes së financimit dhe projekti ndërmjet Republikës së Shqipërisë, òMarrësiò, të përfaqësuar nga Ministria e Financave, dhe Fondit Shqiptar për Zhvillim, òAgjencia zbatuese e projektitò, dhe KfW Frankfurt am Manin, òKfWò, për fondet IPA të Bashkimit Evropian për furnizimin me ujë të zonave ruraleò.
- Ligji nr. 36/2015, òPër ratifikimin e marrëveshjes së financimit dhe projekti ndërmjet Republikës së Shqipërisë, òMarrësiò, të përfaqësuar nga Ministria e Financave, dhe Fondit Shqiptar për Zhvillim, òAgjencia zbatuese e projektitò, dhe KfW Frankfurt am Manin, òKfWò, për masat shoqëruese për furnizimin me ujë të zonave rurale IIIò.
- Ligji nr. 8402, datë 10.09.1998, òPër kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimitò i ndryshuar;
- Ligji nr. 8990, datë 23.1.2003, òPër vlerësimin e ndikimit në mjedisò i ndryshuar, si dhe ligje të tjera të fushës së ndërtimit.
- VKM nr. 116, datë 24.02.1997, òPër kompetencat, procedurat, nënshkrimi, lëvrimin, regjistrimin, zbatimin, shlyerjen dhe raportimin e huave, kredive dhe ndihmave të huaja që i jepen Qeverisë së Republikës së Shqipërisëò i ndryshuar.
- VKM nr. 452, datë 01.07.1998, òPër disa masa në përmirësimin e punës për financimin e projekteve që financohen nga donatorët e huajò.
- Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 8, datë 17.02.2003, òPër evidentimin, regjistrimin, përdorimin dhe raportimin e financimeve të huaja, në kuadrin e projekteve dhe marrëveshjeve me donatorët e huajò.
- Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 20, datë 24.12.2003, òPër përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore të njësisë të menaxhimit/zbatimit të projekteve dhe marrëveshjeve me donatorët e huajò.
- Udhëzuesit e prokurimit të Huadhënësit për zbatimin e kontratave për mallra, punime dhe shërbime; Manuali Operacional i FSHZH-së.
- Akte të tjera ligjore apo nënligjore që do të jenë të nevojshme gjatë auditimit.

7. Standardet e auditimit: Auditimi është kryer në përputhje me procedurat e përgjithshme të pranuar të kuadrit ligjor, rregullator dhe Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit (ISSAI). Raporti i auditimit është hartuar në përputhje me kërkesat e Rregullores së Procedurave të Auditimit në KLSH, mbështetur në:

Kërkesat e Kushtetutës së Shqipërisë (Pjesa XIV, nenet 162 ó 165).

Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014, òPër organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetitò.

ISSAI 100 - Parimet themelore të auditimit të sektorit publik.

ISSAI 400 - Standardet e Auditimit të Përputhshmërisë.

ISSAI 4000 - Prezantim i përgjithshëm i udhëzimeve për auditimin e përputhshmërisë.

ISSAI 1500 (ISA 500) - Objektivi i audituesit është të hartojë dhe të kryejë procedurat e auditimit në mënyrë të tillë që të mundësojë marrjen e evidencës së mjaftueshme për të nxjerrë konkluzione të arsyeshme në të cilin do të bazojë opinionin e tij.

ISSAI 1530 (ISA 530) - Objektivi i audituesit është të kryejë procedura të përshtatshme auditimi në funksion të këtij objekti.

Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA) të Federatës Ndërkombëtare të Kontabilistëve IFAC.

Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë të Gjykatës Evropiane të Audituesve.

Kërkesat e Udhërrëfyesit të IDI-t, INTOSAI për implementimin e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI mbi Auditimin e përputhshmërisë.

Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë të KLSH.

Si dhe në praktikat më të mira të fushës.

8. Metodatat e auditimit:

- ✓ Metodatat e auditimit janë bazuar tek kombinimi i testeve të ndryshme të auditimit.
- ✓ Në funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm.
- ✓ Në procedurat bazë dhe në procedurat analitike pas sistemeve të kryera me qëllim arritjen e objektivave të auditimit.

Nisur nga veçoritë e subjektit të audituar konkretisht, Fondi Shqiptar i Zhvillimit për Projektin ÷Furnizimi me ujë i zonave rurale IIIö, periudha gjashtë vjeçare e aktivitetit të projektit të audituar; periudha dhe koha e zhvillimit të auditimit, në varësi të çështjeve të auditimit dhe vlerësimit të audituesve janë përdorur veçmas ose të kombinuara metodatat dhe teknikat e mëposhtme:

a. Verifikimi i transaksioneve - duke marrë informacion për një rrethanë ose transaksion nga një burim i caktuar, dhe krahasimin me një informacion të marrë për të njëjtat transaksione, por me origjinë nga një burim tjetër.

b. Intervistimi - duke marrë informacion nëpërmjet pyetjeve drejtuar personelit kyç të subjektit për një çështje të caktuar, e kombinuar kjo me shqyrtimin e evidencave përkatëse.

c. Raporte dhe informacione - shfrytëzimi i raporteve/ informacioneve relevante dhe që kanë lidhje me objektivat e auditimit dhe specifikisht drejtimeve të auditimit.

d. Pyetësorët për vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm - duke marrë informacionet e funksionimit të sistemit të kontrollit të brendshëm dhe menaxhimit financiar të subjektit.

e. Modelimet e thjeshta statistikore - në lidhje me përzgjedhjen sa më përfaqësuese të shembullit për shqyrtim në çështje të caktuara të auditimit.

f. Verifikimi në sistem dhe në terren- me përzgjedhje të çështjeve të veçanta të auditimit, sipas drejtimeve të auditimit.

g. Të kombinuara, sipas rastit dhe vlerësimit të audituesve- Audituesit e KLSH janë përpjekur në çdo rast në përzgjedhjen e arsyeshme dhe të mjaftueshme të metodave dhe teknikave veçmas dhe/ose të kombinuara, si dhe shtrirjen e tyre për të dhënë siguri të arsyeshme në arritjen e konkluzioneve dhe opinionit të auditimit.

9. Dokumentimi i auditimit: Audituesit e KLSH, për dokumentimin e auditimit janë mbështetur në kërkesat e Manualit të Auditimit të Përputhshmërisë, si edhe në Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit ISSAI 1230 ÷Dokumentimi i Auditimitö, që të jetë i

mjaftueshëm për të mundësuar dhekuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit të kryera në përputhje me standardetpërkatese dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatore.

Mbi bazën e evidencave të kërkuaradhe të vëna në dispozicion, si dhe intervistave, takimeve dhe konsultave me nëpunësit e Fondit Shqiptar të Zhvillimit (strukturat drejtuese të projektit) audituesit e KLSH kanë përgatitur dokumentacionin e mjaftueshëm të auditimit, si rezultat ikuptimit të qartë të kritereve të përdorura, të fushë-veprimit të auditimit; të gjykimeve, tëpërfundimeve të arritura në zbatimin e programit të auditimit dhe natyrën, kohën, shtrirjen dhe rezultatat e procedurave të kryera; arsyetimin pas të gjitha çështjeve të rëndësishme që kërkohet përushtrimin e gjykit profesional si dhe konkluzioneve lidhur me to.

Në këtë mënyrë, dokumentimi iauditimit është kryer nëpërmjet letrave të punës, shënimeve, pyetësorëve, të finalizuara me aktkonstatimet dhe observacionet e subjektit, të cilat kanë shërbyer si bazë për hartimin e këtij Raporti Auditimi.

III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

1. Informacion i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim

Ky projekt financohet me fondet e Bankës Gjermane për Zhvillim, Bashkimit European përmes programit IPA dhe Qeverisë Shqiptare, nëpërmjet Fondit Shqiptar të Zhvillimit në rolin e Agjencisë Zbatuese të Projektit. Për sigurimin e këtyre fondeve janë lidhur katër marrëveshje me KfW-në Gjermane në shumën 35,973,922 euro (në formë grantesh në shumën 11,973,922 euro + hua në shumën 24,000,000 euro) dhe Kontribut Lokal në shumën 4,000,000 euro nga Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore përfituese të projektit ku totali shkon në shumën 39,973,922 euro.

Fondi Shqiptar i Zhvillimit ka menaxhuar projektin, për të cilin janë ndërtuar dhe rindërtuar sisteme të reja për Ujësjetësuar sipas 26 skemave për furnizimin me ujë të 83 fshatrave në qarqet Korçë, Elbasan, Dibër, Kukës, Lezhë, Vlorë, Fier, Berat, Tiranë dhe Durrës. Objektivat kryesorë të projektit janë: Përmirësimi dhe furnizimi me ujë të pijshëm 24 orë për 88,167 banorë në zonat rurale të cilat kanë problematika të shumta në këtë furnizim.

Objekti, qëllimi dhe fushëveprimi i auditimit është rregullshmëria e shpenzimeve sipas projektit, sa i përket shpenzimeve konsulente, ashtu edhe shpenzimeve për mallra dhe punime, për fazën e tretë të projektit. Është audituar aktiviteti i projektit për periudhën e auditimit, fokusuar kryesisht në operacione financiare, por jo vetëm. Janë audituar disbursimet, marrëveshjet financiare me ndryshimet përkatëse, objektivat dhe qëllimi i projektit krahasuar me ato të parashikuara në marrëveshje, realizimi i komponentëve të projektit krahasuar me ato në marrëveshje si financiare ashtu dhe teknike, kontratat e zbatimit të punimeve si dhe administrimi i veprave të dorëzuara.

2. Përshkrimi i rezultateve sipas drejtimeve të auditimit

1. Marrëveshjet e financimit të projektit me huadhënësit, ndryshimet, shkaqet dhe argumentimi i ndryshimeve.

Për realizimin e projektit ÷Furnizimi me ujë i zonave rurale IIIö, janë nënshkruar 4 marrëveshje midis KfW-së Gjermane dhe Republikës së Shqipërisë, më konkretisht si më poshtë:

- Marrëveshja midis KfW-së dhe Republikës së Shqipërisë përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Fondit Shqiptar të Zhvillimit si Agjencia e Zbatimit të Projektit për marrjen e huas me vlerë 24,000,000 euro nënshkruar më datë 07.01.2015, për financimin e projektit me objekt Ujësjetësi Rural III. Marrëveshja për marrjen e huas 24,000,000 euro për financimin e projektit me objekt Ujësjetësi Rural III është ratifikuar me Ligjin nr. 97/2015, datë 17.05.2015. Sipas marrëveshjes së huas përcaktohet se KfW-ja do të japë huamarrësit një hua që nuk i kalon 24 milionë euro. Qëllimi i kësaj marrëveshje është që huamarrësi do të kanalizojë Huan plotësisht tek Agjencia e Zbatimit të Projektit. Agjencia e Zbatimit të Projektit do të përdorë Huan ekskluzivisht për rehabilitimin, rindërtimin ose ndërtimin e sistemeve të ujësjetësve rural dhe, nëse është e zbatueshme për masa plotësuese të ujërave të zeza në raste emergjencash. Huamarrësi e kanalizon Huan tek Agjencia e Zbatimit të Projektit si një Grant të pashlyeshëm sipas një marrëveshje të veçantë financimi.

Procedurat e disbursimit janë përcaktuar në bazë të nenit 3 të marrëveshjes, KfW-ja do të disbursojë Huan në pajtim me progresin e Projektit dhe me kërkesën e Agjencisë së Zbatimit të Projektit. KfW-ja nuk është e detyruar të kryejë disbursime në një shumë më të vogël se 500,000

euro. KFW-ja është e detyruar të kryejë disbursime vetëm me përmbushjen e kushteve në një formë dhe përmbajtje të pranueshme për KFW-në.

Huamarrësi do të ketë demonstruar në një formë të pranueshme për KFW-në, me anë të paraqitjes së një opinionioni ligjor që të jetë ligjërisht efektiv dhe i zbatueshëm dhe në veçanti:

Huamarrësi ka përmbushur të gjitha kërkesat sipas së drejtës së tij kushtetuese dhe dispozitave ligjore të tjera të zbatueshme për përmbushjen e vlefshme të të gjitha detyrimeve të tij.

KFW-ja është e përjashtuar nga të gjitha tatimet mbi të ardhurat nga interesi dhe të gjitha detyrimet, komisionet dhe kostot e ngjashme në Republikën e Shqipërisë për dhënien e Huas.

Garancia nga Republika Federale e Gjermanisë është në fuqi dhe efekt pa kufizim.

Huamarrësi, Agjencia e Zbatimit të Projektit dhe KFW-ja do të përcaktojnë detajet e procedurës së disbursimit nga Marrëveshja e Veçantë dhe në veçanti, të dhëna që duhet të jepen nga Agjencia e Zbatimit të Projektit të cilat dokumentojnë se shumat e Huas së kërkuar përdoren për qëllimin e rënë dakord. Huamarrësi mund të heqë dorë nga disbursimi i shumave të padisbursuara të Huas me pëlqimin e ndërsjellë të gjitha Palëve të kësaj Marrëveshjeje kundrejt pagesës së Kompensimit të Mospranimit në pajtim.

Huamarrësi do të paguajë një tarifë të pakthyeshme angazhimi prej 0.25% në vit për shumat e padisbursuara të Huas. Tarifa e Angazhimit është e kërkueshme për pagesën gjashtëmujore në shumat të prapambetura në datën 30 qershor dhe 30 dhjetor të çdo viti. Huamarrësi do t'i paguajë KFW-së një tarifë të përgjithshme, të njëhershme dhe të pakthyeshme menaxhimi të barabartë me 1% të shumës së Huas.

U konstatua se për këtë marrëveshje është kryer amendim më datë 28.02.2019, ku KFW dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë kanë rënë dakord për shtyrjen e afatit të disbursimit deri në datën 30.06.2021.

- Marrëveshja midis KFW-së dhe Republikës së Shqipërisë përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Fondit Shqiptar të Zhvillimit si Agjencia e Zbatimit të Projektit për dhënien e një kontributi financiar me vlerë 9,803,922 euro për rehabilitimin, rindërtimin ose ndërtimin e sistemeve të ujësjellësve ruralë dhe nëse është e zbatueshme, për masat plotësuese mbi ujërat e zeza në raste emergjente, nënshkruar më datë 07.01.2015. Marrëveshja për dhënien e një kontributi financiar me vlerë 9,803,922 euro për rehabilitimin, rindërtimin ose ndërtimin e sistemeve të ujësjellësve ruralë është ratifikuar me Ligjin nr. 35/2015, datë 09.04.2015.

Sipas marrëveshjes përcaktohet se KFW-ja do t'i japë marrësit një kontribut financiar që nuk tejkalon shumën 9,803,922 euro, ky kontribut financiar nuk është i shlyeshëm. Marrësi ia kanalizon plotësisht kontributin financiar agjencisë së ekzekutimit të Projektit në përputhje me kushtet e përcaktuara në nenin 2. Agjencia e Zbatimit të Projektit përdor kontributin financiar ekskluzivisht për rehabilitimin, rindërtimin ose ndërtimin e sistemeve të ujësjellësve ruralë dhe nëse është e zbatueshme, për masa plotësuese mbi ujërat e zeza në raste emergjente.

Taksat dhe tarifat e tjera publike që do të përballohen nga Marrësi ose Agjencia e Zbatimit të Projektit dhe tatimet e importit nuk financohen nga kontributi financiar. Marrësi ia kanalizon kontributin financiar Agjencisë së Zbatimit të Projektit si një grant të pashlyeshëm sipas një marrëveshjeje të veçantë financimi.

KFW-ja do të disbursojë kontributin financiar në përputhje me progresin e Projektit dhe me kërkesë të Agjencisë së Zbatimit të Projektit. Me anë të një marrëveshjeje të veçantë, Agjencia e Zbatimit të Projektit dhe KFW-ja do të përcaktojnë procedurën e disbursimit, në veçanti të dhënat që provojnë se fondet e disbursuara përdoren për qëllimin e përcaktuar.

KFW-ja nuk mund të pezullojë disbursimet nëse: Marrësi i ka përmbushur detyrimet e tij ndaj KFW-së për kryerjen e pagesave kur bëhen të kërkueshme, Agjencia e Zbatimit të Projektit nuk

mund të provojë se kontributi financiar është përdorur për qëllimin e caktuar, linden rrethana të jashtëzakonshme që përjashtojnë ose rrezikojnë seriozisht zbatimin, operimin ose qëllimin e Projektit, etj.,

Referuar nenit 5 të marrëveshjes, Marrësi do të përballojë të gjitha taksat dhe tarifatat e tjera publike që shtohen jashtë Republikës Federale të Gjermanisë mbi lidhjen dhe ekzekutimin e kësaj Marrëveshjeje, si dhe të gjitha kostot e transferimit dhe shkëmbimit që shtohen në lidhje me disbursimin e kontributit financiar.

U konstatua se për këtë marrëveshje është kryer amendim, ku KFW dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë kanë rënë dakord për shtyrjen e periudhës së zbatimit deri më datë 19.02.2022.

- Marrëveshja midis KFW-së dhe Republikës së Shqipërisë përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Fondit Shqiptar të Zhvillimit si Agjencia e Zbatimit të Projektit për dhënien e një kontributi financiar me vlerë 1,500,000 euro për masat shoqëruese të projektit si dhe fushat e informimit dhe sensibilizimit dhe trajnimet e operatorëve, nënshkruar më datë 07.01.2015. Marrëveshja për dhënien e një kontributi financiar me vlerë 1,500,000 euro për masat shoqëruese të projektit si dhe fushat e informimit dhe sensibilizimit dhe trajnimet e operatorëve është ratifikuar me Ligjin nr. 36/2015, datë 09.04.2015.

Me anë të kësaj marrëveshjeje KFW-ja i jep Marrësit një kontribut financiar që nuk i kalon 1,500,000 euro, ky kontribut financiar nuk është i shlyeshëm. Marrësi e kanalizon kontributin financiar plotësisht në Agjencinë e Zbatimit të Programit në pajtim me kushtet e parashikuara në nenin 2. Agjencia e Zbatimit të Projektit e përdor kontributin financiar ekskluzivisht për Masat Shoqëruese të projektit si fushatat e informimit dhe sensibilizimit dhe trajnimet e operatorëve. Agjencia e Zbatimit të Projektit dhe KFW-ja përcakton hollësitë e Projektit dhe mallrat dhe shërbimet që duhet të financohen nga kontributi financiar me marrëveshje të veçantë. Tatimet dhe detyrimet e tjera publike që duhet të mbulohen nga Marrësi ose Agjencia e Zbatimit të Programit dhe detyrimet e importit nuk financohen nga kontributi financiar.

Referuar nenit 3, të marrëveshjes së nënshkruar përcakton se KFW-ja e livron kontributin financiar në pajtim me progresin e Projektit dhe me kërkesë të Agjencisë së Zbatimit të Projektit. Me marrëveshje të veçantë, Agjencia e Zbatimit të Projektit dhe KFW-ja përcaktojnë për procedurën e disbursimit, veçanërisht për provat e vërtetimit që fondet e disbursuara janë përdorur për këtë qëllim të parashikuar. KFW-ja ka të drejtën e refuzimit të kryerjes së disbursimeve pas datës 30.06.2019.

Pezullimi i disbursimeve dhe shlyerja përcaktohet specifikisht në nenin 4, KFW-ja nuk mund të pezullojë disbursimet, përveç kur:

Marrësi nuk përmbush detyrimet e tij ndaj KFW-së për të kryer pagesat kur bëhen të kërkueshme.

Detyrimet sipas kësaj Marrëveshjeje, Marrëveshjes së Projektit dhe Huas së datës, Marrëveshjes së Financimit dhe Projektit ose sipas marrëveshjeve të veçanta që i përkasin kësaj Marrëveshjeje, janë shkelur.

Agjencia e Zbatimit të Projektit nuk mund të provojë që kontributi financiar është përdorur për qëllimin e parashikuar; ose

Dalën rrethana të jashtëzakonshme që pengojnë ose rrezikojnë seriozisht zbatimin, operimin ose qëllimin e Projektit.

Marrësi mbulon të gjitha tatimet dhe detyrimet e tjera publike që mbledhen jashtë Republikës Federale të Gjermanisë mbi lidhjen dhe zbatimin e kësaj Marrëveshjeje, si dhe të gjitha kostot e transfertave dhe konvertimit që linden në lidhje me disbursimin e kontributit financiar.

U konstatua se për këtë marrëveshje është kryer amendim më datë 29.01.2021, ku KFW dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë kanë rënë dakord për shtyrjen që KFW rezervon të drejtën për të mohuar disbursimet pas datës 30.12.2022.

- Marrëveshja midis KFW-së dhe Republikës së Shqipërisë përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Fondit Shqiptar të Zhvillimit si Agjencia e Zbatimit të Projektit për dhënien e një kontributi financiar me vlerë 670,000 euro për përgatitjen e projektit dhe studimeve të fizibilitetit për ndërtim/rindërtimin e sistemeve të ujësjellësve në zonat rurale nënshkruar më datë 22.10.2015. Marrëveshja për dhënien e një kontributi financiar me vlerë 670,000 euro për përgatitjen e projektit dhe studimeve të fizibilitetit për ndërtim/rindërtimin e sistemeve të ujësjellësve në zonat rurale është ratifikuar me Ligjin nr. 116/2015, datë 22.10.2015.

KFW-ja do t'i japë Përfituesit një Kontribut Financiar që nuk kalon shumë prej 670,000 euro, duke përfshirë çdo shumë paradhënieje, ky Kontribut Financiar nuk është i kthyeshëm. Sipas Marrëveshjes së Zbatimit, llogaritë e mëposhtme janë zbritur nga Granti prej 750,000 euro i Kornizës Investuese për Ballkanin Perëndimor: Pagesa e KFW-së për shërbimet e saj si Institucion Financiar Ndërkombëtar Drejtues, në shumën prej 30,000 euro.

Kostoja e Auditimit e shpenzuar nga KFW-ja në përputhje me kërkesat e auditimit të jashtëm vjetor të llogarisë së Grantit WBIF të administruar nga KFW-ja sipas nenit 6, që pritet të arrijë shumën prej 25,000 euro dhe që për të cilën KFW do të rimbursohet nga fondet e granteve.

Pagesa e shërbimeve të Agjentit të Tenderit që pritet të arrijë shumën 25,000 euro dhe për të cilën KFW-ja do të rimbursohet nga fondet e Grantit.

Përfituesi e kanalizon Kontributin Financiar plotësisht tek Agjencia e Zbatimit të Projektit në pajtim me kushtet e përcaktuara, Agjencia e Zbatimit të Projektit e përdor Kontributin Financiar vetëm për: përgatitjen e projektit dhe studimet e fizibilitetit për ndërtimin ose rindërtimin e sistemit të ujësjellësve në zonat rurale. Agjencia e Zbatimit të Projektit dhe KFW-ja përcaktojnë hollësitë e Projektit dhe mallrat dhe shërbimet që financohen nga Kontributi Financiar me marrëveshje të veçantë. Tatimet dhe detyrimet e tjera publike mbulohen nga Përfituesi ose Agjencia e Zbatimit të Programit dhe detyrimet e importit nuk financohen nga Kontributi Financiar. Përfituesi e kanalizon Kontributin Financiar tek Agjencia e Zbatimit të Projektit si një Grant të pakthyeshëm sipas një marrëveshjeje të veçantë financimi, Kanalizimi i Kontributit Financiar nuk përbën ndonjë detyrim për Agjencinë e Zbatimit të Projektit ndaj KFW-së për detyrime pagese.

KFW-ja e disburson Kontributin Financiar në pajtim me ecurinë e Projektit dhe me kërkesë të Agjencisë së Zbatimit të Projektit. Nëpërmjet një marrëveshjeje të veçantë, Agjencia e Zbatimit të Projektit dhe KFW-ja bien dakord për procedurën e disbursimit, veçanërisht për provat që vërtetojnë se fondet e disbursuara nga Kontributi Financiar janë përdorur për qëllimin e parashikua.

Përfituesi do të mbulojë të gjitha taksat dhe detyrime të tjera publike, që krijohen jashtë Republikës Federale të Gjermanisë, në lidhje me arritjen dhe zbatimin e kësaj Marrëveshjeje, si dhe kostot e transfertave dhe konvertimeve që lindin në lidhje me disbursimin e Kontributit Financiar.

Për sa trajtuar më sipër është mbajtur Akt konstatimi 3, nr. 1882/4 prot., datë 30.07.2021

2. Mbi shkallën e realizimit të objektivave dhe të komponentëve të projektit në krahasim me ato të përcaktuara në marrëveshjet me huadhënësit.

2.1. Mbi ndjekjen e procedurave ligjore në hartimin e objektivave dhe komponentëve të marrëveshjes së financimit.

2.2. Mbi zbatimin e rregullave për përzgjedhjen e skemave.

2.3. Mbi shkallën e realizimit të objektivave dhe komponentëve të projektit në krahasim me ato të përcaktuara në marrëveshjet e me huadhënësit.

2.4. Mbi respektimin e afateve të përcaktuara në marrëveshjet e financimit, për realizimin e objektivave të projektit.

1. Titulli i gjetjes: Mungesë e furnizimit me ujë 24 orë.

Situata:

Nga verifikimi në terren konstatohet se objektivi i përcaktuar në marrëveshjet midis KFW dhe Qeverisë Shqiptare i cili është furnizimi me ujë të pijshëm 24 orë nuk është arritur në të gjitha zonat. Më konkretisht në qytetin e Peshkopisë, fshati Çetush, u konstatua se ky fshat nuk ka furnizim me ujë të pijshëm 24 orë, konstatim i cili u konfirmua edhe nga banorët e fshatit gjatë verifikimit në terren. Gjithashtu gjatë auditimit të investimit në Depon e ujit të pijshëm në këtë fshat u konstatua se depo ishte e boshatisur dhe furnizimi me ujë të pijshëm për këtë fshat bëhej me orare të kufizuara. Nga verifikimi në terren në datën 18.06.2021, për investimin e kryer në zonën e qytetit Durrës, më konkretisht në fshatin Katundi i Ri ku ndodhen 2 depo ujë të pijshëm të cilat furnizojnë me ujë të pijshëm disa fshatra siç janë Katundi i ri, Jubë, Qerret, Katund Sukth dhe Lagje e Mirditorëve, u konstatua se të 2 depot e ujit ishin të boshatisura dhe furnizimi me ujë të pijshëm në fshatrat e lartpërmendura kryhet me orare të kufizuara dhe jo 24 orë në ditë siç është e përcaktuar në Marrëveshjen e Huas ratifikuar me Ligjin nr. 97/2015, datë 17.05.2015, për projektin ÷Furnizimi me ujë i zonave rurale IIIö, si dhe Manuali Operacional i Projektit, Seksioni 2, pika 2.1.

Kriteri:

Marrëveshja e Huas ratifikuar me Ligjin nr. 97/2015, datë 17.05.2015, për projektin ÷Furnizimi me ujë i zonave rurale IIIö, si dhe Manuali Operacional i Projektit, Seksioni 2, ÷Korniza e Zbatimit të Programit RWSö, pika 2.1, ÷Korniza Logjike e Programitö, ku përcaktohet se: *“Fshatrat përfitues kanë një furnizim të vazhdueshëm dhe të mjaftueshëm (24 orë në ditë dhe 100 l/c/d) me cilësi të ujit të pijshëm sipas standardeve të OBSH-së”*.

Shkaku:

Mos furnizimi i depove 24 orë me ujë ka sjell për pasojë mungesë të furnizimit të fshatrave të lartë përmendura. Gjithashtu një faktor tjetër për mungesën e furnizimit me ujë është edhe përdorimi i ujit për vaditje.

Ndikimi/Efekti:

Mungesë e furnizimit me ujë 24 orë i banorëve siç është përcaktuar në projektin e financuar nga KFW.

Rëndësia:

E lartë.

Rekomandimi:

- Fondi Shqiptar i Zhvillimit në bashkëpunim me Institucionet Vendore të evidentojnë mangësitë në sistemet dhe impiantet hidraulike të furnizimit me ujë për zonat përkatëse me qëllim realizimin e furnizimit

me ujë pa ndërprerje për këto zona.

-Fondi Shqiptar i Zhvillimit të marrë masat që në të ardhmen të angazhohet maksimalisht në rankimin e zonave ku do të investohet për projektet e ngjashme të furnizimit me ujë 24 orë, me qëllim që në ato zona burimet natyrore të ujit në sasi dhe cilësi furnizim të ujit duke pasur parasysh furnizimin me vetërrjedhje, për pasojë uljen e kostos së furnizimit me ujë për banorët.

Më hollësisht rezultatet e auditimit paraqiten si më poshtë:

Me Ligjin nr. 97/2015, datë 17.05.2015, Ligjin nr. 35/2015, datë 09.04.2015, Ligjin nr. 36/2015, datë 09.04.2015 dhe Ligjin nr. 116/2015, datë 22.10.2015, janë ratifikuar marrëveshjet për projektin Ujësjiellësi Rural III, financuar nga KFW. Qëllimi i kësaj marrëveshje është që huamarrësi do të kanalizojë Huan plotësisht tek Agjencia e Zbatimit të Projektit. Agjencia e Zbatimit të Projektit do të përdorë Huan ekskluzivisht për rehabilitimin, rindërtimin ose ndërtimin e sistemeve të ujësjiellësve rural dhe, nëse është e zbatueshme për masa plotësuese të ujërave të zeza në raste emergjencash.

Në projekt programin e miratuar në këtë marrëveshje është rënë dakord nga palët si më poshtë vijon:

Programi trajton rehabilitimin, rindërtimin ose ndërtimin e sistemeve të ujësjiellësve ruralë dhe nëse është e zbatueshme, shërbimet bazë të kanalizimeve të ujërave të zeza. Qëllimi i projektit të financuar është furnizimi me ujë të pijshëm 24 orë pa ndërprerje. Projekti përfshin të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, nga auditimi u evidentua se përfitues nga projekti janë Bashkia Dibër, Klos, Tropojë, Mat, Vlorë, Himarë, Lushnje, Ura Vajgurore, Durrës, Tiranë, Korçë, Devoll dhe Përrenjas.

Qëllimi i Projektit të Financimit është ndërtimi ose rindërtimi i ujësjiellësve rural me rrjedhje të lirë. Programi do të kontribuojë në përmirësimin e qëndrueshëm të kushteve të jetesës të popullsisë rurale në rajonet e programit. Kriteret për arritjen e këtyre objektivave, rezultatet e programit dhe aktivitetet e kërkuara të programit.

Objektivi i Programit sipas marrëveshjes

Rehabilitimi ose rindërtimi i rrjetit të rrugëve rurale si dhe akses i përmirësuar dhe i qëndrueshëm në ujin e pijshëm të sigurt nëpërmjet rehabilitimit të ndërtimit dhe rindërtimit të skemave të ujësjiellësve rural me rrjedhje të lirë në tarifa që mbulojnë kostot e pranuar nga pikëpamja sociale.

- Treguesit për tu realizuar për investimet në ujësjiellësit,

Furnizim i vazhdueshëm 24 orë në ditë me ujë të pijshëm dhe brenda standardeve të miratuara nga Organizata Botërore e Shëndetësisë, me ujë të pijshëm në fshatrat pjesëmarrëse në program.

Mbulimi i kostove rrjedhëse, duke përfshirë mirëmbajtjen e duhur të skemave të ujësjiellësve.

- Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion u konstatua se, janë nënshkruar me Bashkitë respektive certifikatat e marrjes së përkohshme në dorëzim të punimeve si dhe marrëveshjet e funksionimit të mirëmbajtjes për Lotet 1, 2 dhe 4. Ndërsa për Lotin 3 nuk është nënshkruar certifikata e marrjes së përkohshme në dorëzim të punimeve dhe marrëveshja e funksionimit të mirëmbajtjes.

- Nga auditimi u konstatua se Studimi i fizibilitetit i muajit mars të vitit 2017, i përgatitur nga konsulenti òP. a. P. C. E.ò përfshin të gjitha rajonet e Republikës së Shqipërisë, ndërkohë që

referuar Manualit Operacional të Projektit, Programi RWS III është faza e implementimit të projektit dhe përfshin si më poshtë:

- Tenderimin dhe lidhjen e kontratës për Projektim dhe Mbikëqyrje.
- Konsultime me komunitetin, rritja e ndërgjegjësimit dhe mobilizim.
- Ndërtimi/Rehabilitimi i skemave RWS.

Ndërsa RWS II përfshinte studimin e fizibilitetit për projektin dhe përzgjedhjen e cila ka pasur në fokus Rajonin Verior të Republikës së Shqipërisë. Gjatë auditimit është evidentuar se, nuk është dokumentuar mënyra se si ka ndodhur zgjerimi i programit në të gjithë rajonin e Republikës së Shqipërisë.

Nga verifikimi në terren konstatohet se, objektivi i përcaktuar në marrëveshjet midis KFW dhe Qeverisë Shqiptare i cili është furnizimi me uji të pijshëm 24 orë nuk është arritur në të gjitha zonat. Më konkretisht në qytetin e Peshkopisë, fshati Çetush, u konstatua se ky fshat nuk ka furnizim me ujë të pijshëm 24 orë, konstatim i cili u konfirmua edhe nga banorët e fshatit gjatë verifikimit në terren. Gjithashtu gjatë auditimit të investimit në Depon e ujit të pijshëm në këtë fshat u konstatua se depo ishte e boshatisur dhe furnizimi me uji të pijshëm për këtë fshat bëhej me orare të kufizuara. Nga verifikimi në terren më datën 18.06.2021, për investimin e kryer në zonën e qytetit Durrës, më konkretisht në fshatin Katundi i Ri ku ndodhen 2 depo uji të pijshëm të cilat furnizojnë me ujë të pijshëm disa fshatra siç janë Katundi i ri, Jubë, Qerret, Katund Sukth dhe Lagje e Mirditorëve u konstatua se, të 2 depot e ujit ishin të boshatisura dhe furnizimi me uji të pijshëm në fshatrat e lartë përmendura kryhet me orare të kufizuara dhe jo 24 orë në ditë siç është e përcaktuar në projekt.

Për sa trajtuar më sipër është mbajtur Akt konstatimi 4, nr. 1882/5 prot., datë 30.07.2021

3. Mbi menaxhimin financiar të projektit, shkallën e realizimit të disbursimeve financiare të fondeve kundrejt nivelit të programuar. Raportimi i tyre në Ministrinë e Financave.

3.1. Mbi ndjekjen e procedurave ligjore në menaxhimin financiar të projektit.

3.2. Mbi realizimin e disbursimeve të projektit, në krahasim me disbursimet e planifikuara.

3.3. Mbi ndjekjen e procedurave ligjore për raportimet financiare dhe jo financiare.

1. Titulli i gjetjes: Amendime për ndryshimin e afateve të disbursimeve jo në zbatim të angazhimeve të marrëveshjeve të financimit.

Situata: Gjatë periudhës së zbatimit të Projektit, Marrëveshjet e Financimit me dakortësinë e palëve janë ndryshuar (amenduar) në lidhje me afatet e disbursimeve të fondeve konkretisht:

-Më datë 28.02.2019, midis KfW-së Gjermane dhe MFE-së është kryer amendimi i Marrëveshjes së Huas me nr. 201166370, të ratifikuar me Ligjin nr. 97/2015, datë 17.09.2015, me objekt shtyrjen e afatit të disbursimeve nga data 30.06.2019, deri më 30.06.2021.

- Më datë 27.01.2020, midis KfW-së Gjermane dhe MFE-së është kryer amendimi i Marrëveshjes së Financimit me nr. 202061133, të ratifikuar me Ligjin nr. 35/2015, datë 09.04.2015, me objekt shtyrjen e afatit të disbursimeve nga data 30.06.2019, deri më datë 19.02.2022.

- Më datë 29.01.2021, midis KfW-së Gjermane dhe MFE-së është kryer amendimi i Marrëveshjes së Financimit me nr. 201470137, të ratifikuar me Ligjin nr. 36/2015, datë 09.04.2015, me objekt shtyrjen e afatit të disbursimeve nga data 30.06.2019, deri më datë 30.12.2022.

Në zbatim të nenit 3, pika 3.2, të marrëveshjeve të financimit respektivisht me nr. 202061133, dhe nr. 201470137, afati përfundimtar për kryerjen e disbursimeve është data 30.06.2019. Amendimet për ndryshimin/shtyrjen e afateve të disbursimeve janë bërë me shkresat e datës 27.01.2020, dhe datës 29.01.2021. Nga auditimi konstatohet se, disbursimet kanë vazhduar edhe pas datës 30.06.2019, në kushtet kur midis palëve nuk është dakordësuar amendim për ndryshimin e afateve për disbursimin e fondeve. Referuar shkresave të sipërpërmendura amendimet janë kryer pas 7 muajve për Marrëveshjen e Financimit me nr. 202061133, dhe pas 19 muajve për Marrëveshjen e Financimit me nr. 201470137.

Kriteri: Marrëveshjet e Financimit të ratifikuara respektivisht me Ligjin nr. 35/2015, datë 09.04.2015, dhe Ligjin nr. 36/2015, datë 09.04.2015, për projektin òFurnizimi me ujë i zonave rurale IIIö, nenet 8, pika 8.5, të secilës marrëveshjeje.

Shkaku: Mungesa e vëmendjes kushtuar hartimit dhe ndryshimit të akteve ligjore të projektit.

Ndikimi/Efekt: Bëhet precedent për miratimin, ndryshimin e afateve të disbursimeve jo në kohë reale në të ardhmen.

Rëndësia: E mesme.

Rekomandimi: Fondi Shqiptar i Zhvillimit/Njësia e Menaxhimit të Projektit, në vijim të zbatimit të projektit òFurnizimi me ujë i zonave rurale IIIö si dhe për të gjitha projektet të cilat do të menaxhohen në të ardhmen nga FSHZH, të

marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat administrative për informimin e MFE në cilësinë e përfaqësuesit të Qeverisë Shqiptare për përfundimin e afateve të disbursimeve financiare referuar marrëveshjeve të financimit në kushtet që nga MFE dhe donatorët të kryen amendimet në kohë reale.

- 2. Titulli i gjetjes:** Mos pasqyrim i saktë i pagesave për TVSH-në në pasqyrat financiare.
- Situata:** Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion në lidhje me likuidimin e TVSH-së nga Qeveria Shqiptare, referuar kontratës të datës 26.02.2019, ndërmjet FSHZH-së dhe O. J. òT. E.ò & òS.ò me objekt òNdërtimi i sistemit të ri të ujësjetllësit dhe furnizimin me ujë 24 orë për 15,883 banorë, Lot 1ò në vlerën 8,601,883 euro pa TVSH konstatohet se:
- Për situacionin e punimeve nr. 6, të kontratës të sipërpërmendur OE ka lëshuar faturën tatimore seria 77032493, nr. 42, datë 29.06.2020, në shumën 795,398 euro me TVSH. Për këtë faturë, TVSH-ja është në shumën 132,566.48 euro konvertuar sipas kursit të Bankës së Shqipërisë (1 euro këmbëhet me 124.77 lekë) ose në shumën 16,474,036.47 lekë. Likuidimi i TVSH për këtë faturë është kryer me Urdhër Shpenzimin nr. 108/1, datë 07.07.2020, në shumën 16,747,036 lekë me një diferencë më tepër në shumën 273,000 lekë në favor të OE J. òT. E.ò & òS.ò. Kjo problematikë është bërë me dije përfaqësuesve të FSHZH-së më datë 28.06.2021, ku më datë 29.06.2021, janë kryer veprimet rregulluese në R. Bankë sipas transaksionit me referencë nr. P210629EUPOP08, datë 29.06.2021, ku OE ka arkëtuar në llogari të FSHZH-së shumën 273,000 lekë. Pavarësisht kthimit të shumës nga OE, në pasqyrat financiare të vitit 2020, regjistrimi i kësaj pagese nuk është kryer në përputhje me vlerën e saktë të përcaktuar në faturën tatimore.
- Kriteri:** Ligji nr. 9228, datë 29.04.2004, òPër kontabilitetin dhe pasqyrat financiareò i ndryshuar, si dhe neni 48, të Ligjit nr. 92/2014, datë 24.07.2014, òPër tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisëò i ndryshuar.
- Shkaku:** Kjo situatë vjen si pasojë e mos respektimit të legjislacionit përkatës në fuqi.
- Ndikimi/Efekti:** Regjistrim jo i saktë në pasqyrat financiare me pasojë fshehjen e detyrimeve të institucionit në të ardhmen duke ndikuar negativisht në bilancet vjetore.
- Rëndësia:** E lartë.
- Rekomandimi:** Fondi Shqiptar i Zhvillimit/Departamenti i Financës në pasqyrat financiare të vitit 2021 të kryejë sistemimin e vlerës 273,000 lekë, vlerë e cila ka të bëjë me regjistrimin e gabuar të likuidimit të TVSH-së për situacionin e punimeve nr. 6, për kontratën e zbatimit të punimeve Lot 1 të lidhur midis OE J. òT. E.ò & òS.ò dhe FSHZH, për Projektin òFurnizimi me ujë i zonave rurale IIIò duke u bazuar në Urdhër Shpenzimin nr. 108/1, datë 07.07.2020, referuar sistemit të trajtimit kontabël dhe funksionimit të llogarive të grupit 23 òInvestime në

procesö, si dhe të bëhen rakordimet me Degën e Thesarit Tiranë.

3. Titulli i gjetjes: Likuidimi i pagesave të rimbursueshme pa dokumentacionin e plotë shoqërues.

Situata: Bazuar në kontratën e datës 09.11.2015, ndërmjet FSHZH-së dhe OE òP. & P.ò me objekt òPërgatitjen e projektit dhe studimet e fizibilitetitò në vlerën 663,070 euro pa TVSH, likuidimi i pagesave të rimbursueshme është kryer referuar aplikimit nr. 6, datë 19.06.2017, disbursuar respektivisht në shumën 9,542.64 euro nga KfW-ja Gjermane dhe shumën 153,609 lekë nga Qeveria Shqiptare me Urdhër Shpenzimin nr. 127, datë 04.07.2017, sipas faturës tatimore nr. 12, datë 01.06.2017. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion konstatohet se, për katër raste si më poshtë:

- Fatura tatimore nr. 119, datë 23.03.2016, në shumën 17,500 lekë me TVSH me objekt òWork Shop akomodim në hotel G. K., marrje salle me qiraò.

- Fatura tatimore nr. 352, datë 25.03.2016, në shumën 33,600 lekë me TVSH me objekt òShërbim aktiviteti dhe shërbim kafeje Sh.ò.

- Fatura tatimore nr. 141, datë 18.03.2016, në shumën 18,000 lekë me TVSH me objekt òWork Shop akomodim në H. G. T.ò.

- Fatura tatimore nr. 19, datë 29.03.2016, në shumën 17,000 lekë me TVSH me objekt òShërbim kateringù në E. M. V.ò.

Urdhër shpenzimet për likuidimit e faturave të mësipërme nuk kanë të bashkëlidhur dokumentacionin e plotë shoqërues, konkretisht, listat e nënshkuara nga personat të cilët kanë qenë pjesëmarrës në këto aktivitete, veprime këto jo sipas përcaktimeve të Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011, òPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikò i ndryshuar, pika 36.

Kriteri: Pika 36, e Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011, òPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikò i ndryshuar.

Shkaku: Mos respektim i legjislacionit përkatës në fuqi.

Ndikimi/Efekti: Bëhet precedent për likuidime fiktive në të ardhmen pa dokumentacion shoqërues.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandimi: Fondi Shqiptar i Zhvillimit/Departamenti i Financës dhe Menaxheri i Projektit, të marrin masa të menjëhershme për plotësimin me përgjegjësi të dokumentacionit shoqërues për këtë praktikë dhe për të gjitha praktikatat e tjera në vazhdim në zbatim të kuadrit rregullator ligjor në fuqi.

4. Titulli i gjetjes: Detyrime nga NJVV drejt FSHZH-së mbi mbulimin me financim të Kontributit Lokal.

Situata: Bazuar, në angazhimet e përcaktuara në Marrëveshjet e Financimit të donatorëve përkatës, në Manualin Operacional të Projektit dhe në Marrëveshjet Përfundimtare të Investimit, NJVV të cilat përfitojnë nga ky Projekt, kanë detyrimin të financojnë në formë kontributi një pjesë të

fondeve të projektit. Kështu gjatë implementimit të projektit për periudhën nga data 01.01.2016, deri më 30.06.2021, disa nga këto NJVV kanë derdhur kontributet e tyre në arkën e FZSHH shumën totale 308,963,708 lekë. Ndërsa nëntë NJVV nuk kanë shlyer ende detyrimin në shumën 89,425,931 lekë për Kontributin Lokal në llogari të FSHZH-së (shiko listën në tabelën nr. 9, pikën nr. 3, të Raportit të Auditimit). Kjo situatë ka ndodhur si pasojë e mos respektimit të afatit për derdhjen e detyrimeve referuar Marrëveshjes Përfundimtare të Investimit të lidhur me NJVV respektive neni 3, pikat 3.1, 3.2, dhe 3.3, ku përcaktohet se:

- Të plotësojë kontributin total financiar në vlerën 10% të çmimit të Kontratës të Punimeve.

- Të rrisë pjesëmarrjen e Përfituesve të drejtpërdrejtë duke i nxitur ata të paguajnë të paktën 2% të Kontributit të Përfituesit.

- Të paguajnë pjesën e mbetur të Kontributit të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore, para nënshkrimit të Kontratës të Punimeve, kjo e llogaritur mbi çmimin e Kontratës së Punimeve dhe të pagesave të kryera në numrin e llogarisë bankare të FSHZH.

Kriteri: Manuali Operacional i Projektit dhe Marrëveshjet Përfundimtare të Investimit ndërmjet Bashkive përfituese nga projektit dhe FSHZH-së neni 3, pikat 3.1, 3.2, dhe 3.3.

Shkaku: Nuk janë respektuar detyrimet e përcaktuara në Manualin Operacional të Projektit Marrëveshjet Përfundimtare dhe Investimit.

Ndikimi/Efekti: Detyrime në shumën 89,425,931 lekë të cilat kanë NJVV ndaj FSHZH-së për Kontributin Lokal.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandimi: Fondi Shqiptar i Zhvillimit/Njësia e Menaxhimit të Projektit të marrin të gjitha masat e nevojshme duke ndjekur të gjitha rrugët procedurale dhe administrative për mbledhjen e detyrimeve/Kontributin Lokal në shumën 89,425,931 lekë nga NJVV përfituese të projektit të cilat janë debitorë ndaj FSHZH-së, në zbatim të përcaktimeve të Marrëveshjes Përfundimtare të Investimit.

5. Titulli i gjetjes: Raportim jashtë afateve mbi realizimin e disbursimeve.

Situata: Raportimet për realizimin e disbursimeve dhe shpenzimeve për periudhën nga data 01.01.2016, deri më 30.05.2021, janë dorëzuar në MFE-së, ku në përgjithësi janë kryer mbi bazën e dispozitave ligjore përkatëse por konstatohet se, në 11 raste konkretisht për muajin shkurt, maj, qershor, dhjetor 2016, janar, shkurt, qershor, dhjetor 2017, dhjetor 2018, dhjetor 2019, dhjetor 2020, nga FSHZH nuk janë respektuar afatet mbi raportimin e realizimit të disbursimeve në MFE-së sipas përcaktimeve të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 8, datë 17.02.2003, òPër evidencimin, regjistrimin, përdorimin dhe raportimin e financimeve të huaja në kuadrin e projekteve dhe marrëveshjeve me donatorët e huajë, pika 5.5.

Kriteri: Pika 5.5, e Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 17.02.2003, òPër evidencimin, regjistrimin, përdorimin dhe

	raportimin e financimeve të huaja në kuadrin e projekteve dhe marrëveshjeve me donatorët e huajë.
Shkaku:	Kjo situatë vjen si pasojë e mos respektimit të legjislacionit përkatës në fuqi.
Ndikimi/Efekti:	Mos paraqitje e të dhënave mbi realizimin e disbursimeve financiare dhe shpenzimeve në kohë reale.
Rëndësia:	E mesme.
Rekomandimi:	Fondi Shqiptar i Zhvillimit/Departamenti i Financës të marrë masa që të raportojë në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë realizimin e disbursimeve financiare dhe shpenzimeve të Projektit brenda afateve të parashikuara në kuadrin rregullator ligjor përkatës.

Më hollësisht rezultatet e auditimit paraqiten si më poshtë:

3.1. Mbi ndjekjen e procedurave ligjore në menaxhimin financiar të projektit.

Ky projekt financohet me fondet e Bankës Gjermane për Zhvillim KFW-së, Bashkimit Evropian përmes programit IPA dhe Qeverisë Shqiptare, nëpërmjet FSHZH-së në cilësinë e Agjencisë Zbatuese të Projektit.

Për sigurimin e këtyre fondeve rezulton se, janë lidhur katër marrëveshje me KFW-në Gjermane në shumën 35,973,922 euro (në formë grantesh në shumën 11,973,922 euro + hua në shumën 24,000,000 euro) dhe Kontribut Lokal në shumën 4,000,000 euro duke u bazuar në Manualin Operacional të Projektit dhe Marrëveshjen Përfundimtare të Investimit ndërmjet Bashkive pjesë të skemës së projektit dhe FSHZH-së, ku totali shkon në shumën 39,973,922 euro. Për sa i përket TVSH-së likuidimi do të kryhet nga Qeveria Shqiptare.

Në mënyrë analitike paraqiten të ardhurat nga donatori referuar marrëveshjeve si më poshtë:

1. Me Ligjin nr. 35/2015, datë 09.04.2015, është ratifikuar Marrëveshja e Financimit dhe Projekti me nr. 202061133, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe KFW-së Gjermane për fondet IPA të Bashkimit Evropian për projektin ÷Furnizimi me ujë i zonave rurale IIIö, me një grant në shumën 9,803,922 euro.

2. Me Ligjin nr. 36/2015, datë 09.04.2015, është ratifikuar Marrëveshja e Financimit dhe Projekti me nr. 201470137, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe KFW-së Gjermane për masat shoqëruese për projektin ÷Furnizimi me ujë i zonave rurale IIIö, me një grant në shumën 1,500,000 euro.

3. Me Ligjin nr. 97/2015, datë 17.09.2015, është ratifikuar Marrëveshja e Huas me nr. 201166370, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe KFW-së Gjermane për projektin ÷Furnizimi me ujë i zonave rurale IIIö, me një hua në shumën 24,000,000 euro.

Referuar angazhimeve të përcaktuara në marrëveshjet e sipërpërmendura projekti (faza e tretë) duhej të fillonte zbatimin/implementimin e tij në vitin 2015 (afat i cili përkon edhe me ratifikimin e marrëveshjeve) por duke qenë se në këtë financim nuk parashikohen fonde për ÷Përgatitjen e projektit dhe studime fizibilitetiö, u arrit dakordësia midis dy palëve duke u nënshkruar edhe marrëveshja e katërt e projektit konkretisht:

4. Me Ligjin nr. 116/2015, datë 22.10.2015, është ratifikuar Marrëveshja e Financimit dhe Projekti me nr. 202061695, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe KFW-së Gjermane për ÷Përgatitjen e projektit dhe studime të fizibilitetit për ndërtimin/rindërtimin e sistemeve të furnizimit me ujë në zonat ruraleö, me një grant në shumën 670,000 euro.

Në kushte të tilla projekti ka nisur zbatimin e tij, duke u bërë efektive Marrëveshja e Financimit dhe Projekti me nr. 202061695, e ratifikuar me Ligjin nr. 116/2015, datë 22.10.2015, me nënshkrimin e kontratës me objekt òPërgatitjen e projektit dhe studime të fizibilitetit për ndërtimin/rindërtimin e sistemeve të furnizimit me ujë të zonave rurale, me BOE òP. & P.ò SHPK më datë 09.11.2015, ku disbursimi i parë është realizuar më datë 11.02.2016, në shumën 99,460 euro. Afati përfundimtar i disbursimit është data 01.08.2017, bazuar në nenin 3.2, të kësaj marrëveshjeje.

Projektimi/studimi dhe fizibiliteti, është një proces kushtëzues për nisjen e fazës së tretë të projektit dhe për implementimin dhe efektivitetin e tre marrëveshjeve të sipërpërmendura edhe pse si proces parashikohej të përfundonte përgjatë fazës së dytë. Realizimi i këtij procesi shprehet edhe në vullnetin e donatorit, në përmbushje të detyrimeve të përcaktuara në Manualin Operacional të Projektit, seksioni 2, Faza II: Zhvillimi (Fizibiliteti dhe përzgjedhja e projektit).

Me amendimet e trajtuara më poshtë, midis palëve është dakordësuar shtyrja e afatit për realizimin e disbursimeve sipas marrëveshjeve respektive:

-Më datë 28.02.2019, midis KFW-së Gjermane dhe MFE është kryer amendimi i Marrëveshjes së Huas me nr. 201166370, ratifikuar me Ligjin nr. 97/2015, datë 17.09.2015, me objekt shtyrjen e afatit të disbursimeve nga data 30.06.2019, përcaktuar në nenin 3, pika 3.2, të marrëveshjes deri më datë 30.06.2021.

-Më datë 27.01.2020, midis KFW-së Gjermane dhe MFE është kryer amendimi i Marrëveshjes së Financimit dhe Projekti me nr. 202061133, ratifikuar me Ligjin nr. 35/2015, datë 09.04.2015, me objekt shtyrjen e afatit të disbursimeve nga data 30.06.2019, përcaktuar në nenin 3, pika 3.2, të marrëveshjes deri më datë 19.02.2022.

- Më datë 29.01.2021, midis KFW-së Gjermane dhe MFE është kryer amendimi i Marrëveshjes së Financimit dhe Projekti me nr. 201470137, ratifikuar me Ligjin nr. 36/2015, datë 09.04.2015, me objekt shtyrjen e afatit të disbursimeve nga data 30.06.2019, përcaktuar në nenin 3, pika 3.2, të marrëveshjes deri më datë 30.12.2022.

Duke u bazuar në nenin 3, pika 3.2, të Marrëveshjes së Financimit me nr. 202061133, dhe nr. 201470137, afati përfundimtar për disbursimin e fondeve është data 30.06.2019. Amendimi për ndryshimin/shtyrjen e këtij afati është realizuar sipas shkresave të datës 27.01.2020, dhe datës 29.01.2021. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion konstatohet se, disbursimet kanë vazhduar edhe pas datës 30.06.2019, në kushtet kur midis palëve nuk është dakordësuar amendim për ndryshimin e afateve për disbursimin e fondeve. Referuar shkresave të sipërpërmendura amendimet janë kryer pas 7 muajve për Marrëveshjen e Financimit dhe Projekti me nr. 202061133, dhe pas 19 muajve për marrëveshjen e financimit me nr. 201470137. Ndërkohë që në Marrëveshjet e Financimit dhe Projekti të ratifikuara respektivisht me Ligjin nr. 35/2015, datë 09.04.2015, dhe Ligjin nr. 36/2015, datë 09.04.2015, neni 8, pikat 8.5, të secilës marrëveshjeje, përcaktohet që:

Neni 8, pika 8.5: Marrëveshja e Financimit dhe Projekti me nr. 202061133, seksioni 8.5: “Çdo ndryshim ose modifikim i kësaj Marrëveshjeje duhet të bëhet me shkrim dhe të nënshkruhet sipas rregullave nga të gjitha Palët. Ministri i Financave është i autorizuar të nënshkruajë çdo amendim që duhet të miratohet nga Këshilli i Ministrave. Ndryshimet në këtë Marrëveshje që cenojnë vetëm periudhën e disponueshmërisë nuk kërkojnë miratim paraprak nga Këshilli i Ministrave”.

Neni 8, pika 8.5: Marrëveshja e Financimit dhe Projekti me nr. 201470137, seksioni 8.5: “Çdo ndryshim ose modifikim i kësaj Marrëveshjeje është vetëm me shkrim dhe duhet të nënshkruhet rregullisht nga të dyja palët. Ministri i Financave është i autorizuar të nënshkruajë çdo ndryshim që duhet të aprovohet nga Këshilli i Ministrave. Ndryshimet në këtë Marrëveshje që prekin vetëm periudhën e disponibilitetit nuk kërkojnë aprovim paraprak të Këshillit të Ministrave”.

3.2. Mbi realizimin e disburseve të projektit, në krahasim me disbursemet e planifikuara. Referuar fondeve të aprovuara nga KFW-ja Gjermane në zbatim të angazhimeve të parashikuara në marrëveshjet e sipërpërmendura si dhe fondeve nga Qeveria Shqiptare në formën e Kontributit Lokal nga Bashkitë përfituese të projektit, paraqitet ndarja e shumave të financimit për shpenzimet e pranueshme për secilën kategori, si më poshtë:

Euro

Kosto totale e vlerësuar dhe financimi RWS III		Kosto		Financimi			
		Kosto sipas kategorive	FC Kredi/Grant	EU IPA 2013 Grant	Kontributi Lokal	WIBF Grant	Financimi Total
1	Ndërtimi/Rehabilitimi e sistemeve të ujësjellësve dhe masa emergjente për KUZ	27,000,000	18,350,000	6,000,000	2,650,000	0	27,000,000
Investime totale për ndërtim		27,000,000	18,350,000	6,000,000	2,650,000	0	27,000,000
2.1	Kosto administrative të FSZH	2,000,000	650,000	0	1,350,000	0	2,000,000
2.2	Fizibilitete Sociale dhe Teknike	670,000	0	0	0	670,000	670,000
2.3	Projektim dhe supervizionim	5,000,000	2,000,000	3,000,000	0	0	5,000,000
Total pa fonde rezervë		34,670,000	21,000,000	9,000,000	4,000,000	0	34,670,000
3	Fondi rezervë	3,803,922	3,000,000	803,922	0	0	3,803,922
Kosto totale e Projektit (FC+EU+LC)		38,473,922	24,000,000	9,803,922	4,000,000	0	38,473,922
4	Masa shoqëruese	1,500,000	1,500,000	0	0	0	1,500,000
Total (FC+EU+LC+BM)		39,973,922	25,500,000	9,803,922	4,000,000	670,000	39,973,922
	TVSH 20%	7,594,784					

Tabela nr. 1. Burimi i të dhënave: FSHZH/Përpunoi grupi i auditimit.

Deri në momentin e auditimit, projekti (faza e tretë) është vitin e gjashtë të implementimit/zbatimit të tij ku rezulton se, nga KFW-ja Gjermane është disbursuar sipas marrëveshjeve përkatëse shuma totale 32,530,567.14 euro si dhe nga Qeveria Shqiptare në formën e Kontributit Lokal nga Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore përfituese të projektit shumë 308,963,709 lekë + TVSH (për kontratat e zbatimit të punimeve, projektim supervizion, masat shoqëruese, studime dhe fizibilitet) në shumë 855,815,192 lekë. Në mënyrë të hollësishme paraqitet realizimi i financimit/disburseve për periudhën 01.01.2016, deri më 25.06.2021, si më poshtë:

Tabela mbi realizimin e disburseve sipas marrëveshjeve respektive.

Euro

Periudha nga fillimi i Projektit deri më 25.06.2021						
Ratifikimi sipas Ligjit	Marrëveshja	Kodi i Marrëveshjes	Donatori	Shuma e financuar	Disbursuar	Realizimi në %
Ligji nr. 35/2015, datë 09.04.2015	IPA Grant	202061133	KfW	9,803,922	8,102,190.56	82.6 %
Ligji nr. 36/2015, datë 09.04.2015	KFW Grant	201470137	KfW	1,500,000	748,411.16	49.8 %
Ligji nr. 97/2015, datë 17.09.2015	Hua	201166370	KfW	24,000,000	23,019,452.78	95.9 %
Ligji nr. 116/2015, datë 22.10.2015	WBIF Grant	202061695	KfW	670,000	660,512.64	98.5 %
Totali				35,973,922	32,560,567.14	90.4 %

Tabela nr. 2. Burimi i të dhënave: FSHZH/Përpunoi grupi i auditimit.

Tabela mbi realizimin e disburseve sipas aplikimeve.

Euro

Disbursemet								
Nr. i aplikimit	Kontraktori	Data e aplikimit	Totali i aplikuar	KFW Hua 24,000,000	IPA 9,803,922	KFW Grant 1,500,000	KFW Grant 670,000	Data e disbursemet
1	P. & P.	01.02.2016	99,460	0	0	0	99,460	11.02.2016
2	P. & P.	05.04.2016	33,154	0	0	0	33,154	19.04.2016
3	P. & P.	30.08.2016	66,307	0	0	0	66,307	19.09.2016
4	P. & P.	16.02.2017	132,614	0	0	0	132,614	01.03.2017
5	P. & P.	16.02.2017	198,921	0	0	0	198,921	01.03.2017
6	P. & P.	04.07.2017	130,056.61	0	0	0	130,056.64	27.07.2017
1	C. C.	22.06.2017	150,000	60,000	90,000	0	0	19.07.2017
2	C. C.	01.11.2017	153,386	61,354.40	92,031.60	0	0	23.11.2017
3	Reporting	01.11.2017	170,000	54,000	0	0	0	28.02.2018

4	C. C.	12.03.2018	156,771	62,708.40	94,062.60	0	0	05.04.2018
5	Reporting	26.06.2018	0	0	0	0	0	Reporting
6	C. C.	24.07.2018	52,265.63	52,265.63	0	0	0	03.08.2018
7	C. C.	24.07.2018	214,740	85,896	128,844	0	0	03.08.2018
8	C. C.	21.09.2018	350,423.00	140,169	210,254	0	0	12.10.2018
9	Reporting	28.09.2018	77,150	77,150	0	0	0	26.10.2018 (SA)
10	C. C.	13.12.2018	153,386	61,354.40	92,031.60	0	0	20.12.2018
11	Reporting	21.01.2019	33,000	33,000	0	0	0	14.02.2019(SA)
12	C. C.	01.03.2019	117,103.13	109,164.37	7,938.76	0	0	23.04.2019
13	C. C.	01.03.2019	55,575	22,230	33,345	0	0	23.04.2019
14	C. C.	01.03.2019	122,708	49,083.20	73,624.80	0	0	23.04.2019
15	J. S. & T. E.	09.04.2019	862,914.20	650,291.99	212,622.21	0	0	13.05.2019
16	Reporting	20.05.2019	0	0	0	0	0	Raportim shpenzimesh
17	J. A. & A. G.	03.06.2019	1,579,593.86	1,190,381.93	389,211.92	0	0	25.06.2019
18	C. C.	06.06.2019	326,848.30	130,739.32	196,108.98	0	0	18.07.2019
19	C. C.	06.06.2019	121,738	48,695.20	73,042.80	0	0	18.07.2019
20	A. G.	24.06.2019	1,285,482.75	968,739.80	316,742.95	0	0	18.07.2019
21	C. C.	27.06.2019	23,948	9,579.2	14,368.8	0	0	18.07.2019
22	J. S. & T. E.	27.06.2019	637,953.24	480,761.38	157,191.86	0	0	22.07.2019
23	A. G. A.	06.08.2019	149,922.26	0	0	149,922.26	0	16.08.2019
24	A. G. A.	28.08.2019	29,500	0	0	29,500	0	19.09.2019
25	J. SHPK	06.09.2019	801,814.98	604,247.77	197,567.21	0	0	20.09.2019
26	C. C.	09.09.2019	153,386	61,354.4	92,031.6	0	0	20.09.2019
27	A. G.	30.09.2019	1,517,232.73	1,143,386.58	373,846.15	0	0	17.10.2019
28	J. S. & T. E.	30.09.2019	799,160.69	602,247.5	196,913.19	0	0	17.10.2019
29	C. C.	10.10.2019	339,910.27	135,964.11	203,946.16	0	0	05.11.2019
30	J. A. & A. G.	11.11.2019	1,411,913.81	1,064,018.25	347,895.56	0	0	22.11.2019
31	J. S. & T. E.	12.11.2019	651,953.5	491,312.16	160,641.34	0	0	28.11.2019
32	A. G.	12.11.2019	1,668,750.08	1,257,570.06	411,180.02	0	0	27.11.2019
33	A. G. A.	19.11.2019	91,398	0	0	91,398	0	28.11.2019
34	A. G. A.	05.12.2019	5,762.04	0	0	5,762.04	0	17.12.2019
35	C. C.	06.12.2019	346,950	0	346,950	0	0	19.12.2019
36	J. S. & T. E.	11.12.2019	291,469.05	0	291,469.05	0	0	19.12.2019
37	A. G.	11.12.2019	281,189.11	0	281,189.11	0	0	17.12.2019
38	A. G. A.	12.12.2019	91,398	0	0	91,398	0	30.12.2019
39	J. A. & A. G.	12.12.2019	195,390.54	0	195,390.54	0	0	19.12.2019
40	Reporting	26.02.2020	102,000	102,000	0	0	0	17.07.2020
41	A. G.	12.03.2020	938,739.85	919,287.85	19,452	0	0	09.04.2020
42	J. S. & T. E.	24.03.2020	890,276.34	890,276.34	0	0	0	09.04.2020
43	A. SHPK & A.	24.03.2020	672,863.57	654,269.50	18,594.07	0	0	09.04.2020
44	J. SHPK	25.03.2020	428,761.40	392,719.40	36,042	0	0	09.04.2020
45	C. C.	22.04.2020	274,713	109,885.20	164,827.80	0	0	14.05.2020
46	A. G.	22.04.2020	91,398	0	0	91,398	0	06.05.2020
47	A. G.	27.04.2020	9,768.24	0	0	9,768.24	0	15.05.2020
48	J. SHPK	27.05.2020	322,151.21	242,773.15	79,378.06	0	0	09.06.2020
49	A. G.	18.06.2020	554,468.62	417,847.55	136,621.07	0	0	08.07.2020
50	J. A. & A. G.	18.06.2020	1,038,590.06	782,681.47	255,908.59	0	0	08.07.2020
51	A. G.	02.07.2020	91,398	0	0	91,398	0	31.07.2020
52	J. S. & T. E.	03.07.2020	579,978.35	437,071.68	142,906.67	0	0	31.07.2020
53	J. SHPK	17.08.2020	533,454.16	402,011.05	131,443.11	0	0	25.09.2020
54	C. C.	12.08.2020	261,308	104,523.20	156,784.80	0	0	16.09.2020
55	J. S. & T. E.	10.09.2020	1,076,145.32	810,983.11	265,162.21	0	0	01.10.2020
56	A. G.	15.09.2020	91,398	0	0	91,398	0	30.10.2020
57	J. A. & A. G.	15.09.2020	682,016.65	513,967.75	168,048.90	0	0	08.10.2020
58	A. G.	18.09.2020	3,054.38	0	0	3,054.38	0	30.10.2020
59	A. G.	21.10.2020	1,253,705.65	944,792.58	308,913.07	0	0	17.11.2020
60	J. S. & T. E.	03.11.2020	1,329,951.25	1,002,251.26	327,699.99	0	0	25.11.2020
61	J. A. & A. G.	19.11.2020	798,616.68	601,837.53	196,779.15	0	0	14.12.2020
62	C. C.	24.11.2020	592,730.00	237,092.00	355,638.00	0	0	16.12.2020
63	J. SHPK	07.12.2020	944,866.72	944,866.72	0	0	0	22.12.2020
64	A. G.	10.12.2020	91,398.00	0	0	91,398.00	0	21.01.2021
65	A. G.	10.12.2020	2,016.24	0	0	2,016.24	0	21.01.2021
66	A. G.	11.12.2020	161,490.55	161,490.55	0	0	0	06.01.2021
67	C. C.	11.12.2020	309,083.00	309,083.00	0	0	0	20.01.2021
68	A. SHPK & A.	14.12.2020	111,991.34	111,991.34	0	0	0	06.01.2021
69	ADF	18.12.2020	280,000.00	280,000.00	0	0	0	19.04.2021

70	J. SHPK	21.12.2020	274,196.94	274,196.94	0	0	0	06.01.2021
71	J. S. & T. E.	15.02.2021	269,361.35	269,361.35	0	0	0	08.03.2021
72	Aplikim	12.04.2021	103,850.00	103,850.00	0	0	0	14.06.2021
73	C. C.	17.05.2021	183,505.35	125,956.09	57,549.26	0	0	10.06.2021
74	A. G.	17.05.2021	91,398.00	0	0	0	0	Ende pa konfirmuar
75	A. G.	17.05.2021	2,683.06	0	0	0	0	Ende pa konfirmuar
76	J. SHPK	17.05.2021	158,895.25	158,895.25	0	0	0	09.06.2021
77	J. S. & T. E.	24.05.2021	245,506.71	245,506.71	0	0	0	09.06.2021
78	A. SHPK & A.	14.06.2021	424,919.80	424,919.80	0	0	0	25.06.2021
79	A. SHPK & A.	14.06.2021	335,399.36	335,399.36	0	0	0	25.06.2021
Totali			32,390,225.18	23,019,452.78	8,102,190.56	748,411.16	660,512.64	

Tabela nr. 3. Burimi i të dhënave: FSHZH/Përpunoi grupi i auditimit.

Tabela për koston totale e vlerësuar dhe financimi i projektit.

Euro

Kosto totale e vlerësuar dhe financimi RWS III	Kosto		Financimi							
	Kosto sipas kategorive	FC Kredi/Grant	Realizimi 2016-2021 FC Kredi/Grant	EU IPA 2013 Grant	Realizimi 2016-2021 EU IPA 2013 Grant	Kontributi Lokal	Realizimi 2016-2021 Kontributi Lokal	WIBF Grant	Realizimi 2016-2021 WIBF Grant	Realizimi Total deri me Qershor 2021
1 Ndërtimi/Rehabilitimi e sistemeve të ujësjellësave dhe masa emergjente për KUZ	30,826,825	21,372,903	20,392,356	6,803,922	5,618,810	2,650,000	904,074	0	0	26,915,240
Investime totale për ndërtim	30,826,825	21,372,903	20,392,356	6,803,922	5,618,810	2,650,000	904,074	0	0	26,915,240
2.1 Kosto administrative të FSZH	2,000,000	650,000	390,042	0	0	1,350,000	333,614	0	0	723,656
2.2 Fizibilitete Sociale dhe Teknike	670,000	0	0	0	0	0	0	670,000	660,513	660,513
2.3 Projektim dhe supervizionim	4,976,951	1,977,097	1,977,097	2,999,854	2,483,381	0	0	0	0	4,460,478
Total pa fonde rezervë	7,646,951	2,627,097	2,367,139	2,999,854	2,483,381	1,350,000	333,614	670,000	660,513	5,844,647
3 Fondi rezervë	146	0	0	146	0	0	0	0	0	0
Kosto totale e Projektit (FC+EU+L)	38,473,922	24,000,000	22,759,495	9,803,922	8,102,191	4,000,000	1,237,688	670,000	660,513	32,759,887
4 Masa shoqëruese	1,500,000	1,500,000	842,492	0	0	0	0	0	0	842,492
Total (FC+EU+LC+BM)	39,973,922	25,500,000	23,601,987	9,803,922	8,102,191	4,000,000	1,237,688	670,000	660,513	33,602,379

Tabela nr. 4. Burimi i të dhënave: FSHZH/Përpunoi grupi i auditimit.

Projekti synon furnizimin me ujë të pijshëm 24 orë për 88,167 banorë në zonat rurale duke ndërtuar/rindërtuar sisteme të reja për ujësjellësat sipas 26 skemave për furnizimin me ujë të 83 fshatrave në 14 degë të ujësjellësave në qarqet Korçë, Elbasan, Dibër, Kukës, Lezhë, Vlorë, Fier, Berat, Tiranë dhe Durrës, për të cilat janë realizuar dhe disbursuar kontratat si më poshtë:

1. Për realizimin e kontratës me objekt ÷Përgatitjen e projektit dhe studime të fizibilitetit për ndërtimin/rindërtimin e sistemeve të furnizimit me ujë të zonave rurale, deri më datë 31.05.2021, nga KFW-ja Gjermane është disbursuar shuma 660,513 euro financiar nga Marrëveshja e Financimit dhe Projekti me nr. 202061695, ratifikuar si pjesë e Ligjit nr. 116/2015, datë 22.10.2015, si dhe pagesë TVSH-je në shumën 131,337 euro (17,895,771 lekë) nga Qeveria Shqiptare.

2. Për realizimin e kontratës me objekt ÷Projektimin dhe supervizioni i punimeve për të gjithë programin, deri më datë 31.05.2021, nga KFW-ja Gjermane është disbursuar shuma totale 4,460,477.68 euro (1,977,097 euro nga Marrëveshja e Huas me nr. 201166370, ratifikuar me

Ligjin nr. 97/2015, datë 17.09.2015, + 2,483,380.56 euro nga Marrëveshja e Financimit dhe Projekti me nr. 202061133, ratifikuar me Ligjin nr. 35/2015, datë 09.04.2015), si dhe pagesë TVSH-je në shumën 892,089 euro (111,266,551 lekë) nga Qeveria Shqiptare.

3. Për realizimin e kontratës me objekt òNdërtimi i sistemit të ri të ujës-jellësit dhe furnizimit me ujë 24 orë për të katër Lotetò deri më datë 31.05.2021, nga KFW-ja Gjermane është disbursuar shuma totale 26,011,165.27 euro (20,392,355.66 euro nga Marrëveshja e Huas me nr. 201166370, ratifikuar me Ligjin nr. 97/2015, datë 17.09.2015, + 5,618,809.61 euro nga Marrëveshja e Financimit me nr. 202061133, ratifikuar me Ligjin nr. 35/2015, datë 09.04.2015), si dhe Kontribut Lokal në shumën 904,123 euro + pagesë TVSH-je në shumën 5,727,692.77 euro (620,433,525 lekë) nga Qeveria Shqiptare konkretisht:

a) Lot 1 për kontratën të lidhur me BOE J. òS.ò & òT. E.ò, KFW-ja Gjermane ka disbursuar shumën 7,634,669.5 euro si dhe Kontribut Lokal në shumën 425,587 euro + pagesë TVSH-je në shumën 1,702,343.77 euro (210,346,216 lekë) nga Qeveria Shqiptare.

b) Lot 2 për kontratën të lidhur me OE òA. G.ò, KFW-ja Gjermane ka disbursuar shumën 7,661,088.97 euro si dhe Kontribut Lokal në shumën 427,037 euro + pagesë TVSH-je në shumën 1,708,149 euro (209,639,854 lekë) nga Qeveria Shqiptare.

c) Lot 3 për kontratën të lidhur me OE òJ.ò SHPK, KFW-ja Gjermane ka disbursuar shumën 3,464,140.66 euro si dhe pagesë TVSH-je në shumën 769,806 euro (94,886,238 lekë) nga Qeveria Shqiptare.

d) Lot 4 për kontratën të lidhur me BOE òA.ò SHPK & òA.ò, KFW-ja Gjermane ka disbursuar shumën 7,251,295.66 euro si dhe Kontribut Lokal në shumën 51,500 euro + pagesë TVSH-je në shumën 1,547,394 euro (190,961,217 lekë) nga Qeveria Shqiptare.

4. Për realizimin e kontratës me objekt òShërbimet e konsulencës për implementimin e masave shoqërueseò, deri më datë 31.05.2021, nga KFW-ja Gjermane është disbursuar shuma 748,411.16 euro financuar nga Marrëveshja e Financimit dhe Projekti me nr. 201470137, ratifikuar si pjesë e Ligjit nr. 36/2015, datë 09.04.2015, si dhe pagesë TVSH-je në shumën 168,403 euro (20,819,345 lekë) nga Qeveria Shqiptare.

Tabela mbi realizimin e disbursimeve sipas kontratave respektive.

Euro

Programi			Vlera e Kontratës/Kontraktori						
Projekti "Furnizimi me ujë i zonave rurale III"			J. "S." & "T. E." Lot 1	A. G. Lot 2	J. SHPK Lot 3	J. "A." & "A." Lot 4	C. C. Supervizion i punimeve	A. G. Masat shoqëruese	P. & P. SHPK Projektim /studime fizibiliteti
Viti	Donatori	Paguar Total	8,601,883	8,540,990	5,877,511	7,897,969	4,976,951	1,499,223	663,070
2016	KfW	0	0	0	0	0	0	0	0
	IPA Grant	0	0	0	0	0	0	0	0
	KfW Grant	0	0	0	0	0	0	0	0
	WBIF Grant	198,921	0	0	0	0	0	0	198,921
	Beneficiary Contribution	0	0	0	0	0	0	0	0
2017	KfW Hua	121,354	0	0	0	0	121,354	0	0
	IPA Grant	182,032	0	0	0	0	182,032	0	0
	KfW Grant	0	0	0	0	0	0	0	0
	WBIF Grant	461,591.64	0	0	0	0	0	0	461,591.64
	Beneficiary Contribution	0	0	0	0	0	0	0	0
2018	KfW Hua	402,393	0	0	0	0	402,393	0	0
	IPA Grant	525,192	0	0	0	0	525,192	0	0
	KfW Grant	0	0	0	0	0	0	0	0
	Beneficiary								

	Contribution	0	0	0	0	0	0	0	0
	WBIF Grant	0	0	0	0	0	0	0	0
2019	KfW Hua	9,019,767	2,224,613	3,369,696	604,247	2,254,400	566,809.80	0	0
	IPA Grant	4,573,218	1,018,838	1,382,958	197,567	932,498	1,041,356.90	0	0
	KfW Grant	367,980	0	0	0	0	0	367,980	0
	WBIF Grant	0	0	0	0	0	0	0	0
	Beneficiary Contribution	0	0	0	0	0	0	0	0
2020	KfW Hua	10,409,137	3,140,582	2,281,928	1,982,370	2,552,756	451,500	0	0
	IPA Grant	2,764,199	735,769	464,986	246,863	639,331	677,251	0	0
	KfW Grant	287,017	0	0	0	0	0	287,017	0
	WBIF Grant	0	0	0	0	0	0	0	0
	Beneficiary Contribution	427,037	0	427,037	0	0	0	0	0
30.05.2021	KfW Hua	2,416,800	514,868	161,491	433,092	872,311	435,039	0	0
	IPA Grant	57,549	0	0	0	0	57,549	0	0
	KfW Grant	187,495	0	0	0	0	0	93,414.24	0
	WBIF Grant	0	0	0	0	0	0	0	0
	Beneficiary Contribution	477,086	425,587	0	0	51,500	0	0	0
Totali	32,218,259	8,060,257	8,088,096	3,464,139	7,302,795	4,460,476.7	748,411.24	663,070	
Realizimi në %	86%	93.7%	95%	58.9%	92%	89.6%	49.9%	99.6%	
TVSH sipas kontratave	6,919,521.77 (855,815,192)	1,702,343.77 (210,346,216)	1,708,149 (209,639,854)	769,806 (94,886,238)	1,547,394 (190,961,217)	892,089 (111,266,551)	168,403 (20,819,345)	131,337 (17,895,771)	

Tabela nr. 5. Burimi i të dhënave: FSHZH/Përpunoi grupi i auditimit.

Mbi angazhimet e Marrëveshjes së Huas

Referuar Marrëveshjes së Huas me nr. 201166370, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe KfW-së Gjermane për projektin ÷Furnizimin me ujë të zonave rurale IIIö, ratifikuar me Ligjin nr. 97/2015, datë 17.09.2015, janë parashikuar angazhimet:

Aneksi nr. 1, grafiku më i shpejtë i mundshëm i disbursimit deri në fund të çdo periudhe disbursimi Huamarrësi mund të kërkojë disbursime deri në masën kumulative të disbursimeve të përcaktuar në tabelën e mëposhtme:

Euro		
Periudha	Data e hyrjes në fuqi të përfundimit të periudhës	Shuma maksimale që mund të disbursohet deri në fund të periudhës (kumulative)
1	30.12.2015	2,400,000
2	30.06.2016	8,400,000
3	30.12.2016	14,000,000
4	30.06.2017	20,400,000
5	30.12.2017	24,000,000

Tabela nr. 6. Burimi i të dhënave: Marrëveshja e Huas.

Procedurat të cilat duhen të ndiqen nga Qeveria Shqiptare për shlyerjen e kësteve të huas dhe interesat janë të parashikuara në seksionet përkatëse të marrëveshjes së huas e ratifikuar si pjesë e Ligjit nr. 97/2015, datë 17.09.2015, si më poshtë:

Seksioni 4.1. Tarifa e angazhimit. Huamarrësi do të paguajë një tarifë të pakthyeshme angazhimi prej 0.25% në vit për shumat e padisbursuara të huas. Tarifa e angazhimit është e kërkueshme për pagesën gjashtëmujore në shumën të prapambetura në datën 30 qershor dhe 30 dhjetor të çdo viti, për herë të parë në datë 30.06.2015, por jo më parë se në datën përkatëse pas datës në të cilën kjo marrëveshje hyn në fuqi dhe efekt bazë të nenit 13.11. Tarifa e angazhimit do të faturohet, nëse është e zbatueshme, me efekt prapaveprues për periudhën që fillon tre muaj pas nënshkrimit të kësaj marrëveshjeje dhe do të zgjasë deri në datën e disbursimit të plotë të huas ose nëse është e zbatueshme, deri në datën e përfundimit të plotë të disbursimeve nga huaja.

Seksioni 4.2. Tarifa e menaxhimit. Huamarrësi do të paguajë KFW-së një tarifë të përgjithshme, të menjëhershme dhe të pakthyeshme menaxhimi të barabartë me 1% të shumën së huas të përcaktuar në nenin 1.1.

Seksioni 6.1. Grafiku i shlyerjes. Huamarrësi do të shlyejë huan si më poshtë:

Euro

Kësti	Data e kërkueshme	Kësti i shlyerjes
1	30.06.2018	1,000,000
2	30.12.2018	1,000,000
3	30.06.2019	1,000,000
4	30.12.2019	1,000,000
5	30.06.2020	1,000,000
6	30.12.2020	1,000,000
7	30.06.2021	1,000,000
8	30.12.2021	1,000,000
9	30.06.2022	1,000,000
10	30.12.2022	1,000,000
11	30.06.2023	1,000,000
12	30.12.2023	1,000,000
13	30.06.2024	1,000,000
14	30.12.2024	1,000,000
15	30.06.2025	1,000,000
16	30.12.2025	1,000,000
17	30.06.2026	1,000,000
18	30.12.2026	1,000,000
19	30.06.2027	1,000,000
20	30.12.2027	1,000,000
21	30.06.2028	1,000,000
22	30.12.2028	1,000,000
23	30.06.2029	1,000,000
24	30.12.2029	1,000,000

Tabela nr. 7. Burimi i të dhënave: Marrëveshja e Huas.

Në zbatim të programit të auditimit nr. 581/1 prot., datë 04.06.2021, FSHZH me shkresën nr. 2049 prot., datë 09.06.2021, është drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Borxhit të Huaj pranë MFE me kërkesë për dhënie informacioni në lidhje me shlyerjen e interesave për projektin ÷Furnizimi me ujë i zonave rurale IIIö. Në referencë të shkresës të sipërpërmendur MFE me shkresën nr. 10361/1 prot., datë 24.06.2021, protokolluar në FSHZH me nr. 2049/1 prot., datë 25.06.2021, ka paraqitur të dhënat mbi interesat e paguara për periudhën nga 01.01.2015 deri më 31.05.2021, si më poshtë:

Euro

Periudha	Interes i paguar 2015-2020	Komision i paguar 2015-2020
2015		43,833.33
2016		300,000
2017	402.50	59,932.92
2018	3,008.86	59,200.95
2019	31,000.31	52,193.02
2020	155,785.68	26,224.53
Totali	190,197.35	541,384.75

Tabela nr. 8. Burimi i të dhënave: Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

Kontribut Lokal

Duke u bazuar në angazhimet e përcaktuara në Marrëveshjet e Financimit të Projektit dhe Marrëveshjet Përfundimtare të Investimit në lidhje me derdhjen e detyrimeve të Kontributit Lokal nga Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore të cilat janë pjesë e skemës së financimit drejt FSHZH-së për periudhën nga data 01.01.2016, deri më 30.06.2021, sipas rastit është arkëtuar Kontribut Lokal në shumën totale 308,963,708 lekë. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion konstatohet se ka ende NJVV të cilat kanë për të derdhur edhe detyrimin Kontributin Lokal në

shumën 89,425,931 lekë drejt FSHZH-së. Kjo situatë ka ndodhur si pasojë e mos respektimit të afatit për derdhjen e detyrimeve referuar Marrëveshjeve Përfundimtare të Investimit të lidhur me NJVV respektive neni 3, pikat 3.1, 3.2, dhe 3.3, ku është shprehur në mënyrë eksplicite se:

Dispozitat financiare: Në mënyrë të veçantë Njësia e Vetëqeverisjes Vendore:

3.1. Të plotësojë kontributin total financiar në vlerën 10% të çmimit të Kontratës të Punimeve.

3.2. Të rrisë pjesëmarrjen e Përfituesve të drejtpërdrejtë duke i nxitur ata të paguajnë të paktën 2% të Kontributit të Përfituesit.

3.3. Të paguajnë pjesën e mbetur të Kontributit të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore, para nënshkrimit të Kontratës të Punimeve, kjo e llogaritur mbi çmimin e Kontratës së Punimeve dhe të pagesave të kryera në numrin e llogarisë bankare të FSHZH.

Në mënyrë të detajuar paraqitet detyrimet për Kontributin Lokal sipas Bashkive përkatëse si më poshtë:

Lekë

Bashkia	Kontrata	Kotribut Lokal	Kontributi sipas MPI	Arkëtuar Kontribute RSW III viti 2017	Arkëtuar Kontribute RSW III viti 2018	Arkëtuar Kontribute RSW III viti 2019	Arkëtuar Kontribute RSW III viti 2020	Arkëtuar Kontribute 01.01.2021 30.06.2021	Progressive	Mbeten Kontribute Për t'u derdhur
Bashkia Devoll UK SHA Bilisht	325,050,912	32,505,091	29,246,000	17,547,600	0	0	0	0	17,547,600	14,957,491
Bashkia Lezhë	203,383,738	20,338,373	18,018,000	2,414,000	10,000,000	0	7,924,374	0	20,338,374	0
Bashkia Përrenjas UK SHA Librazhd	533,051,426	53,305,142	33,152,000	12,000,000	19,500,000	0	0	6,000,000	37,500,000	15,805,143
Bashkia Dibër UK SHA Dibër	147,079,006	14,707,900	15,162,000	9,097,200	3,032,400	0	0	0	12,129,600	2,578,301
Bashkia Tiranë UKT SHA Tiranë	193,512,948	19,351,294	17,626,000	12,690,720	0	6,660,575	0	0	19,351,295	0
Bashkia Vlorë UK SHA Vlorë	390,807,295	39,080,729	30,660,000	9,000,000	9,396,000	0	0	0	18,396,000	20,684,730
Bashkia Klos Sektori i Ujësllësit	242,435,385	24,243,538	16,598,400	9,959,040	3,319,680	0	0	0	13,278,720	10,964,819
Bashkia Durrës UK SHA Durrës	808,386,189	80,838,618	99,008,000	17,824,800	41,580,000	0	22,368,527	0	81,773,327	934,708
Bashkia Tropojë UK SHA Tropojë	376,876,774	37,687,677	23,812,600	14,287,560	4,762,520	4,178,200	0	0	23,228,280	14,459,397
Bashkia Mat UK SHA Mat	114,930,792	11,493,079	7,294,000	3,500,000	876,400	0	0	0	4,376,400	7,116,679
Bashkia Himarë - Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit	207,332,647	20,733,264	16,646,000	0	8,500,000	12,233,265	0	0	20,733,265	0

Bashkia Korçë, UK SHA Korçë	237,798,719	23,779,871	16,170,000	9,702,000	0	7,038,900	7,038,972	0	23,779,872	0
Bashkia Lushnje (Çiflik)	45,309,748	4,530,974	25,196,892	600,000	2,146,800	0	1,784,175	0	4,530,975	0
Bashkia Ura Vajgurore, UK SHA Berat	157,935,411	15,793,541	20,618,892	0	12,000,000	0	0	0	12,000,000	3,793,541
Totali		398,389,099	369,208,784	118,622,920	115,113,800	30,110,940	39,116,048	6,000,000	308,963,708	89,425,391

Tabela nr. 9. Burimi i të dhënave: FSHZH/Përpunoi grupi i auditimit.

Kosto Administrative financuar nga KFW-ja Gjermane dhe Kontribut Lokal nga NJVV përfituese nga projekti, i realizuar për periudhën nga data 01.01.2016, deri më 30.06.2021, si më poshtë:
Lekë

Nr.	Zërat	Realizimi i koston KFW mbulon 5% të buxhetit 30.06.2021	Realizimi i koston Kontributi lokale 30.06.2021
1	Pagat	57,300,144	34,452,532
2	Kanceleri	479,325	0
3	Karburant	6,312,864	0
4	Servis makinash/siguracion	5,033,708	0
5	Dieta	566,233	0
6	Telefon dhe PT	1,450,051	17,590
7	Internet	131,035	0
8	Energji Elektrike/Ujë	1,504,664	434,647
9	Zyra me qira	845,909	0
10	Mirëmbajtje/Sigurim godine	3,731,412	0
11	Te tjera/Petty cash/PCU Admin.	1,227,339	79,953
12	Publikimi & Promovime	646,979	58,400
13	Kontrata Shërbimi/PCU	-	0
14	Shp. gjyqësore/përkthime	217,503	16,316
15	Servis kompjuter dhe fotokopje	138,371	0
	Bankë charges	105,605	95,806
	TOTAL	79,691,142	35,155,244

Tabela nr. 10. Burimi i të dhënave: FSHZH/Përpunoi grupi i auditimit.

1. Realizimi i Koston Administrative disbursuar nga KFW-ja Gjermane.

Marrëveshja me KFW-në për programin ÷Furnizimi me ujë i zonave rurale III÷, financuar nga KFW/IPA2013/Kontributi Lokal është në vlerën 39 milion euro, ku kategoria Kosto Administrative financuar nga KFW-ja kredi zë rreth 5% mbi totalin e Marrëveshjes përkatësisht 650,000 euro. Sipas Marrëveshjes fondi për këtë kategori lëvrohet nga KFW nëpërmjet MFE në llogarinë speciale pranë Bankës së Shqipërisë dhe më pas transferohet në bankën e nivelit të dytë llogari projekti nga ku bëhen shpenzimet përkatëse.

FSHZH raporton në mënyrë periodike tek donatori mbi shpenzimet e kryera dhe kërkesën për disbursimin pasardhës, paraqitur kjo edhe në tabelën mbi realizimin e disbursimeve sipas aplikimeve. Aktualisht nga KFW-ja janë disbursuar 650,000 euro për periudhën 2018-2021, në bazë të aplikimeve të dërguara tek donatori, disbursimi është kryer në 6 transhe.

Referuar disponibilitetit të fondeve të miratuara në buxhetin vjetor për çdo program, hartohet dhe buxheti vjetor i institucionit ku bën pjesë dhe programi Mbështetje e Furnizimit me Ujë zonat rurale III financuar nga KFW-ja (pra ky financim kalon si mbështetje buxhetore ku miratohet sipas vendimeve të Bordit Drejtues të FSHZH-së në buxhetin vjetor të institucionit).

Buxheti vjetor miratohet nga Bordi Drejtues i FSHZH-së përkatësisht me Vendimet e mëposhtme për çdo vit buxhetor.

- Për vitin 2018, me Vendimin e BD nr. 160, datë 05.04.2018.
- Për vitin 2019, me Vendimin e BD nr. 178, datë 11.06.2019.
- Për vitin 2020, me Vendimin e BD nr. 197, datë 04.03.2020.
- Për vitin 2021, me Vendimin e BD nr. 211, datë 23.03.2021.

2. Realizimi i Kostos Administrative të financuar nga Qeveria Shqiptare (Kontributi Lokal), si më poshtë:

Lekë

Përfituesi	Përshkrimi	Data e Urdhër Shpenzimit	Shuma	Përmbledhëse	Zërat
Paga	Paga Stafi		34,452,532	34,452,532	Pagat
OE ðE. B.ö	Përkthim - Fatura nr. 668, datë 18.01.2020.	01.06.2020	16,316	16,316	Shp. Gjyqësore/ Përkthimi
OE ðA.ö	Telefon - Fatura nr. 388954071, datë 30.04.2021. - Fatura nr. 21, datë 15.04.2021.	26.02.2021	6,460	17,590	Telefon dhe PT
Posta Shqiptare	Posta - Fatura nr 1437, date 26.05.2021	11.06.2021	11,130		
UK Tiranë SHA	UKT - Fatura nr. 2102-2104-159555-1-1-1; 2102-2104-359468-1-1, datë 30.04.2021.	07.05.2021	37,675	434,647	Energji elektrike/ Ujë
UK Tiranë SHA	UKT Fat nr 2105-159555-1-1 & 2105-359468-1-1 dt 31.05.2021	16.06.2021	14,275		
UK Tiranë SHA	UKT Fat nr 2105-427898-1-1 dt 31.05.2021	16.06.2021	2,575		
OSHEE	Energji elektrike - Fat nr 412887850 dt 25.04.2021	16.06.2021	200,860		
OSHEE	Energji elektrike - Fat nr 414224075 dt 31.05.2021	16.06.2021	25,076		
OSHEE	Energji elektrike - Fat nr 414217187 dt 31.05.2021	16.06.2021	5,406		
OSHEE	Energji elektrike - Fat nr 414224750 dt 25.05.2021	16.06.2021	148,780		
ARRSH	Pagese tarife leje për ARRSH-në - Fatura nr. 148, datë 26.06.2020.	30.06.2020	79,953	79,953	Të tjera/ Petty Cash/ PCU Admin
S.	Publikim - Fatura nr. 38, datë 14.10.2020.	15.10.2020	5,600	58,400	Publikime dhe Promovime
P. G.	Publikim - Fatura nr. 924, datë 06.10.2020.	16.11.2020	12,000		
P. G.	Publikim, P. - Fatura nr. 438, datë 29.04.2021. - Fatura nr. 439, datë 29.04.2021.	11.05.2021	24,000		
S.	Publikim, S. L. - Fatura nr. 12, datë 30.04.2021. - Fatura nr. 13, datë 30.04.2021. - Fatura nr. 14, datë 30.04.2021.	11.05.2021	16,800		
C./ U.	Komisione bankare		95,806	95,806	Komisione bankare
Total			35,155,244	35,155,244	

Tabela nr. 11. Burimi i të dhënave: FSHZH/Përpunoi grupi i auditimit.

3.3. Mbi ndjekjen e procedurave ligjore për raportimet financiare dhe jo financiare.

Tabela mbi raportimet në MFE mbi realizimin e disbursimeve dhe shpenzimeve për periudhën nga data 01.01.2016, deri më 30.05.2021.

Raportimet mujore

Nr.	Muaji	Viti 2016	Viti 2017	Viti 2018	Viti 2019	Viti 2020	Viti 2021
1	Janar	Nr. 169 prot., datë 05.02.2016	Nr. 106 prot., datë 06.02.2017	Nr. 28/1 prot., datë 05.02.2018	Nr. 43/1 prot., datë 05.02.2018	Nr. 69/1 prot., datë 05.02.2020	Nr. 170/1 prot., datë 04.02.2021
2	Shkurt	Nr. 335 prot., datë 07.03.2016	Nr. 224 prot., datë 06.03.2017	Nr. 28/2 prot., datë 05.03.2018	Nr. 43/2 prot., datë 05.03.2019	Nr. 69/2 prot., datë 05.03.2020	Nr. 170/2 prot., datë 05.03.2021
3	Mars	Nr. 456 prot., datë 05.04.2016	Nr. 317 prot., datë 05.04.2017	Nr. 28/3 prot., datë 05.04.2018	Nr. 43/3 prot., datë 05.04.2019	Nr. 69/3 prot., datë 01.04.2020	Nr. 170/3 prot., datë 02.04.2021
4	Prill	Nr. 633 prot., datë 04.05.2016	Nr. 317/1 prot., datë 05.05.2017	Nr. 28/4 prot., datë 04.05.2018	Nr. 43/4 prot., datë 03.05.2019	Nr. 69/4 prot., datë 05.05.2020	Nr. 170/4 prot., datë 05.05.2021
5	Maj	Nr. 839 prot., datë 06.06.2016	Nr. 317/2 prot., datë 05.06.2017	Nr. 28/5 prot., datë 05.06.2018	Nr. 43/5 prot., datë 05.06.2019	Nr. 69/5 prot., datë 05.06.2020	Nr. 170/5 prot., datë 04.06.2021
6	Qershor	Nr. 1001 prot., datë 06.07.2016	Nr. 707 prot., datë 11.07.2017	Nr. 28/6 prot., datë 05.07.2018	Nr. 43/6 prot., datë 05.07.2019	Nr. 69/6 prot., datë 03.07.2020	
7	Korrik	Nr. 1149 prot., datë 05.08.2016	Nr. 707/1 prot., datë 05.08.2017	Nr. 28/7 prot., datë 03.08.2018	Nr. 43/7 prot., datë 05.08.2019	Nr. 69/7 prot., datë 04.08.2020	
8	Gusht	Nr. 1149/1 prot., datë 05.09.2016	Nr. 707/2 prot., datë 05.09.2017	Nr. 28/8 prot., datë 04.09.2018	Nr. 43/8 prot., datë 04.09.2019	Nr. 69/8 prot., datë 04.09.2020	
9	Shtator	Nr. 1149/2 prot., datë 05.10.2016	Nr. 707/3 prot., datë 05.10.2017	Nr. 28/9 prot., datë 05.10.2018	Nr. 43/9 prot., datë 04.10.2019	Nr. 69/9 prot., datë 05.10.2020	
10	Tetor	Nr. 1381 prot., datë 04.11.2016	Nr. 707/4 prot., datë 03.11.2017	Nr. 28/10 prot., datë 05.11.2018	Nr. 43/10 prot., datë 05.11.2019	Nr. 69/10 prot., datë 04.11.2020	
11	Nëntor	Nr. 1381/1 prot., datë 05.12.2016	Nr. 707/5 prot., datë 05.12.2017	Nr. 28/11 prot., datë 05.12.2018	Nr. 43/11 prot., datë 05.12.2019	Nr. 69/11 prot., datë 04.12.2020	
12	Dhjetor	Nr. 26 prot., datë 16.01.2017	Nr. 28 prot., datë 10.01.2018	Nr. 43 prot., datë 11.01.2019	Nr. 69 prot., datë 13.01.2020	Nr. 170 prot., datë 13.01.2021	

Tabela nr. 12. Burimi i të dhënave: FSHZH/Përpunoi grupi i auditimit.

Raportimet për realizimin e disbursimeve dhe shpenzimeve janë dorëzuar në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë sipas tabelës sa më sipër ku në përgjithësi janë kryer sipas kuadrit rregullator ligjor por konstatohet se, për muajt shkurt, maj, qershor, dhjetor 2016, janar, shkurt, qershor, dhjetor 2017, dhjetor 2018, dhjetor 2019, dhjetor 2020, nga FSHZH nuk janë zbatuar afatet mbi raportimin e realizimit të disbursimeve në Ministrinë e Financave sipas përcaktimeve të pikës 5.5, të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 8, datë 17.02.2003 òPër evidencimin, regjistrimin, përdorimin dhe raportimin e financimeve të huaja në kuadrin e projekteve dhe marrëveshjeve me donatorët e huajò, ku është shprehur në mënyrë eksplicite se:

5.5. Brenda datës 5 të çdo muaji, çdo njësi e zbatimit të projekteve duhet të paraqesë në Drejtorinë e Thesarit dhe Borxhit në Ministrinë e Financave, situacionin e raportimit të të ardhurave dhe shpenzimeve për muajin paraardhës, progresiv për projektet respektive që ato mbulojnë.

Për sa trajtuar më sipër është mbajtur Akt konstatimi 1, nr. 1882/2 prot., datë 30.07.2021

4. Mbi realizimin e procedurave të prokurimit për shërbime, mallra dhe punime civile, përputhshmëria me udhëzuesit e Bankës, apo ligjit shqiptar, kur është i aplikueshëm.

4.1 Për procedurën e prokurimit të zhvilluar me objekt “Ndërtim i Ujësjellsve LOT 1”:

- Dosja e prokurimit me objekt Ndërtim i Ujësjellsave LOT 1 e përbërë nga skemat:
Lot 1.1, Menkulas, Poncar, Braçanj, Dobraj, Zicisht, Sul, Gjyrez, Fitore dhe Koshnicë në Bashkinë Devoll.
Lot 1.2, Kamenicë dhe Dvoran në Bashkinë Korçë.
Lot 1.3, Kovanik, Skënderbej, Sutaj, Bardhaj dhe Rrajcë fushë në Bashkinë Përrenjas.
- Dokumentacioni i subjektit fitues,
- Korrespondenca zyrtare.

Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion, rezultoi se procedura e konkurrimit për kontratën e Ndërtimit të Ujësjellsve LOT 1 ka qenë Tender i hapur Ndërkombëtar:

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: Ndërtimi Ujësjellsave LOT 1		
1. Urdhër Prokurimi Nr. 1, datë 17.05.2018	3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit C. C.E. S. G.-G..	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave 1. L. M. (Kryetar) 2. D. M. (Anëtar) 3. E. O. (Anëtar)
2. Procedura e Prokurimit Tender i Hapur Ndërkombëtar ICB, post kualifikim sipas Udhëzuesit për prokurimet KFW Maj 2007.		
5. Vlera sipas Projektit (pa tvsh) 7,973,599 Euro	6. Oferta fituese (pa tvsh) 8,543,152.87 Euro	7. Diferenca me vlerën Projektit (pa tvsh) +5 69,553.87 Euro.
8. Data e hapjes së tenderit: 11.06.2018. Hapja e ofertave 02.07.2018. Shtyrë në datën 12.07.2018 me miratim të donatorit.	9. Burimi Financimit KFW, IPA 2013, Qeveria Shqiptare.	10. Operatorët Ekonomikë a) Aplikuar 5 Operatorë d) Kualifikuar 2 Operatorë c) Søkualifikuar 1 Operatorë
b. Zbatimi i Kontratës		
11. Lidhja e kontratës õJ. S.õ & õT. E.õ SHPK, datë 01.02.2019.	12. Vlera e kontratës (me tvsh) 10,354,970.93 Euro	13. Likuiduar deri datë 11.09.2020, - 100%

Nga auditimi i dosjes së prokurimit të vënë në dispozicion të grupit të auditimit, rezultoi sa më poshtë vijon:

- “No Objection” nga donatori për DST e procedurës së prokurimit, ka ardhur me e-mail në datën 11.05.2018. E-maili dërguar nga KFW tek menaxheri i projektit cilëson se FSHZH mund të procedojë me publikimin e dokumenteve të tenderit dhe për këtë të vihet në dijeni donatori. Në vazhdim, KFW ka kërkuar shpjegime/sqarime për DST. FSHZH është përgjigjur duke dhënë shpjegime për paqartësitë e donatorit në datën 07.06.2018, ora 11:36, ku i cilëson se korrigjimet

do të reflektohen përpara datës 11.06.2018, datë e cila përkon me hapjen e ofertave nga pjesëmarrësit në tender me qëllim që t'ju bëhen prezent propozimet tuaja.

Gjatë auditimit është konstatuar se DST për këtë projekt janë hartuar nga Konsulenti dhe me kontribut të ulët të strukturave përkatëse të FSHZH duke mos dhënë input të dokumentuar në këtë proces.

- Në datën 16.05.2018, me anë të një shkresë drejtuar Njesisë Juridike dhe Prokurimit, menaxheri i projektit, kërkon kryerjen e procedurës së prokurimit për Lotin I dhe konkretisht për:

a) Lot 1.1 (Gjyrez, Zicisht, Fitore, Dobraj, Bracanj, Sul, Poncare, Menkulas dhe Koshnicë) në Bashkinë Devoll;

b) Lot 1.2 (Kamenicë dhe Dvoran) në Bashkinë Korçë;

c) Lot 1.3 (Kovanik, Skënderbej, Bardhaj, Sutaj dhe Rrajcë fushë) në Bashkinë Përrenjas;

Vlera sipas projektit, është 7,973,599.17 Euro (pa TVSH).

- Urdhri i prokurimit është me nr. 1, dhe datë 17.05.2018. Komisioni i vlerësimit të ofertave është i përbërë nga L. M.-Kryetar (Përgjegjës i njesisë së projekteve hidroteknike), D. M.-Anëtar (Specialist i njesisë së projekteve të infrastrukturës rrugore) dhe E. O.-Anëtar (Përgjegjës i projekteve të punëve në komunitet). Tek urdhri prokurimit, është cilësuar se fondi limit për këtë procedurë është 7,973,599.17 Euro (pa TVSH). Metoda e prokurimit do të jetë Tender i Hapur Ndërkombëtar (ICB), post kualifikim, siç specifikohet në udhëzuesin e prokurimit të punëve dhe mallrave bazuar në bashkëpunimin financiar me vendet në zhvillim të KFW, hartuar në Maj 2007. Urdhri prokurimit është nënshkruar nga Drejtori ekzekutiv B. B..

Në këtë urdhër nuk është përcaktuar njësia e prokurimit në kundërshtim me kapitullin 9, nënkaptulli 9.1.2, Urdhri i Prokurimit, pika 571 gërma ðeð.

- Publikimi është bërë tek web-page i donatorit me adresë <https://www.gtai.de/gtai-en>, tek gazeta K. J., tek gazeta T. dhe tek web-page i FSHZH.

- Dokumentet e Tenderit janë tërhequr nga data 17.05.2018, deri në datën 02.07.2018, kundrejt pagesës nga 32 operatorë ekonomiksi në vijim: ðA. A.ð SHPK, ðC. 1. R. K.ð SHPK, ðA.I.ð SHPK, ðR. T.ð SHPK, ðA. S.A.ð SHPK, ðA.ð S., ðS.ð SHPK, ðA.-S.ð SHPK, ðS. C. L.ð, ðG. P.&F.ð S., ðG. K.ð SH.A, ðA. K.ð SHPK, ðB.-N.ð SHPK, ðA.ð L., ðV. I.ð SHPK, ðT. E. 2.ð SHPK, ðL. V.ð SH.A, ðE.ð L., ðT. S.ð S., ðE. E.ð D., ðL. P. H.-U. T.ð G. & C. K., ðA.-B.ð SHPK, ðG. 2.ð SHPK, ðE.ð A., ðC. D. I.ð C., ðGJ.ð SHPK, ðG. C.ð SHPK, ðA. K.ð SHPK, ðU. I. V. M. S.ð L. S., ðA. I. S. V. T.ð O., ðA. M. I. S. V. T.ð A., ðI. S.ðS., dhe ðC.ð SHPK.

- Në datën 11.06.2018, kanë qenë prezent dhe kanë dorëzuar ofertat 12 operatorë ekonomik sipas procesverbalit të mbajtur e të nënshkruar nga pjesëmarrësit në këtë procedurë.

- Në datën 14.06.2018, është miratuar nga donatori shtyrja e datës së tenderit nga data 02.07.2018, në datën 12.07.2018, për arsye të reflektimit të disa sugjerimeve nga KFW. Kjo e vërtetuar me e-mailin e datës 14.06.2018, ora 16:08 dërguar nga A. D. (D.a.@kfw.de) tek A. Z. (a.@albaniandf.org).

- Reflektimet dhe korrespondenca e FSHZH me donatorin për miratimin e disa korigjimeve ka vazhduar deri në datën 19.06.2018, datë në të cilën janë dërguar gjithashtu tek donatori edhe minutat e takimit me ofertuesit të cilët janë vënë në dijeni për korigjimet e bëra nga donatori.

- Ofertat janë hapur në datën 12.07.2018, dhe kanë rezultuar se ato janë 5 dhe konkretisht sipas procesverbalit të mbajtur për minutat e takimit: ðE. A.ð-Greqi, ðA. I.ð-Azerbajxhan, ðJ. T. E. 2.&S.ð-Shqipëri&Austri, ðL. P.H.ð-Gjermani dhe ðJ. C.&R.ð-Shqipëri&Bullgari. Për dy operatorët e fundit është cilësuar fakti se kanë disa mangësi.

- Në datën 17.09.2018, i janë dhënë sqarime donatorit në lidhje me para-kualifikimin e operatorëve pjesëmarrës në tender.

- Raporti i vlerësimit është nënshkruar në datën 17.09.2018, nga komisioni i vlerësimit të ofertave i përbërë nga L. M., D. M. dhe E. O.. Në stadin e dytë të Post Qualification, janë kualifikuar dy oferta dhe përkatësisht nga operatorët ekonomikë J. T. E. 2. & S.ö ó Shqipëri & Austri dhe J. C. & R.ö - Shqipëri & Bullgari. Të njëjtët operatorë janë kualifikuar edhe në stadin e tretë të Technical Evaluation.
- Donatori është vënë në dijeni për fazat e vlerësimit në datën 08.10.2018, me e-mail në orën 09:46 nga A. Z. (a..@albanianidf.org) . Tek ky e-mail cilësohet se ofertat ekonomike pasi të hapen do të informohet përsëri donatori.
- Në datën 16.10.2018, është mbajtur procesverbali i hapjes së ofertave ekonomike nga ku ka rezultuar se operatori ekonomik J. T. E. 2. & S.ö - Shqipëri & Austri ka dhënë ofertën në vlerën 8,543,152.87 Euro (pa TVSH) dhe J. C. & R.ö - Shqipëri & Bullgari 6,692,390.83 Euro (pa TVSH).
- Në datën 25.10.2018, Komisioni i vlerësimit të ofertave, ka mbajtur procesverbalin e vlerësimit të ofertës ekonomike dhe propozon që fitues të shpallet oferta më e ulët ajo e operatorit ekonomik J. U. & R.ö SHPK ó Shqipëri & Bullgari me vlerë 6,692,390.83 Euro (pa TVSH).
- Në datën 02.09.2018, Drejtori Ekzekutiv i FSHZH, njofton operatorin ekonomik J. C. & R.ö SHPK, se është shpallur fitues i tenderit.
- Në datën 08.11.2018, KFW ka miratuar draft kontratën dhe ka udhëzuar FSHZH për të vijuar me nënshkrimin e saj me operatorin e shpallur fitues.
- Në datën 20.11.2018, me e-mail, operatori ekonomik i shpallur fitues J. C. & R.ö SHPK, njofton FSHZH se tërhiqet nga tenderi për arsye të pjesëmarrjes në tendera të tjerë në Bullgari. Kërkesa është e pa protokolluar në FSHZH dhe ka vetëm firmën e T. S. në rolin e përfaqësuesit ligjor të operatorit ekonomik. Për këtë tërheqje është vënë në dijeni edhe donatori. Në vazhdim, nga korrespondencat e evidentuara në dosjen e tenderit, janë kërkuar sqarime nga operatori i dytë për të bërë një analizë të çmimeve të preventivit të ofertës meqenëse ajo është më e lartë se kostoja paraprake e përlogaritur e projektit. Për këto korrespondenca është vënë në dijeni vazhdimisht donatori i cili ka bërë dhe miratimet e tij. Procesverbali i minutave të negociimit me operatorin ekonomik të renditur në vendin e dytë, është mbajtur në datën 07.01.2019, në orën 13:00.
- Në datën 04.02.2019, donatori ka miratuar tërheqjen e operatorit ekonomik J. C. & R.ö SHPK dhe është shprehur se është dakord për lidhjen e kontratës midis FSHZH dhe operatorit të dytë të kualifikuar J. T. E. 2. & S.ö SHPK.
- Njoftimi i fituesit është më datë 04.02.2019. Kontrata nr. RWSP-WC- ICB-2018-1 lidhur me operatorin ekonomik J. T. E. 2. & S.ö SHPK dhe Fondit Shqiptar të Zhvillimit është e pa protokolluar. Kjo kontratë nuk është nënshkruar në çdo faqe nga specialistët që e kanë hartuar në kundërshtim me kapitulli 9 nënkaptulli 9.1.6, pika 593 dhe 594, të Manualit të Procedurave të FSHZH miratuar me Vendimin nr. 167, datë 06.12.2018, i ndryshuar.
- Në datën 21.02.2020, është hartuar kërkesa nga Përgjegjësi i Njësisë së Projekteve drejtuar Departamentit Juridik dhe të Prokurimit për amendimin e kontratës dhe shtyrjen e afatit të ekzekutimit të saj për në datën 31.05.2020. Arsyeja është se ARRSH ka vonuar në dhënien e lejeve për punime në rrugë. Kërkesa është e pa protokolluar.
- Amendamenti nr. 1, është me nr. 140/3 prot., datë 24.02.2020. Afati i përfundimit të ekzekutimit të punimeve bëhet 31.05.2020.
- Në datën 28.05.2020, është hartuar kërkesa nga Përgjegjësi i Njësisë së Projekteve drejtuar Departamentit Juridik dhe të Prokurimit për amendimin e kontratës dhe shtyrjen e afatit të

ekzekutimit të saj për në datën 15.06.2020. Arsyeja është se pandemia COVID 19, ka influencuar negativisht në respektimin e afateve të ekzekutimit. Kërkesa është e pa protokolluar.

- Amendamenti nr. 2, është me nr. 1132 prot., datë 03.06.2020. Afati i përfundimit të ekzekutimit të punimeve bëhet 15.06.2020.

- Memo drejtuar Drejtorit Ekzekutiv, Drejtorit të Departamentit të Menaxhimit të Projekteve dhe Drejtorit të Departamentit Juridik dhe Prokurimeve, nga Përgjegjësi i Njesisë së Projekteve, është pa numër protokoll. Kjo Memo është në vetvete një kërkesë për rishikimin e vlerës së kontratës lidhur me taksën e plastikës të shtuar me Ligjin nr. 93/2018, në skemat e RWSP III, Lotet 1, 2 dhe Lotin 4.

- Amendamenti nr. 3, është me nr. 1132/1 prot., datë 05.06.2020. Vlera që duhet shtuar në kontratën bazë pas ndikimeve të ligjit të mësipërm për taksën e plastikës, rezulton të jetë 18,202,637 lekë. Kjo vlerë do të paguhet nga buxheti që i është alokuar FSHZH-së, zëri TVSH.

- Në datën 29.09.2020, është hartuar kërkesa nga Përgjegjësi i Njesisë së Projekteve drejtuar Departamentit Juridik dhe të Prokurimit për amendimin e kontratës dhe shtyrjen e afatit të ekzekutimit të saj për në datën 11.09.2020. Arsyeja është se pandemia COVID 19, ka influencuar negativisht në respektimin e afateve të ekzekutimit. Kërkesa është e pa protokolluar.

- Amendamenti nr. 4, është me nr. 1132/2 prot., datë 29.09.2020. Afati i përfundimit të ekzekutimit të punimeve bëhet 11.09.2020.

Dosja e procedurës së prokurimit nuk është e inventarizuar dhe arkivuar në kundërshtim me nenin 3, dhe 29, të ÷Norma Tekniko Profesionale dhe Metodologjisë të Shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisë, miratuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave, në zbatim të Ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003, ÷Për Arkivat.

4.2 Për auditimin e procedurës së prokurimit për kontratën e punimeve Ndërtim/Rikonstruksion i Ujësjetësve në zonat rurale LOT 4.

Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion, rezultoi se procedura e konkurrimit për kontratën e **Ndërtim/Rikonstruksion i Ujësjetësve ne zonat rurale LOT 4** ka qenë Tender i hapur Ndërkombëtar:

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: Ndërtimit të Ujësjetësve LOT 4		
1.Urdhër Prokurimi Nr. 4 datë 21.11.2018	3.Hartuesit e Dokumenteve Tenderit C. C. E. S. G.	4.Komisioni i Vlerësimit Ofertave 1. L. M. (Kryetar) 2. D. M. (Anëtar) 3. E. O. (Anëtar)
2. Procedura e Prokurimit Tender i Hapur Ndërkombëtar ICB, post kualifikim sipas Udhëzuesit për prokurimet KFW Maj 2007.		
5.Vlera sipas Projektit (pa tvsh) 8,267,198 Euro	6.Oferta fituese (pa tvsh) 7,897,969.30 Euro	7. Diferenca me vlerën Projektit (pa tvsh) 369,228.7 Euro
8. Data e hapjes së tenderit: 07.01.2019 Afati për dorëzimin.	9.Burimi Financimit KfW, IPA 2013, Qeveria Shqiptare.	10.Operatoret Ekonomike a) Aplikuar 4 Operatorë d) Kualifikuar 2 Operatorë c) Søkualifikuar 2 Operatorë
b. Zbatimi i Kontratës		

11. Lidhja e kontratës BOE A. shpk & A. G. O. nr. datë 18.04.2019	12. Vlera e kontratës (me tvsh) 9,477,563.20 Euro	13. Likuiduar deri datë 31.05.2021- 6,490,976.50 Euro
--	---	---

7 kompani kanë treguar interes duke blerë dokumentat e tenderit por më datën 07.01.2019, afat i hapjes së tenderit, vetëm 4 operatorë kanë dërguar propozimet si më poshtë:

Operatori	Qyteti/Provinca	Shteti
J. A. shpk & A. G. O.	Tirana/Baku	Albania/Azerbajjan
L. P. H. & T. G.	Kassel	Germany
A.-S. shpk	Tirana	Albania
J. A. s. & 2. shpk	Puglia/Tirana	Italy/Albania

Për këtë proces tenderimi është përdorur metoda me dy zarfe. Zarfi i jashtëm duhet të përmbante këto dokumente:

- 1- Garancinë e tenderit
- 2- Pyetësorët dhe Formularët e kualifikimit
- 3- Zarfin e Brendshëm

Komisioni i vlerësimit të ofertave ka kryer vlerësimin sipas hapave të mëposhtëm.

Hapi 1- Vlerësim paraprak gjatë hapjes së tenderit ku është bërë vlerësimi i përmbajtjes së të gjitha dokumenteve referuar kërkesave. Të katërt Operatorët kanë paraqitur dokumentacion të plotë dhe kane kaluar këtë hap.

Hapi 2- Post Kualifikimi i cila ka të bëjë me plotësinë, konformitetin ndaj dokumenteve të tenderit dhe pajtueshmërinë me kërkesat. Gjatë vlerësimeve të kryera në këtë hap Komisioni i Vlerësimit ka kualifikuar dy operatorët BOE òA.ò shpk & òA. G.ò O. dhe òL. P. H. & T. G.ò dhe ka shkualifikuar òA.-S.ò shpk dhe J.òA. s. & 2.ò shpk për arsytet e mëposhtme:

òA.-S.ò shpk rezultoi i pakualifikueshëm sepse KVO gjeti mospërputhjet e mëposhtme.

- Për kriterin 3.2 (a) kontrata të ngjashme, Operatori nuk e përmbush kriterin. Kriteri është që operatori duhet të ketë 2 kontrata të ngjashme secila minimum me vlerë 7,000,000 Euro dhe operatori s'ka paraqitur asnjë të tillë.
- Operatori nuk përmbush as kriterin e angazhimeve aktuale.

J.òA.s. & 2.ò ShPK rezultoi i pakualifikueshëm sepse KVO gjeti mospërputhjet e mëposhtme.

- Për kriterin 3.2 (a) kontrata të ngjashme, bashkimi i operatoreve nuk e përmbush kushtin sepse ka prezantuar vetëm një kontratë punime të ngjashme me vlerë minimum 7,000,000 Euro.
- Për kriterin 2.3 iii, Pozicioni Financiar, a) Raporti i Likuiditetit dhe Raporti i borxheve nuk përmbushin kushtin sepse për A. s. raporti i borxhit është mbi 80% për tre vite dhe raporti i likuiditetit është nën 1.1 për 2015 dhe 2016.
- Për kriterin 2.1, Kapacitete Financiare BOE nuk përmbush kriterin.
- Për kriterin 3.2 (b) Aktivitete Kyçe Ndërtimore të Kryera, BOE ka raportuar asgjë për nën kriteret.
- Në total Tuba të ujësjellësve HDPE ose PE 100 RC DN> 50mm më shumë se 20km.
- Numri total i shtëpive të lidhura me ujësjellës më shumë se 1000.

Hapi 3- Vlerësimi teknik është kryer nga KVO vetëm për dy operatorët që kanë kaluar hapin e parë dhe të dytë, dhe të dy operatorët janë kualifikuar për vlerësimin financiar.

Më 17 janar 2019 Raporti i Vlerësimit i është dërguar KFW për *no objection*. KFW ka bërë komente të cilat duhet të reflekttoheshin. Bazuar korrespondencës me KFW këto komente janë reflektuar dhe është përgatitur Raporti i Vlerësimit i Rishikuar për të cilin banka ka dhënë miratimin me *no Objection* por këto dokumente të ndërmjetme nuk janë përfshirë në dosjen e prokurimit.

Me 26 Shkurt 2019, është kryer hapja e propozimeve financiare me përfaqësuesit e kompanive të kualifikuara.

Operatori	Shteti	Vlera pa TVSH
L. P. H. & T. G.	Germany	12,499,731.79
J. A. shpk & A. G. O.	Albania/Azerbaijan	7,897,951.00

Më 12 Mars 2019 është hartuar Raporti i vlerësimit Financiar, ku ofertave i janë gjetur gabime aritmetike dhe kane rezultuar si më poshtë:

Operatori	Vlera pa TVSH	Vlera me TVSH	Devijimi nga CE	Renditja
L. P. H. & T. G.	12,400,111.27	14,880,133.50	-4.47%	1
J. A. shpk & A. G. O.	7,897,969.30	9,477,563.20	+49.99%	2

Më 5 mars 2019, Raporti i Vlerësimit Financiar i është dërguar KFW për *no objection*. KFW ka bërë komente të cilat duhet të reflekttoheshin. Bazuar në korrespondencën me KfW këto komente janë reflektuar dhe është përgatitur Raporti i Vlerësimit i Rishikuar për të cilin banka ka dhënë *no Objection* por këto dokumenta nuk janë përfshirë në dosjen e prokurimit.

Kontrata No. RWSP-WC-ICB-2018-4 lidhur midis Fondit Shqiptar të Zhvillimit dhe BOE òA.ò shpk & òA. G.ò O. më datë 18.04.2019, me objekt Ndërtim/Rikonstruksion i Ujësjesave në zonat rurale LOT 4 është e pa protokolluar dhe nuk është e nënshkruar në çdo faqe nga specialistet që e kanë hartuar në kundërshtim me kapitulli 9 nënkaptulli 9.1.6, pika 593 dhe 594, të Manualit të Procedurave të FSHZH miratuar me Vendimin nr. 167, datë 06.12.2018, i ndryshuar.

Kjo kontratë ka pësuar 6 ndryshime.

- Amendamenti nr. 1, i nënshkruar nga palët më 24.05.2019, është i pa protokolluar. Ky amendament ndryshon nenin 14.2 Shuma totale e Parapagimit, të seksionit Të Dhënat e Kontratës, Pjesa A. Me këtë ndryshim rritet përqindja e Parapagimit nga 10% në 20% të Vlerës së Kontratës.Referuar nenit 14.2, të kushteve të përgjithshme të kontratës, kontraktori duhet të dërgojë tek punëdhënësi një garanci në shumë të barabartë me vlerën e parapagimit.

Garancia për parapagimin është dorëzuar më 29.05.2021, dhe është e barabartë me 20%.

- Më datë 28.05.2020, është hartuar kërkesa nga Përgjegjësi i njësisë së projekteve utilitare mbi amendimin nr. 2, drejtuar Departamentit Juridik dhe të Prokurimit për shtesë të afatit të përfundimit të punimeve. Kjo shkresë është e pa protokolluar.Amendamenti 2, nr. 1134 prot., datë 03.06.2020, ndryshon afatin e përfundimit të punimeve si pasojë e tërmetit M 6.5 dhe Covid 19 me një shtesë prej 77 ditësh deri më 31 Korrik 2020 pa ndikuar në vlerën e kontratës.

- Memo drejtuar Drejtorit Ekzekutiv, Drejtorit të Departamentit të Menaxhimit të Projekteve dhe Drejtorit të Departamentit Juridik dhe Prokurimeve, nga Përgjegjësi i Njësisë së Projekteve, është pa numër protokoll. Kjo memo është në vetvete një kërkesë për rishikimin e vlerës së kontratës lidhur me taksën e plastikës të shtuar me Ligjin nr. 93/2018, në skemat e RWSP III, Lotet 1, 2 dhe Lotin 4 dhe në bazë të sajë është hartuar Amendamenti 3, nr. 1134/1, datë 05.06.2020, i cili bën ndryshimin për Rimbursim Takse për materiale plastike nga ndryshimi i Ligjit nr. 9975, datë 28.07.2008, me Ligjin nr. 93/2018, si rrjedhojë punëdhënësi i paguan kontraktorin vlerën 19,256,449 Lekë.

- Më datë 29.09.2020, është hartuar kërkesa nga Menaxheri kontratës, Përgjegjësi i njësisë së projekteve utilitare dhe Drejtori i departamentit të menaxhimit të projekteve mbi amendimin nr. 4, drejtuar Departamentit Juridik dhe të Prokurimit për shtesë të afatit të përfundimit të punimeve. Kjo shkresë është e pa protokolluar. Amendamenti 4, nr. 1134/2, datë 29.09.2020, ndryshon afatin e përfundimit të punimeve si pasojë e pandemisë Covid 19 me një shtesë prej 142 ditë më datë përfundimi punimesh më 20.12.2020, pa ndikuar në vlerën e kontratës.
- Më datë 29.01.2021, është hartuar kërkesa nga Menaxheri kontratës, Përgjegjësi i njësisë së projekteve utilitare dhe Drejtori i departamentit të menaxhimit të projekteve mbi amendimin nr. 5, drejtuar Departamentit Juridik dhe të Prokurimit për shtesë të afatit të përfundimit të punimeve. Kjo shkresë është e pa protokolluar. Amendamenti 5, nr. 556, datë 04.02.2021, ndryshon afatin e përfundimit të punimeve si pasojë e pandemisë Covid 19 me një shtesë prej 71 ditë me datë përfundimi punimesh më 01.03.2021, pa ndikuar në vlerën e kontratës.
- Kërkesa pa datë dhe pa numër protokolli është hartuar nga Menaxheri kontratës, Përgjegjësi i njësisë së projekteve utilitare dhe Drejtori i departamentit të menaxhimit të projekteve, drejtuar Departamentit Juridik dhe të Prokurimit për Amendament nr. 6, me arsye shtesë afati për përfundimin e kontratës si pasojë e Covid 19. Amendamenti 6, nr. 1050, datë 17.03.2021, ndryshon afatin e përfundimit të punimeve si pasojë e pandemisë Covid 19 me një shtesë prej 51 ditë më datë përfundimi punimesh më 20.04.2021, pa ndikuar në vlerën e kontratës.

Dosjet e procedurave të prokurimit, nuk janë të inventarizuara dhe arkivuara në kundërshtim me nenin 3 e 29 të òNorma Tekniko Profesionale dhe Metodologjisë të Shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisë, miratuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave, në zbatim të Ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003, òPër Arkivatö.

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se për këtë projekt nuk është hartuar një Plan Prokurimi në kundërshtim me kapitullin 9, nën-pika 9.1, Fazat e procesit të prokurimit të Manualit të Procedurave të FSHZH miratuar me Vendimin nr. 167, datë 06.12.2018, i ndryshuar. Për sa më sipër rezulton se angazhimi i strukturave përkatëse të FSHZH në këtë projekt ka qenë i pjesshëm dhe megjithatë në këto raste është shoqëruar nga mungesa e gjurmës së auditimit.

1. Titulli i gjetjes: Mos inventarizim i dosjeve të prokurimit dhe dokumente të pa protokolluara.

Situata: Nga auditimi i procedurave të prokurimit të projektit òFurnizimi me ujë i zonave rurale IIIö u konstatua se, dosjet e prokurimit nuk ishin të inventarizuara dhe arkivuara, gjithashtu shumë prej shkresave, kontratave amendamenteve rezultuan të pa protokolluara.

Kriteri: Neni 3 e 29 të òNorma Tekniko Profesionale dhe Metodologjisë të Shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisë, miratuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave, në zbatim të Ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003, òPër Arkivatö, ku përcaktohet se:

Pranë çdo subjekti shtetëror e jo shtetëror funksionon sekretaria dhe arkivi apo sekretari-arkivi, pjesë strukturore që përgjigjet për administrimin e dokumenteve të krijuara, apo të ardhura në adresë të tij. Në mungesë të një strukture të veçantë, me urdhër me shkrim të titullarit të institucionit, ngarkohet një punonjës për punën me dokumentet.

Mbi kapakun e dosjes (Mod. 6) shkruhet me bojë apo shtypet pastër dhe sipas rregullave të drejtshkrimit: emërtimi i plotë zyrtar i organit shtetëror apo jo shtetëror, sektori apo dega e veprimtarisë, shkalla e klasifikimit sekret (nëse dokumenti është i tillë), numri i dosjes, viti, titulli i plotë i dosjes, afati i ruajtjes, datat ekstreme, sasia e

dokumenteve që ka dosja, numri i inventarit të dosjes dhe afati i shfrytëzimit. Titulli i dosjes pasqyron drejt e në mënyrë të përmbledhur përmbajtjen e dokumenteve që përfshihen në të, është i qartë dhe i plotë dhe përmban llojin e dokumenteve që përfshihen në dosje, emërtimin e autorit të dokumenteve, emërtimin e korrespondentit, çështjen (objektin) së cilës i referohet përmbajtja e dokumenteve dhe, sipas rastit, vendin dhe datën që përmbajnë dokumentet. Në rast se dosja përbëhet nga disa vëllime (fraksione) me përmbajtje të njëllotë, të gjitha vëllimeve u vihet një titull i përbashkët, duke shtuar në vëllimin e fundit shënimin: “vëllimi i fundit”. Në përshkrimin e dosjeve me dokumente që kanë vlerë të veçantë, theksohet dhe qenia e tyre në origjinal apo kopje dhe mënyra e riprodhimit (dorëshkrim, daktilografim, fotokopje etj.). Kur në një dosje, krahas dokumenteve të tjera, ka dokumente shumë të rëndësishme, përmbajtja e këtyre të fundit pasqyrohet në mënyrë më të hollësishme në shënimin e dosjes.

Ndikimi/Efekti: Bëhet shkas për mos dokumentim ose tjetërsim të fakteve dhe provave në kohë.

Shkaku: Mosnjohje e legjislacionit të fushës përkatëse.

Rëndësia: E mesme.

Rekomandimi: Fondi Shqiptar i Zhvillimit/Njësia e Menaxhimit të Projektit, të marrë masa për protokollimin dhe arkivimin e të gjitha dosjeve të procedurave të prokurimit të zhvilluara për këtë Projekt në zbatim të Normave Tekniko Profesionale dhe Metodologjisë të Shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisë.

2. Titulli i gjetjes: Mungesa e Planit të Prokurimit.

Situata: Për projektin ÷Furnizimi me ujë i zonave rurale III÷ konstatohet se nuk është hartuar një Plan Prokurimi, veprime këto në kundërshtim me kapitullin 9, nënpika 9.1, ÷Fazat e procesit të prokurimit÷ të Manualit të Procedurave të FSHZH miratuar me Vendimin nr. 167, datë 06.12.2018, i ndryshuar.

Kriteri: Kapitulli 9 nënpika 9.1 Fazat e procesit të prokurimit të Manualit të Procedurave të FSHZH miratuar me Vendimin nr. 167, datë 06.12.2018, i ndryshuar,

Ndikimi/Efekti: Mos kryerja e një analize për realizimin ose mosrealizimin e planit të parashikuar.

Shkaku: Mangësi në zbatimin e rregullores së brendshme të institucionit.

Rëndësia: E mesme.

Rekomandimi: Fondi Shqiptar i Zhvillimit, strukturat përkatëse të prokurimit sipas rastit, të marrin masa që në të ardhmen përpara kryerjes së procedurave të prokurimit për realizimin e projekteve të miratuara më parë, të planifikojnë dhe dokumentojnë prokurimet që do të kryhen në fazën e parashikimit në konformitet me ligjet, rregullat dhe manualët në fuqi.

3. Titulli i gjetjes: Angazhim i pjesshëm i strukturave të FSHZH-së.

Situata: Nga auditimi i dokumentacionit mbi procedurat e realizimit të projekteve që në fazën e studimit të fizibilitetit, referuar edhe skeduleve apo manualeve për zbatim të projekteve të miratuara nga donatori, ka rezultuar se angazhimi i strukturave përkatëse të FSHZH në projektin ÷Furnizimi me ujë i zonave rurale III÷ ka qenë i pjesshëm, shoqëruar në disa raste edhe nga mungesa e gjurmës së auditimit.

Kriteri: Appendix 2, RWSP IMPLEMENTATION FRAMEWORK.

Ndikimi/Efekti: Bëhet precedent për mbulimin e gjurmëve të auditimit në të ardhmen dhe njëkohësisht për shmangie të përgjegjësisë së stafit të FSHZH.

Shkaku: Mos respektimi me qëllim i rregullave dhe manualeve të projektit.

Rëndësia: E Lartë.

Rekomandimi: Fondi Shqiptar i Zhvillimit, Drejtoria Juridike dhe Drejtoria Teknike, të marrin masa që në të ardhmen të angazhohen në çdo projekt në konformitet me manualet dhe rregulloret në fuqi me qëllim përmirësimin e cilësisë së ekzekutimit të projekteve, si nga ana ligjore ashtu dhe teknike duke pasur parasysh lënien e gjurmës së auditimit.

Për sa trajtuar më sipër është mbajtur Akt konstatimi 5, nr. 1882/6 prot., datë 30.07.2021

5. Mbi zbatimin e kontratave të punimeve civile, mallrave e shërbimeve.

5.1 Për kontratën “Ndërtim/Rikonstrukcion i Ujësjellësve në zonat rurale LOT 4”.

Përshkrim i përgjithshëm.

Projekti “Ndërtim/Rikonstrukcion i Ujësjellësve në zonat rurale LOT 4”, përfshin Bashkinë e Tiranës dhe Bashkinë e Durrësit dhe është e ndarë në 4 komponent.

Komponenti 4.1, zbatohet në njësinë Administrative Zall Bastar dhe në skemë përfshihen fshatrat Zall-Bastar, Zall-Dajt, Besh, Shëngjin i Vogël, Kodër Shupal, Mal Vilës e Poshtme.

Komponenti 4.2, në Bashkinë Durrës zbatohet në njësinë administrative Rrashbull, Shkëmbi i Kavajës.

Komponenti 4.3, në Bashkinë Durrës, zbatohet në njësinë Administrative Rrashbull në fshatrat Arapaj dhe ish-Xhafzotaj.

Komponenti 4.4, në Bashkinë Durrës, zbatohet në njësinë Administrative Katundi i Ri, në fshatrat Jube, Erzen, Katundi i Ri, Fllakë, Sektori Rinia, Qerret, Manëz, dhe Lagjja e Mirditorëve.

Kontrata e zbatimit të punimeve për këtë Lot është firmosur më datë 18.04.2019, me BOE òA.ò SHPK dhe òA.ò G. me vlerë 7,897,969.32 Euro pa TVSH dhe 9,477,563.18 Euro me TVSH. Njoftimi për fillimin e punimeve i është dërguar kontraktorit më datë 03.05.2019, me datë fillimi 17.05.2019. Afati fillestar për përfundimin e punimeve ka qenë data 15.05.2020. Nëpërmjet Amendamenteve dhe VO kontraktori ka përfutur disa shtyrje afati në total prej 340 ditësh. Zbatimi i punimeve për këtë LOT ka përfunduar më 26.04.2021, 6 ditë me vonesë për të cilat i janë mbajtur penaltetet Delay Damages për vonesën në vlerën 47,387.82 Euro.

IPC-ja e fundit certifikuar nga Supervizori për periudhën objekt auditimi është IPC nr. 7, më 11.12.2020, dhe vlera totale e ekzekutuar dhe e vërtetuar kumulative e punimeve ishte 7,016,260,92 Euro.

Situacioni Përfundimtar Pjesa 1, i datës 26.04.2021, pasqyron një përqindje totale të punimeve prej 98.4%. Pjesa tjetër prej 1.6% nuk është paguar për punime të pakryera.

Nga auditimi i zbatimit të punimeve për komponentin 4.1 Skema Zall Bastar dhe Vilëz rezultoi se punimet për këtë nën komponent kanë përfunduar. Punimet për këtë skemë përfshinin, rrjetin kryesor me instalimin 9,426 metra tubacione, rrjetin e shpërndarjes me instalimin e 14,419 ml tubacione, ndërtime rezervuarësh, dhomat e klorinimit, puseta valvulash ajrimi/reduktimi presioni etj., vendosje hidrantësh dhe matës uji etj.,.

1. Nga verifikimi në terren i zërave të punimeve u konstatuan se në zonën rrethuese të rezervuarve Kodër Shupal dhe Zall Dajt nuk ishin kryer punimet e peizazhit si sistemime me bar etj.,.
2. Pusetat e Valvulave gjatë inspektimit në terren të disa prej tyre u konstatua të ishin të mbushura me baltë dhe ujë në brendësi.
3. U konstatua se një pjesë e kasetave të matësve të ujit ishin të mbushur me ujë dhe tregonin vlerë konsumimi uji 0 ose shumë pak.
4. Të gjitha dhomat e klorinimit nuk funksiononin për shkak të palëve të treta, konkretisht mos lidhjes së kontratave mes Bashkive respektive dhe OSHEE. Detyrimi i kontraktorit ka qenë të ndërtoje linjën e transmetimit 220V deri tek dhoma e klorinimit dhe kjo është realizuar.

5. Në Zall-Dajt u konstatua se disa familje furnizoheshin me ujë me linjën ekzistuese dhe jo me linjën e ujës jellësit të ri.

Nga auditimi i zbatimit të kontratës për komponentin 4.2 (Rrashbull, Shkëmbi i Kavajës)

rezultoi se punimet për këtë nën komponent kanë përfunduar. Punimet për këtë skemë përfshinin, rrjetin e shpërndarjes me instalimin 6,208 metra tubacione, pusetat e devijimit (Taping chamber), Vendosje Hidrantësh dhe matës uji.

1. Nga verifikimi në terren i zërave të punimeve u konstatuan raste ku tubacioni i furnizimit me ujë të shtëpive nuk ishte vendosur nëntokë sipas specifikimeve të projektit por për 2-3 m e fundit nga kutia e sahateve tubacioni qëndronte mbi tokë.
2. Pusetat e Devijimit (Tapping point Chamber) - u konstatua të ishin të mbushura me baltë dhe ujë në brendësi.
3. U konstatua një pjesë e sahateve tregonin 0 vlerë konsumimi uji.

Nga auditimi i zbatimit të punimeve për komponentin 4.3 (njësia Administrative Rrashbull në fshatrat Arapaj dhe ish-Xhafzotaj)

rezultoi se punimet kanë përfunduar. Punimet për këtë skemë përfshinin rrjetin e shpërndarjes me instalimin e 65,550 ml tubacione, vendosje Hidrantësh, kasetat e matësve të ujit, pusetat e reduktimit të presionit, dhomë e re komandimi.

1. Nga verifikimi në terren i punimeve për zërin 2. Dhomë e Re Valvulash Komandimi rezultoi se mbajtësja në shkallët e jashtme nuk ishte instaluar.
2. Muret e brendshme prej betoni duhet të riparoheshin.
3. Punimet elektrike për dritat duhet të ribëheshin sipas specifikimeve në drita të varura.

Nga auditimi i zbatimit të kontratës për komponentin 4.4 (në njësinë Administrative Katundi i Ri)

rezultoi se punimet kanë përfunduar. Punimet për këtë skemë përfshinin punime për rrjetin e dërgimit me instalimin e 20,358 ml tubacion, rrjetin e shpërndarjes me instalimin e 166,842 ml tubacion, puseta shkarkimi, puseta ajruese, hidrantë, kaseta të matësve të ujit, pikat lidhëse, rehabilitimi i dhomës së kontrollit dhe ambientit rrethues, ndërtimi i kullës së re të ujit.

1. Nga verifikimi në terren i punimeve për zërat rehabilitimi i dhomës së kontrollit dhe ambientit rrethues dhe ndërtim i kullës së re të ujit rezultoi se një pjesë e gardhit rrethues nuk është vendosur sipas specifikimeve teknike.
2. Rezervuari në momentin e inspektimit nuk ishte i mbushur me ujë, duke mos siguruar furnizim 24 orë me ujë.
3. Betoni në disa sipërfaqe duhet të riparohet sipas specifikimeve teknike.

Nga data 28.04.2021, palët janë angazhuar për të filluar procesin e inspektimit për Certifikatën e Marrjes në dorëzim dhe verifikimet e punimeve për përgatitjen e listës së mangësive për punime të pakryera, të cilat nuk ndikojnë në funksionimin e skemave. Të gjitha mangësitë e hasura nga grupi i auditimit janë përfshirë në listë dhe për to kontraktori nuk është paguar.

Për punime të vogla të pambaruara të përfshira në listë, kontraktori i është dhënë një afat kohor prej 45 ditësh, për korrigjimin e mangësive deri më 10.06.2021. Certifikata e Marrjes në Dorëzim bashkë me listën e sipërpërmendur janë lëshuar më 31.05.2021, me kusht që testi i performancës në skemën e Tiranës L 4.1 dhe kullën e ujit L 4.4 të përfundojë deri më 10.06.2021. Nëse kjo nuk realizohet Periudha e Njoftimit të Defekteve DNP-ja do të zgjatet paralel me kohën në të cilën do të përfundojë testi i Performancës.

Shumë prej zërave të përmendura në listën (Snagging List) nga krahasimi i bërë me verifikimit në terren të grupit të auditimit rezultuan ende të pakryera dhe nga ana e FSHZH nuk është marrë asnjë masë për të nisur një rinspektim për të verifikuar gjendjen sipas afatit të përcaktuar më 10.06.2021.

- 1. Titulli i gjetjes:** Mos verifikim i gjendjes së punimeve pas lëshimit të certifikatës.
- Situata:** Nga auditimi u konstatua se, shumë prej zërave të listuara në listën e punimeve të vogla të pakryera (Snagging List) që shoqëron certifikatën e marrjes në dorëzim, nga krahasimi i bërë me verifikimin në terren të grupit të auditimit rezultuan ende të pakryera dhe nga ana e FSHZH nuk është marrë asnjë masë për të nisur një rinspektim për të verifikuar gjendjen sipas afatit të përcaktuar në të më datë 10.06.2021.
- Kriteri:** Kontrata No. RWSP-WC-ICB-2018-4 lidhur midis Fondit Shqiptar të Zhvillimit dhe BOE A. shpk & A. G. O. më 18.04.2019, me objekt Ndërtim/Rikonstruksion i Ujësjetësve në zonat rurale LOT 4.
- Ndikimi/Efekti:** Mungesa e riparimeve dhe e përfundimit të korigjimeve të nevojshme për punime
- Shkaku:** Mos kryerja e një ri-inspektimi për verifikim.
- Rëndësia:** E mesme.
- Rekomandimi:** Fondi Shqiptar i Zhvillimit/Njësia e Menaxhimit të Projektit të marrë masat për të kryer inspektimin për verifikimin e gjendjes dhe të adresohen shkaqet e përgjegjësitë e punimeve të mbetura ende pa kryer si dhe të adresohen mënyrat e përfundimit të tyre referuar kontratës.

5.2. Për kontratën Ndërtim/Rikonstruksion i Ujësjetësve në zonat rurale LOT 1

Përshkrim i përgjithshëm. Kjo kontratë është e ndarë në tre nën lote si më poshtë:

Lot 1.1, Menkulas, Poncar, Bracanj, Dobraj, Zicisht, Sul, Gjyrez, Fitore dhe Koshnicë në Bashkinë Devoll.

Lot 1.2, Kamenice dhe Dvoran në Bashkinë Korçë.

Lot 1.3, Kovanik, Skënderbej, Sutaj, Bardhaj dhe Rrajcë fushë në Bashkinë Përrenjas.

Punimet e zbatimit për këtë lot kanë filluar më 26.02.2019 dhe data fillestare për përfundimin e punimeve ishte 26.02.2020. Kontraktori ka përfituar shtesë afati nëpërmjet 3 amendamenteve duke rezultuar në total 199 ditë shtesë me afat përfundimtar të punimeve datën 11.09.2020. Punimet kanë përfunduar më 15.09.2020, tre ditë mbi afatin e përcaktuar për të cilat është mbajtur penaliteti për vonesa Delay Damages. Nga data 16.09.2020, Kontrata e Lotit I është në fazën e njoftimit të defekteve për 12 muaj.

Vlera finale e punimeve të kryera në Lotin I është 8,511,730.66Euro. Pas zbritjes së penaliteteve për vonesa DD shpenzimet janë 8,485,843.23 Euro krahasuar me vlerën fillestare të kontratës 8,629,142.44 Euro. Pra është kursyer 1.36% në vlerën 143,299.21 Euro. Me 19.05.2021, Inxhinieri ka certifikuar (50%) të garancisë referuar nenit 14.9, të kushteve të përgjithshme të kontratës me vlerë 425,586.53 Euro. Gjysma e dytë e garancisë do të lëshohet brenda 56 ditëve pas lëshimit të Certifikatës së Garancisë.

Nga verifikimi në terren i skemave në fshatrat Sul, Koshnicë, Zicisht Dobrenj dhe Mirasper bashkinë Devoll, Skemat e bashkisë Korçë në Kamenicë dhe Dvoran dhe në Bashkinë Përrenjas në Rrajce fushë Rogdan rezultoi se:

- 1- Rrethimet nuk ishin të sigurta nga ndërhyrjet e kafshëve (zvarranikëve) duke rritur riskun për ndotje të depove të ujit në kundërshtim me kushtet e marrëveshjes, ky fenomen është hasur në të gjitha depot e ujit në të gjitha lotet e projektit.

5.2. Për kontratat Ndërtim/Rikonstrukcion i Ujësjellësve në zonat rurale LOT 2 dhe LOT 3

Për Lotin 2

L 2.1 Bashkia Dibër, Ujësjellës Kanalizime Dibër implementuar në fshatrat Dohoshisht, Çetush, Pollozhan Roshnopoje dhe Tomin.

L 2.2 Bashkia Klos, implementuar në Skenderaj-Kurdari-Suç-Kujtim .

L 2.3 Bashkia Tropoje 3 skema për furnizim me ujë në fshatrat Tropojë Fshat Aste, Kucane, Myhejan, Kasaj, Viçidol, Mejdan, Kojel, Shumice, Babine dhe Begaj.

L 2.4 Bashkia Lezhë Kallmet i Madh dhe Kallmet i Vogël.

L 2.5 Bashkia Mat ne German, Midhe, Kodër Çerre.

L 2.6 Bashkia Tropoje ne Rrogam, Cernicë, Dunishë, Bukovë dhe Llugaj.

Nga verifikimi në terren i skemave të Lot 2.3, Bashkia Tropojë në Tropojë fshat, Aste, L2.1 i bashkisë Dibër Çetush dhe Tomin, L 2.2 Bashkinë Klos në fshatin Kurdari, dhe në Bashkinë Lezhë në Kallmet u konstatua se:

- 1- Rrethimet nuk ishin të sigurta nga ndërhyrjet e kafshëve (zvarranikëve) duke rritur riskun për ndotje të depove të ujit në kundërshtim me kushtet e marrëveshjes.
- 2- Në fshatin Çetush u konstatua se nuk sigurohej ujë i rrjedhshëm 24 orë referuar objektivave të projektit.

Për Lotin 3

L 3.1/1 Bashkia Vlorë Dukat i ri Pjesa 1.

L 3.1/2 Dukat i ri Pjesa shtesë, 4 .

L 3.1/3 Tragjas WW, Pjesa 3.

L 3.2 Bashkia Himarë (Kuç) Fshatrat Kuç, Pilur, Kudhës.

L 3.4 Bashkia Lushnje UKL Çiflik .

L 3.5 Bashkia Ura Vajgurore Pashalli dhe Guri i Bardhë.

Nga verifikimi në terren i skemave të Lot 3.2 Kuç, Pilur, , L3.1/1dhe 2 në Dukat u konstatua se punimet për këto lote janë nën implementim:

- 1- Rrethimet nuk ishin të sigurta nga ndërhyrjet e kafshëve (zvarranikëve) duke rritur riskun për ndotje të depove te ujit në kundërshtim me kushtet e marrëveshjes dhe legjislacionin.

Në të gjitha rastet e audituara nuk bëhej monitorimi i depove të ujit të pijshëm referuar legjislacionit në fuqi VKM nr. 379, datë 25.05.2016, Për miratimin e rregullores òCilësia e ujit të pijshëmò neni 11.

2. Titulli i gjetjes: Rrethime të pasigurta të depove të ujit dhe mos monitorim i ambienteve

Situata:	<p>të rëndësisë së veçantë.</p> <p>Nga auditimi i zbatimit të kontratave për projektin ÷Furnizimi me ujë i zonave rurale III÷ u konstatua se, rrethimet e depove të ujit nuk ishin të sigurta nga ndërhyrjet e kafshëve (zvarranikëve) duke rritur riskun për ndotje të depove të ujit. Gjithashtu nuk kishte asnjë pajisje monitorimi të ambienteve të ujit të pijshëm, veprim ky në kundërshtim me kushtet e marrëveshjes dhe VKM nr. 379, datë 25.05.2016, ÷Për miratimin e rregullores, Cilësia e ujit të pijshëm÷, neni 11.</p>
Kriteri:	<p>VKM nr. 379, datë 25.05.2016, Për miratimin e rregullores ÷Cilësia e ujit të pijshëm÷, neni 11, ku përcaktohet se:</p> <p><i>1. Zonat e mbrojtjes sanitare përcaktohen përreth burimeve sipërfaqësore ose nëntokësore që përdoren për prodhimin e ujit të pijshëm dhe synojnë:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - ruajtjen e cilësisë së ujit; - mbrojtjen nga dëmtimet të veprave të marrjes së ujit. <p><i>2. Zonat e mbrojtjes sanitare përcaktohen specifikisht për secilin burim sipas kërkesave të neneve 34 e 57, të ligjit nr. 111/2012, “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”. Për burimet ujore që lidhen me sistem të furnizimit me ujë parashikohen 3 zona të mbrojtjes sanitare:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> a) zona imediate ose e rreptësisë e mbrojtjes sanitare; b) zona e afërt e mbrojtjes sanitare; c) zona e largët e mbrojtjes sanitare. <p><i>3. Kërkesat higjienosanitare për zonat e mbrojtjes sanitare dhe detyrimet që duhet të respektojnë administratorët e veprave të ujësjellësit, jepen në shtojcën VI të kësaj rregulloreje.</i></p> <p><i>4. Në rastin e furnizimit me ujë nga një pus individual, pronari i pusit kërkon drejtpërdrejt nga Shërbimi Gjeologjik Shqiptar apo një subjekt i licencuar në fushën e hidrogjeologjisë, përcaktimin e zonave të mbrojtjes sanitare sipas kërkesave të akteve ligjore në fuqi. Shpenzimet përballohen nga pronari i pusit.</i></p> <p><i>5. Administratori është i detyruar të ruajë zonat e mbrojtjes sanitare dhe ndërhyr në çdo rast kur konstaton shkelje brenda territorit të tyre. Ai informon organet e qeverisjes vendore, që sipas rastit kërkojnë edhe ndihmën e organeve të ruajtjes së rendit. Njëkohësisht informon edhe strukturën rajonale të shëndetit publik.</i></p>
Ndikimi/Efekti:	Risk për ndotjen e ujit të pijshëm.
Shkaku:	Projekte pa opionencë teknike referuar kushteve të vendit ku aplikohen.
Rëndësia:	E Lartë.
Rekomandimi:	Fondi Shqiptar i Zhvillimit/Njësia e Menaxhimit të Projekteve në të ardhmen, të marrin masa që të angazhohen seriozisht që në fazën e hartimit të projektit me qëllim propozimet përkatëse për përfshirjen në projekte specifike që kanë ndikim në jetën apo sigurinë e jetës së njeriut, të elementeve të sigurisë për sigurimin e garancisë së shëndetit publik në radhë të parë në konformitet me ligjet, rregullat apo marrëveshjet e miratuara nga palët.

Për sa trajtuar më sipër është mbajtur Akt konstatimi 6, nr. 1882/7 prot., datë 30.07.2021

6. Mbi administrimin e veprave të dorëzuara.

1. Titulli i gjetjes: Mos regjistrimi i veprave të marra në dorëzim nga NJVV përfituese të Projektit.

Situata: Për realizimin e skemave të furnizimit me ujë, ndërmjet FSHZH-së dhe operatorëve ekonomikë janë nënshkruar katër kontrata punimesh për secilin Lot. Deri në momentin e auditimit kanë përfunduar Lotet 1, 2 dhe 4, ku aktualisht janë në periudhë garancie, përsa i përket Lotit 3 është në proces punimesh. Në zbatim të angazhimeve të kontratave të punimeve, për lotet që kanë përfunduar punimet nga supervizori janë lëshuar certifikatat e marrjes së përkohshme në dorëzim të punimeve, marrë këto në dorëzim nga NJVV sipas rastit dhe skemave përkatëse. Për kalimin veprave të marra në dorëzim si aset në pronësi të NJVV, ndërmjet palëve janë nënshkruar marrëveshjet përfundimtare të investimit me çdo njësi. Nga auditimi konstatohet se, pas përfundimit të punimeve dhe marrjes në veprave në dorëzim bazuar në certifikatat përkatëse nga NJVV përfituese ende nuk ka nisur procesi i regjistrimit si aset në pronësi të tyre, siç parashikohet në marrëveshjet përfundimtare të investimit të datës 17.09.2018, datë 11.10.2018, dhe datës 23.01.2019, nënshkruar ndërmjet FSHZH-së dhe NJVV respektive, neni 2, pika 2.12, neni 3, pika 3.4, dhe pika 3.5.

Kriteri: Marrëveshjet Përfundimtare të Investimit të datës 17.09.2018, datës 11.10.2018, datës 23.01.2019, ndërmjet FSHZH-së dhe NJVV respektive, respektivisht, neni 2, pika 2.12, neni 3, pika 3.4, dhe pika 3.5.

Shkaku: Mos implementimi i dispozitave ligjore përkatëse.

Ndikimi/Efekti: Mos mbajtja e përgjegjësisë të NJVV në rast dëmtimi asetesh.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandimi: Fondi Shqiptar i Zhvillimit/Njësia e Menaxhimit të Projekteve, të marrë të gjitha masat administrative të nevojshme për Projektin òFurnizimi me ujë i zonave rurale IIIò dhe për Projektet në vazhdim që gjatë procesit të transferimit kapital të investimeve, të kërkohet nisja e menjëhershme e regjistrimit të asetëve në llogari të përfituesve të këtyre investimeve konform akteve ligjore dhe rregullave në fuqi.

2. Titulli i gjetjes: Raportime pjesore mbi funksionim mirëmbajtjen e skemave të Projektit.

Situata: Në zbatim të përcaktimeve të marrëveshjes së funksionimit të mirëmbajtjes NJVV përfituese nga Projekti përgjatë vitit të parë të vënies në funksionin të ujësjellësit, duhet të raportojnë çdo tre muaj pranë FSHZH-në një raport ku të pasqyrohet mënyra si do të kryhet funksionim mirëmbajtja e skemave konkretisht, mjetet financiare, pajisjet, personeli dhe metodologjia. Këtë kriter e plotëson Lot 1 dhe Lot 2 të cilat përfshijnë UK Korçë, Përrenjas, Devoll, Dibër, Klos, Mat, Tropojë dhe Lezhë. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion konstatohet se, ky raportim është kryer vetëm për një tremujor nga UK Devoll., Dibër dhe Tropojë sipas shkresave:

	- Me shkresën nr. 62 prot., datë 25.03.2021, të OE òA. G.ò dërguar pranë FSHZH-së Raportin Mujor të Monitorimit nga Ujësjiellës Kanalizime Devoll.
	- Me shkresën nr. 63 prot., datë 26.03.2021, të OE òA. G.ò dërguar pranë FSHZH-së Raportin Mujor të Monitorimit nga Ujësjiellës Kanalizime Dibër.
	- Me shkresën nr. 64 prot., datë 26.03.2021, të OE òA. G.ò dërguar pranë FSHZH-së lidhur me Raportin Mujor të Monitorimit nga Ujësjiellës Kanalizime Tropojë.
	Ndërkohë që, nga Ujësjiellës Kanalizimet e tjerë pjesë e Lotit 1 dhe 2, nuk kanë përmbushur detyrimet për raportimin çdo tre muaj drejt FSHZH-së në zbatim të referencës pikës 4.2, të Marrëveshjes së Funksionimit dhe Mirëmbajtjes me NJVV.
Kriteri:	Marrëveshjet Funksionimit dhe Mirëmbajtjes ndërmjet FSHZH-së NJVV, nenet 4, pikat 4.2, të secilës marrëveshje.
Shkaku:	Mos implementimi i dispozitave ligjore përkatëse.
Ndikimi/Efekti:	Mos marrja masave në kohë për përmirësimin e një situatë në rast konstatimi të një mangësie.
Rëndësia:	E lartë.
Rekomandimi:	Fondi Shqiptar i Zhvillimit/Njësia e Menaxhimit të Projektit të FSHZH-së të marrë të gjitha masat administrative ku t'u kërkojë ujësjiellësve përfitues nga Projekti referuar Lotit 1 dhe 2, raportet e monitorimit për funksionimin dhe mirëmbajtjen e skemave të ujësjiellësve në zbatim të përcaktimeve ligjore në marrëveshjet e funksionimit mirëmbajtjes.

Më hollësisht rezultatet e auditimit paraqiten si më poshtë:

- ❖ Projekti òFurnizimi me ujë i zonave rurale IIIò synon furnizimin me ujë të pijshëm 24 orë për 83 fshatra në total sipas 26 skemave e ndarë në 4 Lote, si më poshtë:

Lot 1

- Bashkia Devoll përfshin 1 skemë për fshatrat: Menkulas, Ponçar, Bracaj, Dobraj, Zicisht, Sul, Gjyrës, Fitore dhe Koshnicë.
- Bashkia Korçë përfshin 1 skemë për fshatrat: Kamenicë dhe Dvoran.
- Bashkia Përrenjas përfshin 2 skema për fshatrat: Njësia Administrative Rrajcë, Kovanik, Skënderbe, Sutaj dhe Bardhaj.

Lot 2

- Bashkia Dibër përfshin 5 skema për fshatrat: Rrjeti i brendshëm i fshatrave Dohoshisht, Çetush, Pollozhan dhe Tomin (Njësia Administrative Tomin).
- Bashkia Klos përfshin 1 skemë për fshatrat: Ndërtim ujësjiellësit për fshatrat Skënderaj, Kurdari, Suç dhe Kujtim.
- Bashkia Mat përfshin 1 skemë për fshatrat: Fshatrat e Njesisë Administrative, Komsit, German, Midhe, Kodër dhe Çerre.
- Bashkia Tropojë përfshin 2 skema për fshatrat: Skema e furnizimit me ujë të pijshëm për Njësine Administrative Tropojë Fshat, Rrogam, Cerrincë, Dunishë, Bukovë dhe Llugaj.

- Bashkia Lezhë përfshin 1 skemë për fshatrat: Kallmet i Madh dhe Kallmet i Vogël Njësia Administrative Kallmet.

Lot 3

- Bashkia Vlorë përfshin 3 skema për fshatrat: Dukat i Ri, Dukat i Ri Zgjatim, Kuç, Pilur dhe Masat Sanitare në Tragjas.

- Bashkia Himarë përfshin 1 skemë për fshatrat: Kuç, Pilur dhe Kudhës.

- Bashkia Lushnje përfshin 1 skemë për fshatrat: Çiflik.

- Bashkia Ura Vajgurore përfshin 1 skemë për fshatrat: Pashalli dhe Gur i Bardhë.

Lot 4

- Bashkia Tiranë përfshin 2 skema për fshatrat: Njësia Administrative Zall-Bastar, fshati Zall-Bastar, Zall-Dajt, Besh, Kodër Shupal, Shëngjin i Vogël dhe Vilëz.

- Bashkia Durrës përfshin 4 skema për fshatrat: Njësia Administrative Rrashbull/Fshati Shkëmi i Kavajë, Njësia Administrative Rrashbull/Fshati Arapaj, ish-Ferma Xhafzotaj, Njësia Administrative Katund i Ri/Fshat Jube, Erzen Sukth, Qerret, Katund i Ri, Fllakë, Sektori Rinia dhe Mamëz Lagje e Mirditorëve.

Bazuar në marrëveshjet e financimit ndërmjet Bankës Gjermane për Zhvillim KFW-së dhe Republikës së Shqipërisë për projektin ÷Furnizimi me ujë i zonave rurale III÷, FSHZH-ja në rolin e Agjencisë Zbatuese të Projektit duhet të marrë masat e nevojshme për të garantuar funksionimin dhe mirëmbajtjen e skemave sipas ujësjellësve të cilat janë pjesë e investimit nga fondet e projektit si dhe për të siguruar ndjekjen e procedurave për administrimin e veprave të dorëzuara.

Për realizimin e kësaj procedure ndërmjet FSHZH-së dhe Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore përfituesve, janë nënshkruar marrëveshjet përfundimtare të investimit dhe marrëveshjet e funksionimit dhe mirëmbajtjes, me qëllim për të siguruar angazhimin e tyre në të gjithë procesin dhe për të garantuar qëndrueshmërinë e investimit.

Referuar parashikuar në marrëveshjet përfundimtare të investimit, skemat e furnizimit me ujë sipas parashikimeve në projekt implementohen në përputhje me periudhën e përcaktuar në kushtet e kontratave të punimeve.

Me përfundimin e punimeve, procedura e marrjes në dorëzim të veprave të përfunduara, fillon pasi nga ana e supervisorit të punimeve lëshohet një certifikatë e marrjes së përkohshme në dorëzim të punimeve e cila nënshkruhet nga të gjitha palët (supervisor, kontraktori, Njësia e Vetëqeverisjes Vendore, Ujësjellës Kanalizime dhe FSHZH) dhe nga ky moment ky vepra konsiderohet në periudhën e garancisë 1 vjeçare (periudha e korrigjimit të defekteve).

Pas përfundimit të periudhës së garancisë, bëhet dorëzimi përfundimtar i investimit, bazuar në certifikatën e marrjes përfundimtare në dorëzim të punimeve përsëri edhe kjo e nënshkruar nga të gjitha palët e sipërpërmendura.

Projekti në total përfshin 83 fshatra për të cilat financimi do të realizohet sipas 26 skemave për 14 Njësi të Vetëqeverisjes Vendore e ndarë në 4 lote (kontrata punimesh) si më poshtë:

Euro

KONTRATAT E PUNIMEVE						Deri më 30.07.2021 Statusi
Nr.	Objekti i Kontratës	OE/BOE	Vlera e kontratës (pa TVSH)	Data e lidhjes së Kontratës	Afati	
1	Mbështetje për furnizimin me ujë të zonave rurale, Loti I	J. ÷S.÷ & ÷T. E.÷	8,601,883.01	26.02.2019	Deri më 11.09.2020	Në periudhë garancie
2	Mbështetje për furnizimin me ujë të zonave rurale, Loti II	A. G.	8,540,990	28.01.2019	Deri më 21.09.2020	Në periudhë garancie
3	Mbështetje për	J. SHPK	5,877,510.76	07.08.2019	Deri më 15.12.2020	Në proces

	furnizimin me ujë të zonave rurale, Loti III					
4	Mbështetje për furnizimin me ujë të zonave rurale, Loti IV	J. òA. ò&òA. ò	7,897,969.3	18.04.2019	Deri më 20.04.2021	Në periudhë garancie

Burimi i të dhënave: FSHZH/Përpunoi grupi i auditimit.

Mbi administrimin e veprave të dorëzuara.

1. Për realizimin e **Lot 1** është lidhur kontrata e punimeve me objekt òNdërtimi i sistemit të ri të ujësjellësit dhe furnizimin me ujë 24 orë për 15,833 banorë, në të cilën përfshihen 4 skema për Bashkinë Devoll, Korçë dhe Përrenjas. Punimet për këtë Lot kanë përfunduar më datë 15.09.2020, dhe aktualisht është në periudhë garancie.

Duke u bazuar në Marrëveshjen Përfundimtare të Investimit të lidhur më datë 17.09.2018, me Bashkitë e sipërpërmendura për këtë Lot dhe kontratës së punimeve më datë 26.02.2019, me BOE J. òT. E. & S.ò, janë lëshuar certifikatat e marrjes së përkohëshme në dorëzim të punimeve, si më poshtë:

- Më datë 15.09.2020, është lëshuar TOC për marrjen e përkohëshme në dorëzim të objektit òNdërtimi dhe rikonstruksioni i Ujësjellësit në Bracaj, Dobraj, Zicisht, Sul, Gjyrez, Fitore, Koshnicë, Poncar, Menkulas Njësia Administrative Mirasò, nënshkruar nga të gjitha palët më datë 16.09.2020.
- Më datë 15.09.2020, është lëshuar TOC për marrjen e përkohëshme në dorëzim të objektit òNdërtimi dhe rikonstruksioni i Ujësjellësit në Dvoran dhe Kamenicë dhe masa sanitare në Kamenicë Njësia Administrative Mollajò, nënshkruar nga të gjitha palët më datë 16.09.2020.
- Më datë 15.09.2020, është lëshuar TOC për marrjen e përkohëshme në dorëzim të objektit òNdërtimi dhe rikonstruksioni i Ujësjellësit në Kovanik, Skënderbej, Sutaj, Rrajcë e poshtme, Bogdan Njësia Administrative Rrajcëò, nënshkruar nga të gjitha palët më datë 16.09.2020.

2. Për realizimin e **Lot 2** është lidhur kontrata e punimeve me objekt òNdërtimi i sistemit të ri të ujësjellësit dhe furnizimin me ujë 24 orë për 16,609 banorë, në të cilën përfshihen 10 skema për Bashkinë Dibër, Klos, Mat, Tropojë dhe Lezhë. Punimet për këtë Lot kanë përfunduar më datë 25.09.2020, dhe aktualisht është në periudhë garancie.

Duke u bazuar në Marrëveshjen Përfundimtare të Investimit të lidhur më datë 11.10.2018, me Bashkitë e sipërpërmendura për këtë Lot dhe kontratës së punimeve më datë 28.01.2019, me OE òA. G.ò, janë lëshuar certifikatat e marrjes së përkohëshme në dorëzim të punimeve, si më poshtë:

- Më datë 25.09.2020, është lëshuar TOC për marrjen e përkohëshme në dorëzim të objektit òLot 2.1.-Dohoshisht, Çetush, Pollozhan, Rasnopojë dhe Tomin në Bashkinë e Dibrësò, nënshkruar nga të gjitha palët më datë 25.09.2020.
- Më datë 25.09.2020, është lëshuar TOC për marrjen e përkohëshme në dorëzim të objektit òLot 2.2-Skënderaj, Kurdari, Suç dhe Kujtim në Bashkinë Klosò, nënshkruar nga të gjitha palët më datë 25.09.2020.
- Më datë 25.09.2020, është lëshuar TOC për marrjen e përkohëshme në dorëzim të objektit òLot 2.3-Astë, Viçidol, Mejdan, Kojel, Babinë dhe Shumicë në Bashkinë Tropojë, Njësia Administrative Tropojëò, nënshkruar nga të gjitha palët më datë 25.09.2020.
- Më datë 25.09.2020, është lëshuar TOC për marrjen e përkohëshme në dorëzim të objektit òLot 2.4-Kallmet i madh dhe Kallmet i vogël në Bashkinë Lezhëò, nënshkruar nga të gjitha palët më datë 25.09.2020.

- Më datë 25.09.2020, është lëshuar TOC për marrjen e përkohëshme në dorëzim të objektit òLot 2.5-German, Midhe dhe Kodër Çerre në Bashkinë Matò, nënshkruar nga të gjitha palët më datë 25.09.2020.

3. Për realizimin e Lot 4 është lidhur kontrata e punimeve me objekt òNdërtimi i sistemit të ri të ujësjellësit dhe furnizimin me ujë 24 orë për 36,418 banorë, në të cilën përfshihen 6 skema për Bashkinë Tiranë dhe Durrës. Punimet për këtë Lot kanë përfunduar më datë 26.04.2021, dhe aktualisht është në periudhë garancie.

Duke u bazuar në Marrëveshjen Përfundimtare të Investimit të lidhur më datë 23.01.2019, me Bashkitë e sipërpërmendura për këtë Lot dhe kontratës së punimeve më datë 18.04.2019, me BOE J. òA. & A. G.ò SHPK, janë lëshuar certifikatat e marrjes së përkohëshme në dorëzim të punimeve, si më poshtë:

- Më datë 26.04.2021, është lëshuar TOC për marrjen e përkohëshme në dorëzim të objektit òRikonstruksioni dhe zgjerimi i ujësjellësit për fshatrat Ish-Ferma Xhafzotaj dhe Arapajò, nënshkruar nga të gjitha palët më datë 12.07.2021.

- Më datë 26.04.2021, është lëshuar TOC për marrjen e përkohëshme në dorëzim të objektit òRikonstruksioni i ujësjellësit për fshatin Shkëmbi i Kavajës (sipër shinave të trenit)ò, nënshkruar nga të gjitha palët më datë 12.07.2021.

- Më datë 26.04.2021, është lëshuar TOC për marrjen e përkohëshme në dorëzim të objektit òRikonstruksioni dhe zgjerimi i ujësjellësit për fshatrat Jubë, Erzen, Qerret, Katund i Ri, Fllakë, Sektori Rinia dhe Lagja e Mirditorëveò, nënshkruar nga të gjitha palët më datë 12.07.2021.

- Më datë 26.04.2021, është lëshuar TOC për marrjen e përkohëshme në dorëzim të objektit òNdërtimi i Ujësjellësit Vilëz, dhe rikonstruksioni ujesjellësi për fshatrat Shën Gjin i vogël, Besh, Zall, Bastar, Zall Dajt dhe Sanitete në fshatin Vilëzò, nënshkruar nga të gjitha palët më datë 30.06.2021.

(Theksojmë se, Loti 3 nuk është trajtuar në këtë pikë mbi administrimin e veprave të dorëzuara, në kushtet për këtë lot nuk janë lëshuar certifikata të marrjes së përkohëshme në dorëzim të objekteve duke qenë se aktualisht është në proces zbatimi punimesh).

Pas certifikimit të përfundimit të punimeve nga të gjitha palët në respektim të Marrëveshjes së Financimit të datës 11.10.2018, FSHZH ka dërguar referuar shkresave përkatëse dokumentacionin e plotë të zbatimit sipas objekteve dhe skemave respektive të projektit, si më poshtë:

- Për Lot 1:

- Me shkresën nr. 320 prot., datë 21.01.2021, është dërguar dokumentacioni për zbatimin e objektit òUjësjellës Rajcëò, Bashkia Përrenjas.
- Me shkresën nr. 2401 prot., datë 09.10.2020, është dërguar dokumentacioni për zbatimin e objektit òUjësjellës Mollajò, Bashkia Korçë.
- Me shkresën nr. 3353 prot., datë 23.12.2020, është dërguar dokumentacioni për zbatimin e objektit òUjësjellës Mollajò, Bashkia Korçë.

- Për Lot 2:

- Me shkresën nr. 772 prot., datë 22.02.2021, është dërguar dokumentacioni për zbatimin e objektit òNdërtimi/rikonstruksioni i Ujësjellësit Dohoshisht, Çetush, Pollozhan, Rrashnapojë dhe Tominò, Bashkia Dibër.
- Me shkresën nr. 773 prot., datë 22.02.2021, është dërguar dokumentacioni për zbatimin e objektit òNdërtimi i Ujësjellësit Kallmetò, Bashkia Lezhë.

- Me shkresën nr. 769 prot., datë 22.02.2021, është dërguar dokumentacioni për zbatimin e objektit òSkema e furnizimit me ujë për fshatrat Rrogam, Cernicë, Dunishë, Bukovë dhe Lugajë dhe òSkema e furnizimit me ujë për Njësinë Administrative Tropojë Fshatë, Bashkia Tropojë.
- Me shkresën nr. 770 prot., datë 22.02.2021, është dërguar dokumentacioni për zbatimin e objektit òNdërtim/rikonstruksioni i Ujësjellësit Skënderaj, Kurdari, Suç, Kujtimë, Bashkia Klos.
- Me shkresën nr. 771 prot., datë 22.02.2021, është dërguar dokumentacioni për zbatimin e objektit òNdërtim/rikonstruksioni i Ujësjellësit German, Midhë dhe Kodër Çerrëo, Bashkia Mat.

(Theksojmë se për sa i përket Lot 4, nga FSHZH nuk është dërguar ende dokumentacioni i zbatimit Bashkive respektive në kushtet se për këtë Lot certifikatat e marrjes së përkohëshme e punimeve janë kryer më datën 12.07.2021).

Bazuar në kontratat zbatimit të punimeve konkretisht:

- **Lot 1** kontrata nënshkruar më datë 26.02.2019, përfshin 4 skema për Bashkitë Devoll, Korçë dhe Përrenjas.
- **Lot 2** kontrata nënshkruar më datë 28.01.2019, përfshin 10 skema për Bashkinë Dibër, Klos, Mat, Tropojë dhe Lezhë.
- **Lot 4** kontrata nënshkruar më datë 18.04.2019, përfshin 6 skema për Bashkinë Tiranë dhe Durrës.

Për këto kontrata/lotë nga supervizori janë lëshuar certifikatat e marrjes së përkohëshme në dorëzim të punimeve sipas procedurës të sipërpërmendur në material, të cilat janë marrë në dorëzim nga Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore referuar skemave përkatëse.

Ndërkohë që, në marrëveshjet përfundimtare të investimit të datës 17.09.2018, datës 11.10.2018, datës 23.01.2019, ndërmjet FSHZH-së dhe Bashkive përcaktohet se:

Neni 2, Detyrimet e Njësive të Vetëqeverisjes Vendore, pika 2.12: “Të vërtetojë që ky investim do të administrohet drejtpërdrejtë ose nën përgjegjësinë e Bashkisë dhe të funksionojë dhe mirëmbahet, në mënyrë të tillë që të shërbejnë për qëllimin për të cilin ai është financiar”.

Neni 3, Dispozitat financiare, pika 3.4: “Të garantojë firmosjen e certifikatave sipas kushteve FIDIC dhe në veçanti “Çertifikatën e Marrjes në Dorëzim të Punimeve dhe Objekteve” dhe “Çertifikatën e Garancisë pas Përfundimit të Punimeve” brenda 15 ditëve të kohës së rregullt, ose të njoftojë FSHZH-në për arsye e mosfirmosjes dhe veprimet që duhet të ndërmerren në mënyrë që të firmosen këto certifikata”.

Pika 3.5: “Bashkia të bëjë rregjistrimin e asetëve të Ujësjellësit sipas kërkesave të ligjit shqiptar”.

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion konstatohet se, pas përfundimit të punimeve dhe marrjes në veprave në dorëzim bazuar në certifikatat përkatëse nga NJVV përfituese ende nuk ka nisur procesi i regjistrimit si aset në pronësi të tyre, në referencë të marrëveshjes përfundimtare të investimit të datës 17.09.2018, datë 11.10.2018, dhe datës 23.01.2019, nënshkruar ndërmjet FSHZH-së dhe NJVV respektive, neni 2, pika 2.12, neni 3, pika 3.4, dhe pika 3.5, e dokumentuar kjo në korrespondencat me FSHZH-në.

Referuar Marrëveshjeve Funkcionim dhe Mirëmbajtje ndërmjet FSHZH-së Bashkive të cilat janë pjesë e skemës së financimit nga projekti, në pikën 4.2, përcaktohet se:

Njësia e Vetëqeverisjes Vendore nëpërmjet Ujësjellës Kanalizime SHA (sipas rastit), do t'i dërgojë një raport me shkrim FSHZH-së tre muaj para lëshimit të Çertifikatës së Marrjes në Dorëzim, ku të pasqyrohet mënyra se si kjo Njësi e Vetëqeverisjes Vendore synon të kryejë F&M (ky raport do të përfshijë mjete financiare, pajisje, personelin dhe metodologjinë e punës). Pas Çertifikatës së Marrjes në Dorëzim, do të kërkohet një raportim si më poshtë vijon:

- Raportim çdo tre muaj gjatë vitit të parë të vënies në funksion të ujësjellësit;

- Raportim çdo gjashtë muaj gjatë vitit të dytë të vënies në funksion të ujësjellësit;

- Raportim një herë në vit gjatë vitit të tretë e në vijim (çdo fund viti kalendarik).

Ndërkohë që nga dokumentacioni i vënë në dispozicion për realizimin dhe plotësimin e kushtit të parë të pikës 4.2, pra “Raportim çdo tre muaj gjatë vitit të parë të vënies në funksion të ujësjellësit” konstatohet se:

Ky raportim është kryer vetëm në tre raste nga Ujësjellës Kanalizime pjesë e skemave të loteve të sipërpërmendura duke ja dërguar këto raporte OE òA. G.ò dhe më pas konsulenti ka bërë me dije FSHZH sipas shkresave respektive, si më poshtë:

- Me shkresën nr. 62 prot., datë 25.03.2021, të OE òA. G.ò dërguar pranë FSHZH-së Raportin Mujor të Monitorimit nga Ujësjellës Kanalizime Devoll.
- Me shkresën nr. 63 prot., datë 26.03.2021, të OE òA. G.ò dërguar pranë FSHZH-së Raportin Mujor të Monitorimit nga Ujësjellës Kanalizime Dibër.
- Me shkresën nr. 64 prot., datë 26.03.2021, të OE òA. G.ò dërguar pranë FSHZH-së lidhur me Raportin Mujor të Monitorimit nga Ujësjellës Kanalizime Tropojë.

Si dhe,

Nga Ujësjellës Kanalizimet të cilët janë pjesë e skemës së financimit për Lot 1 dhe Lot, nuk kanë përmbushur detyrimet për raportimin çdo tre muaj drejt FSHZH-së në zbatim të references pikës 4.2, të Marrëveshje Funksionim Mirëmbajtje me Bashkitë.

(Theksojmë se në lidhje me detyrimet për kushtet e tjera të pikës 4.2, nuk është plotësuar afati kohor për raportim duke qenë se këto lote (Lot 1, 2 dhe 4) janë në periudhë garancie si dhe është viti i parë nga momenti i marrjen e përkohëshme në dorëzim të punimeve).

Regjistrimi në kontabilitet.

FSHZH i mban të dhënat e kontabilitetit sipas metodës së òCash basisò. Si rezultat i specifikave të institucionit, me burime financiare dhe me kërkesa raportuese të ndryshme, FSHZH mban një SK të kompjuterizuar të integruar sipas programeve dhe donatoreve respektiv. Në bazë të projekteve që ka në zbatim dhe kërkesave të donatoreve, FSHZH përgatit pasqyrat financiare të çdo viti ushtrimor.

Këto Pasqyra Financiare auditohen çdo vit nga Audite, të cilët përzgjidhen nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë. Kompania audituese në fund të periudhës së auditimit gjeneron raportet dhe pasqyrat financiare për secilin projekt.

Në lidhje me projektin òFurnizimi me ujë i zonave rurale IIIò, FSHZH e regjistron në llogarinë 231/230 (Investimet) në proces, si dhe qëndron e regjistruar në këtë llogari kontabël deri në momentin që përfundon garancia e punimeve i cili ka të bëjë edhe me dorëzimin përfundimtar të investimit tek përfituesi final.

Për sa trajtuar më sipër është mbajtur Akt konstatimi 2, nr. 1882/3 prot., datë 30.07.2021

IV. GJETJET DHE REKOMANDIMET

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Nga verifikimi në terren konstatohet se objektivi i përcaktuar në marrëveshjet midis KfW dhe Qeverisë Shqiptare i cili është furnizimi me ujë të pijshëm 24 orë nuk është arritur në të gjitha zonat. Më konkretisht në qytetin e Peshkopisë, fshati Çetush, u konstatua se ky fshat nuk ka furnizim me ujë të pijshëm 24 orë, konstatim i cili u konfirmua edhe nga banorët e fshatit gjatë verifikimit në terren. Gjithashtu gjatë auditimit të investimit në Depon e ujit të pijshëm në këtë fshat u konstatua se depo ishte e boshatisur dhe furnizimi me ujë të pijshëm për këtë fshat bëhej me orare të kufizuara. Nga verifikimi në terren në datën 18.06.2021, për investimin e kryer në zonën e qytetit Durrës, më konkretisht në fshatin Katundi i Ri ku ndodhen 2 depo uji të pijshëm të cilat furnizojnë me ujë të pijshëm disa fshatra siç janë Katundi i ri, Jubë, Qerret, Katund Sukth dhe Lagje e Mirditorëve, u konstatua se të 2 depot e ujit ishin të boshatisura dhe furnizimi me ujë të pijshëm në fshatrat e lartpërmendura kryhet me orare të kufizuara dhe jo 24 orë në ditë siç është e përcaktuar në Marrëveshjen e Huas ratifikuar me Ligjin nr. 97/2015, datë 17.05.2015, për projektin "Furnizimi me ujë i zonave rurale III", si dhe Manuali Operacional i Projektit, Seksioni 2, pika 2.1. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqe 16-18 të Raportit të Auditimit).*

1.1. Rekomandimi: Fondi Shqiptar i Zhvillimit në bashkëpunim me Institucionet Vendore të evidentojnë mangësitë në sistemet dhe impiantet hidraulike të furnizimit me ujë për zonat përkatëse me qëllim realizimin e furnizimit me ujë pa ndërprerje për këto zona.

1.2. Rekomandimi: Fondi Shqiptar i Zhvillimit të marri masat që në të ardhmen të angazhohet maksimalisht në rankimin e zonave ku do të investohet për projektet e ngjashme të furnizimit me ujë 24 orë, me qëllim që në ato zona burimet natyrore të ujit në sasi dhe cilësi furnizim të ujit duke pasur parasysh furnizimin me vetërrjedhje, për pasojë uljen e kostos së furnizimit me ujë për banorët.

Menjëherë dhe në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Gjatë periudhës së zbatimit të Projektit, Marrëveshjet e Financimit me dakortësinë e palëve janë ndryshuar (amenduar) në lidhje me afatet e disbursimeve të fondeve konkretisht:

- Më datë 28.02.2019, midis KfW-së Gjermane dhe MFE-së është kryer amendimi i Marrëveshjes së Huas me nr. 201166370, të ratifikuar me Ligjin nr. 97/2015, datë 17.09.2015, me objekt shtyrjen e afatit të disbursimeve nga data 30.06.2019, deri më 30.06.2021.

- Më datë 27.01.2020, midis KfW-së Gjermane dhe MFE-së është kryer amendimi i Marrëveshjes së Financimit me nr. 202061133, të ratifikuar me Ligjin nr. 35/2015, datë 09.04.2015, me objekt shtyrjen e afatit të disbursimeve nga data 30.06.2019, deri më datë 19.02.2022.

- Më datë 29.01.2021, midis KfW-së Gjermane dhe MFE-së është kryer amendimi i Marrëveshjes së Financimit me nr. 201470137, të ratifikuar me Ligjin nr. 36/2015, datë 09.04.2015, me objekt shtyrjen e afatit të disbursimeve nga data 30.06.2019, deri më datë 30.12.2022.

Në zbatim të nenit 3, pika 3.2, të marrëveshjeve të financimit respektivisht me nr. 202061133, dhe nr. 201470137, afati përfundimtar për kryerjen e disbursimeve është data 30.06.2019. Amendimet për ndryshimin/shtyrjen e afateve të disbursimeve janë bërë me shkresat e datës

27.01.2020, dhe datës 29.01.2021. Nga auditimi konstatohet se, disbursimet kanë vazhduar edhe pas datës 30.06.2019, në kushtet kur midis palëve nuk është dakordësuar amendim për ndryshimin e afateve për disbursimin e fondeve. Referuar shkresave të sipërpërmendura amendimet janë kryer pas 7 muajve për Marrëveshjen e Financimit me nr. 202061133, dhe pas 19 muajve për Marrëveshjen e Financimit me nr. 201470137, veprime këto jo sipas përcaktimeve të Marrëveshjes së Financimit dhe Projektit të ratifikuar me Ligjin nr. 35/2015, datë 09.04.2015, dhe Ligjin nr. 36/2015, datë 09.04.2015, për Projektin ÷Furnizimi me ujë i zonave rurale IIIö, pikat 8.5, të secilës marrëveshjeje. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 19-34 të Raportit të Auditimit).*

2.1. Rekomandimi:Fondi Shqiptar i Zhvillimit/Njësia e Menaxhimit të Projektit, në vijim të zbatimit të projektit ÷Furnizimi me ujë i zonave rurale IIIö si dhe për të gjitha projektet të cilat do të menaxhohen në të ardhmen nga FSHZH, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat administrative për informimin e MFE në cilësinë e përfaqësuesit të Qeverisë Shqiptare për përfundimin e afateve të disbursimeve financiare referuar marrëveshjeve të financimit në kushtet që nga MFE dhe donatorët të kryen amendimet në kohë reale.

Në vijimësi

3. Gjetje nga auditimi: Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion në lidhje me likuidimin e TVSH-së nga Qeveria Shqiptare, referuar kontratës të datës 26.02.2019, ndërmjet FSHZH-së dhe OE J. ÷T. E.ö & ÷S.ö me objekt ÷Ndërtimi i sistemit të ri të ujësjellësit dhe furnizimin me ujë 24 orë për 15,883 banorë, Lot 1ö në vlerën 8,601,883 euro pa TVSH konstatohet se:

Për situacionin e punimeve nr. 6, të kontratës të sipërpërmendur OE ka lëshuar faturën tatimore seria 77032493, nr. 42, datë 29.06.2020, në shumën 795,398 euro me TVSH. Për këtë faturë, TVSH-ja është në shumën 132,566.48 euro konvertuar sipas kursit të Bankës së Shqipërisë (1 euro këmbëhet me 124.77 lekë) ose në shumën 16,474,036.47 lekë. Likuidimi i TVSH për këtë faturë është kryer me Urdhër Shpenzimin nr. 108/1, datë 07.07.2020, në shumën 16,747,036 lekë me një diferencë më tepër në shumën 273,000 lekë në favor të OE J. ÷T. E.ö & ÷S.ö. Kjo problematikë është bërë me dije përfaqësuesve të FSHZH-së më datë 28.06.2021, ku më datë 29.06.2021, janë kryer veprimet rregulluese në R. Bankë sipas transaksionit me referencë nr. P210629EUPOP08, datë 29.06.2021, ku OE ka arkëtuar në llogari të FSHZH-së shumën 273,000 lekë. Pavarësisht kthimit të shumës nga OE, në pasqyrat financiare të vitit 2020, regjistrimi i kësaj pagese nuk është kryer në përputhje me vlerën e saktë të përcaktuar në faturën tatimore, veprime këto jo sipas përcaktimeve të Ligji nr. 9228, datë 29.04.2004, ÷Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiareö i ndryshuar, dhe Ligjit nr. 92/2014, datë 24.07.2014, ÷Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisëö i ndryshuar, neni 48. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 19-34 të Raportit të Auditimit).*

3.1. Rekomandimi:Fondi Shqiptar i Zhvillimit/Departamenti i Financës në pasqyrat financiare të vitit 2021 të kryejë sistemimin e vlerës 273,000 lekë, vlerë e cila ka të bëjë me regjistrimin e gabuar të likuidimit të TVSH-së për situacionin e punimeve nr. 6, për kontratën e zbatimit të punimeve Lot 1 të lidhur midis OE J. ÷T. E.ö & ÷S.ö dhe FSHZH, për Projektin ÷Furnizimi me ujë i zonave rurale IIIö duke u bazuar në Urdhër Shpenzimin nr. 108/1, datë 07.07.2020, referuar sistemimit të trajtimit kontabël dhe funksionimit të llogarive të grupit 23 ÷Investime në procesö, si dhe të bëhen rakordimet me Degën e Thesarit Tiranë.

Deri më datë 31.03.2022

4. Gjetje nga auditimi: Bazuar në kontratën e datës 09.11.2015, ndërmjet FSHZH-së dhe OE òP. & P.ò me objekt òPërgatitjen e projektit dhe studimet e fizibilitetitò në vlerën 663,070 euro pa TVSH, likuidimi i pagesave të rimbursueshme është kryer referuar aplikimit nr. 6, datë 19.06.2017, disbursuar respektivisht në shumën 9,542.64 euro nga KfW-ja Gjermane dhe shumën 153,609 lekë nga Qeveria Shqiptare me Urdhër Shpenzimin nr. 127, datë 04.07.2017, sipas faturës tatimore nr. 12, datë 01.06.2017. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion konstatohet se, për katër raste si më poshtë:

- Fatura tatimore nr. 119, datë 23.03.2016, në shumën 17,500 lekë me TVSH me objekt òWork Shop akomodim në hotel G. K., marrje salle me qiraò.

- Fatura tatimore nr. 352, datë 25.03.2016, në shumën 33,600 lekë me TVSH me objekt òShërbim aktiviteti dhe shërbim kafeje Sh.ò.

- Fatura tatimore nr. 141, datë 18.03.2016, në shumën 18,000 lekë me TVSH me objekt òWork Shop akomodim në H. G. T.ò.

- Fatura tatimore nr. 19, datë 29.03.2016, në shumën 17,000 lekë me TVSH me objekt òShërbim catering në E. M. V.ò.

Urdhër shpenzimet për likuidimit e faturave të mësipërme nuk kanë të bashkëlidhur dokumentacionin e plotë shoqërues, konkretisht, listat e nënshkruara nga personat të cilët kanë qenë pjesëmarrës në këto aktivitete, veprime këto jo sipas përcaktimeve të Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011, òPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikò i ndryshuar, pika 36. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 19-34 të Raportit të Auditimit).*

4.1. Rekomandimi: Fondi Shqiptar i Zhvillimit/Departamenti i Financës dhe Menaxheri i Projektit, të marrin masa të menjëhershme për plotësimin me përgjegjësi të dokumentacionit shoqërues për këtë praktikë dhe për të gjitha praktikatat e tjera në vazhdim në zbatim të kuadrit rregullator ligjor në fuqi.

Menjëherë

5. Gjetje nga auditimi: Bazuar, në angazhimet e përcaktuara në Marrëveshjet e Financimit të donatorëve përkatës, në Manualin Operacional të Projektit dhe në Marrëveshjet Përfundimtare të Investimit, NJVV të cilat përfitojnë nga ky Projekt, kanë detyrimin të financojnë në formë kontributi një pjesë të fondeve të projektit. Kështu gjatë implementimit të projektit për periudhën nga data 01.01.2016, deri më 30.06.2021, disa nga këto NJVV kanë derdhur kontributet e tyre në arkën e FZSHSH shumën totale 308,963,708 lekë. Ndërsa nëntë NJVV nuk kanë shlyer ende detyrimin në shumën 89,425,931 lekë për Kontributin Lokal në llogari të FSHZH-së *(shiko listën në tabelën nr. 9, pikën nr. 3, të Raportit të Auditimit).* Kjo situatë ka ndodhur si pasojë e mos respektimit të afatit për derdhjen e detyrimeve referuar Marrëveshjes Përfundimtare të Investimit të lidhur me NJVV respektive neni 3, pikat 3.1, 3.2, dhe 3.3. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 19-34 të Raportit të Auditimit).*

5.1. Rekomandimi: Fondi Shqiptar i Zhvillimit/Njësia e Menaxhimit të Projektit të marrin të gjitha masat e nevojshme duke ndjekur të gjitha rrugët procedurale dhe administrative për mbledhjen e detyrimeve/Kontributin Lokal në shumën 89,425,931 lekë nga NJVV përfituese të projektit të cilat janë debitorë ndaj FSHZH-së, në zbatim të përcaktimeve të Marrëveshjes Përfundimtare të Investimit.

Menjëherë

6. Gjetje nga auditimi: Raportimet për realizimin e disbursimeve dhe shpenzimeve për periudhën nga data 01.01.2016, deri më 30.05.2021, janë dorëzuar në MFE-së, ku në përgjithësi

janë kryer mbi bazën e dispozitave ligjore përkatëse por konstatohet se, në 11 raste konkretisht për muajin shkurt, maj, qershor, dhjetor 2016, janar, shkurt, qershor, dhjetor 2017, dhjetor 2018, dhjetor 2019, dhjetor 2020, nga FSHZH nuk janë respektuar afatet mbi raportimin e realizimit të disbursimeve në MFE-së sipas përcaktimeve të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 8, datë 17.02.2003, òPër evidencimin, regjistrimin, përdorimin dhe raportimin e financimeve të huaja në kuadrin e projekteve dhe marrëveshjeve me donatorët e huajò, pika 5.5. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 19-34 të Raportit të Auditimit).*

6.1. Rekomandimi: Fondi Shqiptar i Zhvillimit/Departamenti i Financës të marrë masa që të raportojë në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë realizimin e disbursimeve financiare dhe shpenzimeve të Projektit brenda afateve të parashikuara në kuadrin rregullator ligjor përkatës.

Në vijimësi

7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të prokurimit të projektit òFurnizimi me ujë i zonave rurale IIIò u konstatua se, dosjet e prokurimit nuk ishin të inventarizuara dhe arkivuara, gjithashtu shumë prej shkresave, kontratave, amendamenteve rezultuan të pa protokolluara, veprime këto në kundërshtim me nenin 3 dhe 29 të òNorma Tekniko Profesionale dhe Metodologjisë të Shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisëò, miratuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave, në zbatim të Ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003, òPër Arkivatò. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe 35-43 të Raportit të Auditimit).*

7.1. Rekomandimi: Fondi Shqiptar i Zhvillimit/Njësia e Menaxhimit të Projektit, të marrë masa për protokollimin dhe arkivimin e të gjitha dosjeve të procedurave të prokurimit të zhvilluara për këtë Projekt në zbatim të Normave Tekniko Profesionale dhe Metodologjisë të Shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisë.

Menjëherë

8. Gjetje nga auditimi: Për projektin òFurnizimi me ujë i zonave rurale IIIò konstatohet se nuk është hartuar një Plan Prokurimi, veprime këto në kundërshtim me kapitullin 9, nën-pika 9.1, òFazat e procesit të prokurimitò të Manualit të Procedurave të FSHZH miratuar me Vendimin nr. 167, datë 06.12.2018, i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe 35-43 të Raportit të Auditimit).*

8.1. Rekomandimi: Fondi Shqiptar i Zhvillimit, strukturat përkatëse të prokurimit sipas rastit, të marrin masa që në të ardhmen përpara kryerjes së procedurave të prokurimit për realizimin e projekteve të miratuara më parë, të planifikojnë dhe dokumentojnë prokurimet që do të kryhen në fazën e parashikimit në konformitet me ligjet, rregullat dhe manualët në fuqi.

Menjëherë

9. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit mbi procedurat e realizimit të projekteve që në fazën e studimit të fizibilitetit, referuar edhe skeduleve apo manualeve për zbatim të projekteve të miratuara nga donatori, ka rezultuar se angazhimi i strukturave përkatëse të FSHZH në projektin òFurnizimi me ujë i zonave rurale IIIò ka qenë i pjesshëm, shoqëruar në disa raste edhe nga mungesa e gjurmës së auditimit, veprime këto jo sipas parashikimeve të Appendix 2, RWSP IMPLEMENTATION FRAMEWORK. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe 35-43 të Raportit të Auditimit).*

9.1. Rekomandimi: Fondi Shqiptar i Zhvillimit, Drejtoria Juridike dhe Drejtoria Teknike, të marrin masa që në të ardhmen të angazhohen në çdo projekt në konformitet me manualët dhe

rregulloret në fuqi me qëllim përmirësimin e cilësisë së ekzekutimit të projekteve, si nga ana ligjore ashtu dhe teknike duke pasur parasysh lënien e gjurmës së auditimit.

Menjëherë

10. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se, shumë prej zërave të listuara në listën e punimeve të vogla të pakryera (Snagging List) që shoqëron certifikatën e marrjes në dorëzim, nga krahasimi i bërë me verifikimin në terren të grupit të auditimit rezultuan ende të pakryera dhe nga ana e FSHZH nuk është marrë asnjë masë për të nisur një rinspektim për të verifikuar gjendjen sipas afatit të përcaktuar në të më datë 10.06.2021, veprime këto në kundërshtim me Kontratën No. RWSP-WC-ICB-2018-4 lidhur midis Fondit Shqiptar të Zhvillimit dhe BOE òA.ò SHPK & òA. G.ò O. më datë 18.04.2019, me objekt òNdërtim/Rikonstruksion i Ujësjellsave në zonat rurale LOT 4ò. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqe 44-48 të Raportit të Auditimit).*

10.1. Rekomandimi: Fondi Shqiptar i Zhvillimit/Njësia e Menaxhimit të Projektit të marrë masat për të kryer inspektimin për verifikimin e gjendjes dhe të adresohen shkaqet e përgjegjësitë e punimeve të mbetura ende pa kryer si dhe të adresohen mënyrat e përfundimit të tyre referuar kontratës.

Menjëherë

11. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të kontratave për projektin òFurnizimi me ujë i zonave rurale IIIò u konstatua se, rrethimet e depove të ujit nuk ishin të sigurta nga ndërhyrjet e kafshëve (zvarranikëve) duke rritur riskun për ndotje të depove të ujit. Gjithashtu nuk kishte asnjë pajisje monitorimi të ambienteve të ujit të pijshëm, veprim ky në kundërshtim me kushtet e marrëveshjes dhe VKM nr. 379, datë 25.05.2016, òPër miratimin e rregullores, Cilësia e ujit të pijshëmò, neni 11. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqe 44-48 të Raportit të Auditimit).*

11.1. Rekomandimi: Fondi Shqiptar i Zhvillimit/Njësia e Menaxhimit të Projekteve në të ardhmen, të marrin masa që të angazhohen seriozisht që në fazën e hartimit të projektit me qëllim propozimet përkatëse për përfshirjen në projekte specifike që kanë ndikim në jetën apo sigurinë e jetës së njeriut, të elementeve të sigurisë për sigurimin e garancisë së shëndetit publik në radhë të parë në konformitet me ligjet, rregullat apo marrëveshjet e miratuara nga palët.

Menjëherë dhe në vijimësi

